

FRANO KULLI

# KOHË E PËRLYEME

*Publicistikë*

Frano Kulli  
Kohë e përlyeme  
- *Publicistikë* -



Frano Kulli

# Kohë e përlyeme

*- Publicistikë -*

Parathënia nga  
Agron Gjekmarkaj

Përkujdesja gjuhësore:  
Tefë TOPALLI

Kopertina:  
Paolo CURCI

Paraqitja grafike:  
Rezarto KULLI



Enti Botues "Gjergj Fishta", 2018  
tel. +355 215 22342; fax: +355 215 22661  
e-mail: [info@botimetfishta.com](mailto:info@botimetfishta.com)

*Ia kushtoj:  
Julias, mbesës  
e Samuelit, nipit.*

Falënderoj miqtë e bashkëpunëtorët e mij të vyer, studiuesin Tonin Çobani, shkrimtarin e studiuesin Stefan Çapaliku dhe shkrimtarin e gazetarin Lazer Stani, që e kanë inkurajuar më së pari daljen e këtij libri.

Falënderoj publicistin e pedagogun Agron Gjekmarkaj për parathënien e bërë me dashuri dhe prof. Hamit Boriçin, me përkrahjen e hershme të të cilit zë fill përvoja ime modeste në rrugën e publicistikës.

Robert Rakipllarin, kryeredaktorin e “Panorama” e falënderoj për bashkëpunimin e gjatë të mirëkuptuar.



Pasqyra e lëndës

***Parathënie nga Agron Gjekmarkaj:***

Publicistika e Frano Kullit si shënjuese e dilemave të tranzicionit ..... 11

**I. “Kokëderrat” e kënaqun dhe... “Sokrati”i vuejtun**

“Kokëderrat” e kënaqun dhe... “Sokrati” i vuejtun.....	17
Aty ku mbaron e drejta dhe... fillon e padrejta e dhunshme .....	20
Katolikët, martirë ose... të përdorur ?.....	24
Ironia e shtetit që do të bëjmë.....	29
Guvernatorët e pafajshëm.....	32
Pse është kuqlluar kaq shumë Shkodra? .....	36
“Mbetjet teknologjike” si ofertë...? .....	39
“Njollat e murrme “të kryebashkiakëve.....	44
Punë plehnash... ..	48
Kapela e Nastradinit dhe... fushata e burgimeve .....	51
Skandalet e prijësve si dhunë pushteti .....	55
“Punë krajlash” ... punë hajnash .....	58
“Me mih n’ujë” .....	62

**II. Fishta... dhe hijet përreth**

Fishta... dhe hijet përreth .....	67
Pse stisen flirte të Fishtës me fashizmin? .....	71



Fishta - analist dhe polemist.....	77
Nga Kukli në Fishtë dhe hierarkia e dekoratave.....	84
Mjedologu. Lamtumirë Mentor Ouku.....	91
Në kohën që rindërtohen burgje a mund të ngrihen tempuj?.....	93
Dritëroi, Pjetër Arbnori, Fishta ... (Rikthejeni Fishten në tekstet shkollore) .....	98
Ndërmjet “Mitit dhe antimitit” të Tonin Çobanit .....	103
“Posta e Shqypnis’ “ e Tefë Topallit .....	106
Fishta si dëshmi e idenditetit shqiptar .....	110
Filozofia arsimore e Fishtës .....	115

### III. Martirët dhe ndërgjegjja jonë e përlyeme

Një lutje për Martirët në sheshin “Nënë Tereza” ... ..	121
Shenjta Nënë Tereze, lutu për ne... ! .....	125
Martirët dhe... ndërgjegjja jonë e përlyeme .....	128
Moter Marija, dom Errnesti dhe refuzimi i diktatorit... ..	134
Mesha e parë në Shkoder... si fund dhe fillim .....	139
Papa Françesku, gjërat e vogla dhe... statusi.....	144
Për dekorimet si punë... sekretarësh.....	148
Harmonia fetare dhe lapsat e Kryeministrit si një gjest....	151
Lulet dhe... inflacioni i fjalës luftë.....	155
Paç dritë, Imzot Luçjani! .....	158

### IV. Tymnajë, Show dhe Kohë e çmendur

Tymnaja e Sulltanit të madhërisëm në Lezhë. ....	165
Show me “seksizëm” dhe... shoqja Lenka.....	168
Debati për kulturën e feve.....	173
Kishë-xhamia në Rozafat dhe “ekstremizmi” imagjinari prof. Xhufit.....	176
Protesta në teatër dhe “teatri” i kryeministrit.....	181
Akti i fundit i dramës “Kur shembej teatri” .....	185

## Kohë e përlyeme

“Se njerzit e shtetit s’janë Shqipnia...” .....	189
Pjetër Arbnori në oborrin e Kuvendit, një mea culpa për politiken ?.....	192
Koha e çmendur... e Stefan Çapalikut.....	195
Rrëfimet e dom Gjergj Metës në kishë e përtej.....	201
“...Se sheklli asht prishë për kah morali” .....	206
Kumti i Atjon Zhitit, si porosi për sot e mot.....	212
Dom Ndoc Nikaj, 30 botime dhe... shtypshkronja “Nikaj” .....	215
Trashëgimia muzikore e Gjon Kujxhisë dhe... qokat kulturore .....	219
Humoristi i të qeshurës së mundimshme, Gjoshë Vasia.....	223



*Parathënie:*

Publicistika e Frano Kullit si shënjuese e dilemave të tranzicionit

Gjatë diktaturës, në lulishten kryesore të qytetit të Lezhës gjindej një ndërtesë përdhese e shëmtuar për nga forma dhe ende më për nga qëllimi. Ajo ishte godina e hetuesisë. Ngrehina e zyrtë u fliste qytetarëve sa me përzhitjen e saj në formë po aq nëpërmjet lajmeve ogurzeza që dilnin s'andejmi. Ndonjë vit pas rënies së komunizmit, si një shndërrim hipostazash, aty u vendos një shtypshkronjë dhe shtëpi botuese me një emër të dashur, rrethuar me keqkuptime të shumta ideologjike, me emrin e Poetit Kombëtar Gjergj Fishta. Kësaj sipërmarrje të guximshme, por edhe shpresëndjellëse i kishte dhënë jetë gazetari i njohur Frano Kulli.

Asokohe student, fillova ta frekuentoj godinen e "mnershme" e cila mbetej aty si dëshmi e vullnetit të njeriut për të bërë keq apo mirë. Franoja qysh tek shenjimi i emrit të Fishtës kumtonte se ç'kishte ndërmend të botonte dhe të relaciononte me lexuesin dhe shoqërinë shqiptare. Fishten të parin e kësaj të gjithë të ndaluarit e mëdhenj të kulturës kombëtare. Nëpërmjet miqsh të përbashkët, paçka se asokohe isha një student, fillova të shkoja aty

shpesh e më shpesh, kureshtar për ata mekanizma të panjohur që shtypnin libra, por edhe përfitues pa pagesë i ndonjë libri të ri që pronari dhe botuesi i ri na i falte me bujari.

Lezha e viteve '90-të kishte ende një bërthamë të rëndësishme shkrimtarësh, intelektualësh, të cilët e çmonin tej mase magjinë e librit dhe që shkonin me dëshirë në "magjen" ku gatuhej "brumi" i tij. Kam patur fatin të njoh disa prej tyre dhe t'i mbaj me nostalgji në kujtesë. Në këso rrethanash jam njohur me Frano Kullin një person tolerant me gjithkënd e për çfardo, por tejet qëndrestar paqësor në mbrojtjen e bindjeve të veta intelektuale e kulturore.

Kulli ishte angazhuar qysh në fillim të viteve '80-të në shtypin e shkruar e shumë më tepër në kapërcyellin e viteve '90-të duke u rreshtuar në krahun e themeluesve të shtypit të lirë e opozitar në Shqipëri, në rang lokal po e po, por edhe kombëtar.

Si botues do të shquhej për kolanen e plotë të veprës së Gjergj Fishtes dhe të tjerëve martirëve të Kishës Katolike, prelatë e shkrimtarë të papërsëritshem të këtij trualli.

Veprimtaria librore e botuese e Frano Kullit i jep Lezhës një mistikë, që shumë qytete shqiptare e kanë humbur në rrugëtimin e tyre tranzitiv. Aty e ndien aromen e librit të sapo shtypur... gjithë atë mister që tekstet bartin, që kur njeriu i shkroi për të rrëfyer veten dhe të tjerët. Por Franoja, mardhënien me librin nuk e ka shndërruar thjeshtë në punë, e cila i siguron jetesen. Jo, do të ishte një këndvështrim shumë reduktiv. Ai ka jetuar kulturalisht me autorët, me librat dhe debatin rreth tyre duke shkruar

vetë për ta, duke i nxjerrë në dritë, duke i prezantuar dhe duke i mbrojtur shkrimtarët e tij të dashur pa ju munguar polemikave të forta, të cilat nuk e braktisin etiken publike.

Po kaq, ditë pas dite e vit pas viti nuk i është shmangur përgjegjësisë së fjalës së shkruar dhe të thënë për çështjet themelore rreth të cilave shoqëria shqiptare ka patur pritshmëri, zhgënjime e shpresa, keqkuptime e trazime, dhimbje e gaz, duke mos i ikur profesionit të parë atij të gazetarit që vërtetë e ka “mik Platonin” por më mik ka të vërtetën.

Në këtë libër që ai po i paraqet lexuesit shkartin betejat e tij kryesore për të gjitha problemet kyçe të tranzicionit. Nga ato të së përditshmes të përmbledhuna në kapitullin “Kokëderrat” e kënaqun dhe “Sokrati i vuejtun” apo të tjera në kreun “Tymnajë, Show dhe Kohë e çmendun” duke i lënë gjysmës së librit atë që ka më për zemër, jo vetëm zgjedhjen krahinore origjinare nga Zadrima, por me gjasë koneksionin me Fishten, të cilit i ka kushtuar vitet më të rëndësishme të kohës së tij e pse jo edhe të kohës që ka përpara përmes bashkëlidhjes me titull “Fishta dhe hijet përreth”!

Në këtë vazhdë shfaqet edhe nëntema e tij që e tërheq kudo e menjëherë pas autorit të Lahutes së Malcisë, ajo që mbase nuk e përlyen krejt ndërgjegjen e shoqërisë, por gjithnjë e më tepër të Franos së pa faj. Me pohimin “Martirët dhe ndërgjegjia jonë e përlyeme” paraqiten një sërë shkrimesh që rrahin raportin e aktualitetit me kujtesen, me martirët, me krimet dhe plagët duke rrahur fort në kudhren e katarsisit moral e kulturor për t’u çliruar nga dogmat, që na janë ngjitur si rriqna, duke gjetë

një terren pjellor në boten shqiptare të këtyre 75 viteve të fundit.

Duhet lexuar ky libër për të kuptuar përpjekjet dhe dilemat që shenjojnë fizionominë e intelektualit dhe shoqërisë shqiptarë të tranzicionit, të atij intelektualit, që betejën e tij e bën çdo ditë, duke tejkaluar paragjykimet e të jetuarit dhe punuarit në “provincë”. Frano Kulli nga Lezha shkruan për opinion kombëtar, nga aty e përthyen universalen në raport me përmasën lokale dhe lokalen e nxjerr nga “banaliteti i së përditshmes”, duke u shfaqur shpesh e më shpesh në organin kryesor të shtypit shqiptar tek gazeta “Panorama”! E bën këtë me kurajo, me insistim, me stil të “imponuar” nga “mësuesit” e tij, të cilët i boton e riboton prej mëse dy dekadash, me dashuri për kulturen si punëtor i saj, me zellin e reporterit si një gazetar me përvojë si një “zadrimor i butë”, që nuk mbyllet në shtëpi pa e thënë të vetën në fund të ditës, atë që ne e lexojmë në mëngjes.

Lezha i ka pasë në zë qysh motit punëtorët e fjalës, të cilët e kanë pasuruar historinë tonë kombëtare me vepra e bëma, në çdo etapë të saj. Gjatë këtyre viteve ka pësuar një zhbërje, një braktisje a mbasë një topitje, por libra si ky i Frano Kullit, tema si këto, mënyrë shkrimi po kaq mbreslënëse, të bëjnë me besue se perceptimi është relativ pse jo edhe i gabuar. Kultura nuk është sasi, as guximi e talenti. Frano Kulli i ka ato dhe është i vetëmjaftueshëm si përfaqësues në zë i qytetit të vet e shumë më tepër.

**Agron Gjekmarkaj**

I.

“Kokëderrat” e kënaqun  
dhe... “Sokrati”i vuejtun





“Kokëderrat” e kënaqun dhe...  
“Sokrati” i vuejtun

Që prijësat e Shqipërisë së çerekshekullit të fundit kanë qenë e janë kokëderra, këtë e kumtoi me buzëqeshje, pak ditë më parë, më i buzëqeshuri... i kryeministrave që kemi pasë, zoti Pandeli Majko. Ndërsa përtej buzëqeshjes, përmes rreshtave të frazës së kumtuar gëlon bindja e tij e fortë se kështu është dashur të jenë ata, kështu duhet të jenë prijësat shqiptarë - kokëderra. Kështu ka qenë dhe kështu është dashur të jetë edhe vetë ai, thotë Zoti Majko e për këtë nuk e fsheh se ndjehet krenar... për veten e për ata që janë e ata që do të vijnë.

Sigurisht metafora e pohuar është lehtësisht e kapëshme prej kujtdo, qoftë edhe fare pak i vemendshëm në këtë tallaz - politikën tonë; sepse kjo ka qenë e është sot e mot bindja siprore e shumicës së shqiptarëve. Sipas kësaj bindjeje e mendësie prijësat duhet të jenë të fortë, më të fortit e njerëzve që ata prijnë. Ata duhet t’u shkojnë deri në fund gjërave që ata mendojnë, gjërave që ata i gjykojnë si të arsyeshme. Arsyen e tyre ata e çmojnë të gjithëfuqishme, ata vetë ndjehen dërgata e vullnetlartit në tokën e shqipeve dhe në të tjerët, grigja e tyre e bindur.

Kjo është e vërteta, ky është realiteti ynë i përditshëm e i përorshëm. "Kokëderrat" tanë vrâjnë e kthjellin, ftohin e nxejnë, të japin punë e të japin bukë, të bëjnë me para a të fusin në burg... E ne "kokëderrin" e thërasim dajë...

*"Qe besa, or burra*

*Nuk di kah t'çajë*

*Mbasi do t'thirret*

*Sod derri dajë...*

*Kam dâ, ta dini*

*Me vjetë t'sivjetit*

*Me u shporrë Shqypniet*

*Me kënë i vetit."*<sup>1</sup>

E "Sokrati i vuejtun", (ai që nuk është në rrethin e parisë së "kokëderrave") merr arratinë. Ikë, ikë prej këtu në kërkim të jetës më të drejtë e më të mirë. Ka shumë, shumë si vetja, që e ndjekin pas. Mbasi e kanë dikuar e shprazë (zbrazur) gjithë neverinë e pezmin për padrejtësinë e korrupsionin, për premtimet e mosmbajtjen e tyre, për mashtrimin e rrenat, për reformat që vetëm përmenden e s'bëhen, për... duke marrë me vete pezmin fatal se ky vend nuk bëhet, ikin. Tani më tepër se asnjëherë të dëshpëruar. Shifrat janë të trishta. Thuhet se rreth njëqind mijë kanë ikur në Europë, rreth dyqindmijë kanë aplikuar ikjen në Amerikë. Në vendin ku akoma nuk ka një numër të publikuar të popullsisë së vendit, (Europë, fillimshkulli i 21-të), në vendin anëtar të NATO-s dhe

---

1 Gjegj Fishta - (Metamorphosis, 1907), vepra 7, Botimet Fishta 2012, fq.35

aspirant për në Europën e bashkuar, kompania e prijsëve, megjithatë nuk mënon të publikojë si një informacion “të rrjedhur” shifrat e të ikurve. Duket si në një moment ngazëllimi për ta ikja nga ky vend e kaq shumë vetëve e aspak si përgjegjësi e bash vetë atyre... Ngjan se prijësit e dëshirojnë ikjen e “sokratëve të vuejtun” dhe kjo është ende edhe më e trishtë. E ndërkohë këtu vijojnë paradat vezulluese të shakasë së arritjeve...

Në fatin tonë të shtetformimit dhe në rrekjen tonë për të ndërtuar sistemin politik të demokracisë, akoma ndjehemi të vonuar. Në kryeherë për shkak të “kokëderrave”... Ndërmjet atributit të qeverisjes me sundimin, prijësit tek ne kanë zgjedhë gjithmonë sundimin. Edhe sot e gjithë ditën Zoti Edi Rama, kryeministri i radhës, që betohet se do të bëjë shtetin, këtë shtet po bën, shtetin e tij dhe të të tijve. E gjithë trajektorja rreth tri vite e gjatë e qeverimit të tij, ligjin dhe rregullin bazuar në barazinë e zbatimin e njëllajtë për të gjithë të qeverisurit vetëm si propagandë po e përdor... E ndërkaq dyzinat e “sokratëve të vuejtun” ikin. Sikur të iknin prej një ishulli të largët të sapozbuluar e jo prej një vendi, sidokudo në Europë, me një qytetrim të lashtë, sidokudo si të Europës, me një trashëgimi kulturore, sidokudo si të Europës, që jo vetëm nuk po çmohet e vitalizohet (jetësohet), por vetëm përbuzet e rrënohet.

*Panorama, 11 shkurt 2016*

Aty ku mbaron e drejta dhe...  
fillon e padrejta e dhunshme

Ne shqiptarët nuk e duam uniformën e policit. Më saktë nuk kemi ndonjë pëlqim të dallueshëm, siç e kanë vendet me demokraci të zhvilluar dhe me shtete të njëmendta ligjore. Edhe pse, sidomos më heret ka pasë djem nga krahina të veçanta që me pasion kanë zgjedhë të bëjnë policin, (punonjësin e rendit dhe të rregullit pavarësisht emërimit) madje e kanë ushtruar atë edhe në cepa e në stepa të perandorive të mëdha, prap se prap ka qenë më shumë zgjedhja e një zeje për të fituar bukën. E njëherësh jo e gjithërespektuar për atë që profesioni i policit është edhe një mision. Gjithnjë, ky ka qenë raporti ynë me mirëmbajtësit e rendit; në rastin më të mirë shpërfillës, anektodik (mjafton të kujtojmë numrin rekord të barcoletave për policët në Shkodër, në kohën e rregjimit), por më së shumti dhe si rregull, neveritës. Kjo është historia jonë e kësaj mardhënie, së paku në 101 vitet e shtetit shqiptar. Të tjerat janë dokrra. Sepse ky ka qenë fundja raporti ynë, i ne shtetasve me shtetin. A nuk janë ndjerë shtetarët tanë këtu, gjithherë disi sundimtarë? Të destinuar për të sunduar tufën e njerëzve të popullit të vet?

Cilido që të shkojë atje molepset shumë shpejt me këtë mendësi, ky është formati, ky është standarti, zanafilla e të cilit përkon me shkëputjen (a më saktë me lëshimin) e Shqipërisë nga perandoria osmane dhe me agun e shtetit embrional shqiptar. Sepse posti i shtetarit tonë shqiptar, ende nuk është posti i njeriut që zgjidhet për të shërbyer detyrën publike, ashtu siç është kudo në botën e vërtetë demokratike. Jo,jo. Shtetari ynë lufton të zgjidhet a të emrohet në një post publik, me çdo mënyrë e mjet sepse e di që po zgjidhet a caktohet si sundimtar. Por... për me sundue një shtet, nuk asht mjaft dhëlpnia, dredhia, intriga, bataqçillëku, rrena, tradhtia: duhet nder, dije, urti, burrni, qe se ç'ka duhet. Po, por dija, urtia, nderi, burrnia, po u zëjshin [mëshoheshin] në shkollë e, madje, me shumë mund e djersë, e jo ndër kafeshantana të Europës e mejhane e paçexhahane të Tiranës, tue luejtë "tavëll" e "bixhoz" e tue pi "mastikë" - shkruan Fishta në "Delikti [delitto-krimi] i Mamurrasit e gjendja e lingatueme [sëmurë] e shtetit shqiptar"<sup>2</sup>

Dhe s'ka sesi të ngjasë ndryshe me policët... Ata të shkretët janë "bira e fundit e kavallit" - shtet... Qarkullojnë këto 22-23 vitet e kinse demokracisë sonë edhe në këtë fushë teori e terma bashkëkohorë europianë e euroatlantikë, madje edhe të shkallës më të lartë demokratike si "policimi në komunitet", për shembull... Dhe kur ballafaqon ndonjë aktivitet promovues (propogandues) të kësaj nisme me realitetin e përditshëm shqiptar, të vjen të... nxjerrësh zorrët, nga thelbi i shpifur i propagandës pa asnjë bosht.

---

2 Hylli i Dritës, 1924/2, f. 73-80

Vetëm në rrugën kryesore të një qyteti të vogël si Lezha, gjatësia e së cilës nuk i kalon 400 metrat, patrullojnë, së paku në 16 orë të 24 orëshit 4 patrulla me nga 2 dhe nga 4 policë. Në secilën patrullë njëri ose dy policë mbajnë dukshëm në dorë nga një bllok gjobash dhe ai bllok të tundet para syve edhe ty qytetarit këmbësorë, që je duke kaluar trotuarit me familjarët tuaj, me nënën, me gruan, me vajzën, me nipin, me mbesën, a me një mik a mike. Asnjë ndjesi miqësore nuk të shkakton kjo pamje, madje të shfaqet si një bezdi, a diçka më shumë... Po kështu ngjet rëndom në të gjitha qytetet e Shqipërisë, në të gjitha rrugët e Shqipërisë, larg qyteteve edhe më shumë; kështu ka ngjarë, herë më pak e herë më dendur për më se njëzet vjet me radhë, (pa folur për kohën e rregjimit të shkuar)...

Lezha, nuk është më më larg se 5 km nga vija bregdetare. Bregdeti ynë është vërtet një resurs i çmuar, për të cilin, për natë e për ditë, ne thurim ëndërra dhe shpresa për ta bërë të bukur e të begatë ashtu siç e kanë bërë të tjerët në anën tjetër të bregut, kudo përreth nesh. Administruesit e vendit tonë të të gjitha niveleve thurin gjithashtu fjalime e patetika të hatashme prej po kaq vitesh dhe zotohen deri në kupë të qiellit se do ta bëjnë perlë rivierën Joniane dhe Adriatikun, Alpet piktoreske dhe krejt Shqipërinë, që Zoti vetë e kishte bërë të përndritëshme. Thonë se po vijnë e do të vijnë shumë turistë. Nganjëherë, turpshëm janë dhënë shifra milionëshe. Por edhe këto, më shumë si dokrra ngjajnë. Cilindo turist që vjen nga Europa, nga perëndimi po edhe nga lindja, nëse ai vjen me makinën e tij, do ta lemerisë, posë njëqind bezdive të tjera edhe denduria e policëve në rrugë, e pakuptimtë dhe e paperceptueshme

## Kohë e përlyeme

për të. Ndërsa atë bllokun në dorën e secilit polic, nuk do të mund e nuk ka sesi ta kuptojë asnjëri prej tyre. Nuk do ta kuptojë se përse vlen ai shuk letrash, që i përngjajshëm me një tufë letrash bakalli (prap dhuratë prej otomanëve), estetikisht shton një detaj më shumë në një portret të shëmtuar surrealist. Që nuk e gjen askund tjetër... Mos shkoni më larg se këtu ngjitur me ne, në Malin e Zi; nga Ulqini dhe deri në Hercegnov, e përgjatë gjithë bregdetit dalmat dhe me siguri, rrallë të zë syri këmbë e kapelë polici rrugës. Dhe rendi e rregulli, ato për të cilat është emetuar kjo krijesë (polici), nuk mund të thotë kush se është më i dobët atje se tek ne, se aksidentet janë më të pakta se atje, në rrugët tona...

*Panorama, 26 qershor 2014*



## Katolikët, martirë ose...të përdorur ?

Në shpërdorjen e rrëmujshme mediatike të fjalës këtu tek ne, ketyre ditëve është lakuar dendur edhe emri i përgjithshëm: **katolik**. Në të gjitha rasat është lakuar, në gazeta, në televizione në portalet e shumta e në rrjetet sociale, duke përmbushë kështu edhe atë hapësiren e mjaftë boshe në të cilën mungon përmendja e tij. Shkaku ishte emrimi i zotit Sandër Lleshi , Ministër i rendit. Dhe njëra prej dy kredencialeve që u lancua si përparësi ishte besimi i tij katolik.

Në të vërtetë, nuk është vështirë të dallohet se vetëm në këto dy mënyra e mbi këta dy kategoritë e përmendura në titullin e këtij shkrimi ka qenë e mundur të ndërtohej një mardhënie e shtetit shqiptar me katolikët e veriut të Shqipërisë, me përfaqësinë më të zgjedhur të tyre, në rend të parë. Në rregjimin e Hoxhës, që përbën gati gjysmën e kohës së qenies së shtetit shqiptar, mardhënia me katolikët u shfaq që heret, në fillësë si një patologji urrejtjeje. Një urrejtje që mbështetej mbi diferenca ideologjike me elitën e katolikëve. Jo veç prej formimit të tyre në shkollime



*Kisha e Vaudejësit e ndërtuar në shek. XIII.  
Shembur në vitin 1969*

perëndimore, por edhe për shkak të mardhënies së tyre dashurore me vendin e popullin e vet. Ata, me bindje të palëkundëshme, përgjithësisht ishin kundërshtarë që në zanafillë të ideve komuniste. Por urrejtja mbështetej edhe mbi disnivele kulturore e prirje qytetrimore të ndryshme e madje krejt të kundërta. Nëse katolikët, elitat e tyre më së pari ishin prirja dhe krahu i oksidentit, vijimtarë në hullitë e herëshme të orientimit të shqiptarëve, prijësit e ri komunistë i kishin ngulë piketat e orientimit të tyre në tjetrin krah, andej kah ishte shfaq “ai dreqi i kuq”. Dhe elita e katolikëve, “fara e zgjedhur”, si me thanë, ishin gjithashtu edhe prelatë të kishës.

Edhe atëherë kur kjo elitë, në ballë të rilindjes së kombit, do të bashkëngjitej natyrshëm me themelimin e me ringjalljen e shtetit shqiptar, megjithatë mardhëniet me prijësat e tij nuk është se kanë shkuar vaj. Jo veç Fishta e Mjeda a Nikollë Kaçorri, që ishin edhe klerikë por edhe Gurakuqi, një gur i randë fort në themelet e shtetit shqiptar e kontribues i paepur i tij, duke qenë kundruall arbitraritet të prijësve u gjend pabesisht i vrarë... Pastaj, një dekadë e diçka më vonë edhe shkollat katolike, ani pse ishin më të mirat e shkollave të pakta të Shqipërisë, u tentua të ndalen e më pas të mbyllen. U mbyllen, në kohën e Mbretërisë e u bë e mundur të rihapeshin mbas një vendimi të gjykatores së Naltë të Europës.

Për prijësit e shtetit shqiptarë, gjithëherë katolikët kanë qenë të padashtun. Shembujt e historisë, e shumta e vertetojnë këtë, kurse të paktë fort janë shembujt që vertetojnë të kundërtën. Në respekt e nderim të së vërtetës do pohuar kjo.

Kurse komunistët dhe prijsi i tyre paranojak, i demonstroi të gjitha mënyrat edhe më monstruozet për t'i asgjësuar "armiqtë" katolikë. Me një strategji të kopsitur e të lidhur me "dredhat e djallit" siç do të thoshte Fishta, të egër e të akullt, sikur të kishte përballë e në kundërshti njerëz "të përtej detit" e jo bashkëkombas të vet, me të gjitha djallëzitë i luftoi deri në sfilitje asgjësuese ata. Direkt me dhunë e egërsi, por tërthorazi edhe me metodat otomaniste, të përdorimit të të vetëve.

Martirët katolikë, Atë Gjon Shllaku, Padre Giovanni Fausti, Atë Danjel Dajani, Gjelosh Lulashi, Mark Çuni,

Qerim Sadiku (katolik në besim), oren e mbrame para pushkatimit, një tjetër katolik, Tonin Miloti, qe caktuar që të dënuarve prej “gjqeve të popullit”, t’ua merrte ai fjalën e fundit...

Aspirant Tonin Miloti qe zgjedhur të formalizonte aktin e pushkatimit dhe në fund të proces verbalit, ai firmosë amanetet e tyre. Proces verbalit, në krye të të cilit shkruhej ende: Vdekje fashizmit-Liri Popullit, anipse fashizmi ishte mundur dy vjet e sa më parë. Qe zgjedhur ai edhe pse qe...zëvendësi i prokurorit dhe jo prokurori vetë.Mbasi prokurori vetë duhej me deomos të qe prej të tjerave krahina. E mbas këtij akti nuk vonon shumë e vetë ky Tonin Miloti, pason fatin e viktimave të veta martire...

Punë kasnecësh e njerëzish të vegjël kjo punë.

Se njerëzit e mëdhenj, rilindës të vërtetë prej të cilëve e kemi Shqipërinë, të tjera sjellje e të tjera kode kanë pasë...Eqrem Çabej, albanlogu i famshëm nga Gjirokastra, në një kartolinë urimi do t’i shkruante lirikut të vlerhtë pogradecar, Lasgushit sqimatar: *Lexova “Lahuten...” e u mrekullova. Jam magjepsuar prej saj dhe jam gati të bëhem katolik prej Fishtës.*<sup>3</sup>

Mardhënia me katolikët e prijësve të shtetit, përposë egërsisë së skajshme e ka pasë edhe këtë dukurinë e ndërmjetme; ka pasë katolikë shërbyes, që në fillesë janë thirrur atje si përfaqësime në zyrat e shtetit, por kjo vetëm sa për dukje (fasadë). Se më pas janë përcjellë që andej pak a shumë me të njëjtin fat, kur shërbesa e

---

3 Pal Dukagjini: *Gjergj Fishta - jeta dhe veprat*, fq.258

tyre nuk ka gjalluar mâ si nevojë. Porse shëmbëlltyrën e deformimit të kësaj mardhënie të katolikëve të veriut me shtetin e ka sjellë të përkryer kryeministri aktual i vendit, zoti Edi Rama. Ai mori në institucionet më të larta të ngrehinës së shtetit, si përfaqësimi i katolikëve të veriut, “katolikë” që raportin e vetëm me institucionet e shtetit e kishin pasë me institucionin e riedukimit, kryesisht. Dhe i solli në atë aulën e shenjtë, siç është parlamenti për një komb të qytetruar. I solli ata në ndejëset e Gurakuqit, të Fishtës, të Mjedës, të Maliq Bushatit, të Hilë Mosit e Riza Danit... Vetëm e vetëm si nevojë përdorimi për pushtetin. Për ta siguruar më së pari atë... Por tani që siguria e pushtetit i është zvetnuar, tani që të dy ministrat e rendit i ranë si “limonë të shtrydhur” shpejt i erdhi në nevojë një... ministër katolik. Kjo cilësi i është përmendur z.Lleshi si njëra prej dy elementëve të qenësishëm të CV-së tij. Bashkëshoqëruar me *background-in* e tij serioz profesional në fushën ushtarake, si dhe një konfirmë të pëlqyeshme të formimit kulturor, çertifikuar prej shkrimtarit tonë të shquar bashkëkohor, Ismail Kadaesë.

Cilësi dhe çertifikata për Gjeneral Sandrin, të cilat kryeministri ynë i ka aty, në zyrën e tij, bashkë me vetë Gjeneralin këshilltar, që prej 5 a 6 vjetësh. Por që, ja tani po rifreskohen.

Thua si nevojë përdorimi për Gjeneral Sandër Lleshin ?

*Panorama, 2 nëntor 2018*

## Ironia e shtetit që do të bëjmë...

Ndër arritjet e qeverisë së tij, në këto tri vite, kryeministri ynë, përmend gjithnjë e më shpesh reformen energjitike. Duke detyruar qytetarët dhe entet private ta paguajnë energjinë, këtë mall të konsumuar, ai krenohet se kështu ka arritur “të bëjë shtet”. Sidomos në reformën në energji. Dhe e vërteta është se energjia, ky mall i konsumuar, tani përgjithësisht paguhet, madje edhe prej atij, që është nën minimumin jetik të standartit të jetesës. Minimumin jetik në Shqipëri, akoma nuk e kemi të përcaktuar. Po, ne jse. E rëndësishme për të bërë shtet është që... energjia të paguhet. E gjithë rëndësishmja, sipas kryeministrit. Kurse për ne shtetasit, përposë kësaj ka edhe një tjetër anë, kjo “medalje”, njësoj të rëndësishme. Sa, e gjitha kjo vjen e na kthehet në pagesve të energjisë dhe të administruesve të saj, si e mirë publike? Në rastin në fjalë, në furnizim të rregullt e shërbim korrekt?...

Po, a njeh kush ndonjë rast që, kur OSHE-ja të ka shkaktuar ndonjë dëm të të ketë dëmshpërblyer?... Tjetër. Në çdo zyrë të shtetit që të trokasësh për çfarëdo shërbimi , të kërkohet edhe një vertetim nga OSHE, sipas të cilit,

detyrimet e tua të pagesave aty janë zero. Dhe për të marrë këtë vertetim pra, që ti nuk ke asnjë detyrim të papaguar aty, me tagrin që kryeministri ynë i jep asaj, OSHE-së së tij (!), ty qytetarit të nevojiten 5 ditë!!!!

Kaq është afati, që Zotëria e tij, Kryeministri i ka akorduar me ligj kompanisë së tij OSHE. Së paku, kështu shkruajnë referencat ligjore në ato vertetimet e lëshuara. Dhe nuk mund ta marrësh gjithnjë këtë vertetim në qytetin tënd. Për këtë copë letër me firmë e me vulë, shpesh do të duhet të bësh disa dhjetra kilometra rrugë për ta marrë në qytetin ku janë të instaluara zyrat rajonale të krijesës kryeministore OSHE. (Nën emërtesën ironike: “Zyra të kujdesit për klientin”!) Bie fjala nga Puka, nga Lezha a nga Vermoshi në Shkoder, nga Gramshi, Cërriku a Librazhdi në Elbasan etj. Kur elektronikisht ky akt mund të kryhej vetëm në disa minuta dhe kështu të plotësohej kërkesa legale e një qytetari legal në Shqipëri. Po folur për absurdin që ai vertetim kërkohet kudo e për gjithçka, thua se nuk ka plot mënyra të tjera për ta vërtetuar pagesën tënde atje ku duhet, natyrisht dhe jo kudo... Një akt i ngjashëm me matrikullimin, që u bëhet kafshëve, si idendifikim. Ndërsa mua më vjen si kujtim i trishtë dhe e përmend publikisht për të disatën herë, rasti i burgimit të një fshatari në Gur të Zi të Shkodrës. Njëri prej shumë rasteve që i paraprinë fillimit të reformës energjitike (!) Ai u burgos pse rilidhi dritat, për të vënë në punë aparatin e shpëtimit të djalit asmatik të shtrirë, të cilat i ishin shkëputur pse nuk i kishte paguar...

Ky është sistemi disbalancues që ka krijuar kryeministri ynë, që favorizon krijesën e tij OSHE-në. Ai i ka atribuar

vetëm të drejta asaj, madje edhe të burgosë qytetarë, por detyrime nuk i njih as nuk i kërkon asaj, kur nuk shërben qytetarët klientë.

Ka patur që në fillësën e vet kryeministrotre, Zoti kryeministër një tjerre filozofike se sistemet qeverisëse të ndërtuara keq, i korruptojnë njerëzit. Gjë që teorikisht rri si e vërtetë, sikundër se sistemet e ndërtuara mirë ua kufizojnë mundësinë e korruptimit zyrtarëve, që duhet të jenë në shërbimin e ligjzbatimit. Por ja ku jemi. Mundësia e korruptimit u jepet me ligj “shtetbërësve” të kryeministrit. Mjafton të marrim në vemendje njëren prej hallkave të të bërit shtet, me të cilën ai është krenuar këto ditë... Furnizimi energjitik - OSHE. Herë tjetër për të tjerat.

Dhe ka këtu një ngjashmëri, lehtazi të dallueshme me “socializmën e parë” të shqiptarëve. Kjo reforma etatiste “për të bërë shtet” nuk e fsheh tashmë synimin për të varfëruar ndjenjën reaguese të qytetarëve, ndaj kastës që e qeveris atë. Më së pari, duke i ndërlidhur ata me shumë fije detyruese me shtetin. Të dhunëshme dhe aspak demokratike. Këto janë metoda e sisteme jo qeverisëse, por sunduese. Aspak demokratike. Dhe për fatin e keq tonin, ne shqiptarët më shumë jemi sunduar se jemi qeverisur. E sotnja është dëshpëruese, gjithë ajo çfarë po ngjet, kaherë nuk ka ndodhur... Dhe njerëzit, pastaj ikin prej këtu. Ikin. Në rrugën më të lehtë për të shpëtuar, nga pajetueshmëria në vendin e vet... Duke rënduar ardhmërinë e vendin të tyre, rënë në dorë njerëzish... pak të përgjegjshëm.

*Panorama, 22 prill 2016*



## Guvernatorët e pafajshëm...

Më së fundi edhe vetë Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, Z. Ardian Fullani e ka thirrur Prokuroria. Këtë e pohoi edhe vetë, në daljen e tij të fundit para medieve ku bëri një deklaratë për mbledhjen e fundit të Këshilit Mbikqyrës dhe shpalli përparimin e ekonomisë sonë. Në të vërtetë ai tha se po bashkëpunon me prokurorinë, ndërsa sipas kësaj të fundit ajo e ka thirrur për ta pyetur, lidhur me vjedhjen që “ka marrë dhenë”, një vjedhje spektakolare që ka ndodhur në atë bankë gati një muaj më parë. Një vjedhje që ka ndodhur nën “guvernancën” e tij dhe prokuroria do ta pyesë... si dëshmitar. Domethënë do ta pyesë se a ka parë a dëgjuar gjë zotërija në fjalë, për një vjedhje të ndodhur rreth e rrotull tij..., aty mu në Bankën e Shtetit Shqiptar. Ky zotërija që nuk është njëri nga ata punonjësit e atyshëm, por është vetë prijësi i tyre, që për nga paprekshmëria ngjan si sundimtari i tyre. Por edhe i yni. Përderisa administron paratë tona, thesarin tonë dhe nuk jep llogari askund për çfarë bën. A e keni vënë re se sa rreth e rrotull i sillen të gjithë prijësat politikë të Shqipërisë, bash ata që e kanë zgjedhur e

rizgjedhur, si rrallë kënd tjetër në këtë vend, opozitë e qeveri bashkë, me një përkujdesje të posaçme se mos e lëndojnë a mos i prishin humorin guvernatorit tonë!!! Gati si një “lule mos më prek”. (Për kërshërinë e lexuesit, lulja mos më prek është një lloj luleje me gjethe të vogla si të mimozës, të cilat kur i prek ulen poshtë, mblidhen e rudhen -FGJSH, fq 1022, Tiranë 1980) Dhe e gjitha kjo ngjet pasi është vjedhur thesari i shtetit. Kurse vetë Zoti kryeministër, një muaj pas skandalit, më së fundi ka dalë të flasë për publikun, ka thënë se edhe ai e dënon vjedhjen e bankës, por guvernatorin nuk mund ta shkarkojë, se gjasme pushtetet janë të ndara e dokrra të tjera kësisoji, që në opinionin publik të shqiptar, të përmendura nga politikanët në tërësi, ngjajnë krejt të pabesueshme dhe tashmë vetëm sa acarojnë. Aq më tepër kur ky opinion kësaj here u shfaq në masë jo të vogël që në ditët e para, madje dikush u përpoq të mblidhte ca firma për të kërkuar, së paku shkarkimin e guvernatorit nga detyra e prijësit të bankës kombëtare. Por kush i pyeti e kush po i pyet ata e të gjithë ne të tjerëve që mendojmë si ata. Ndërsa Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë e votoi ai *en bloc*-5 me 1, “virgjërinë” e guvernatorit, pra qëndrimin e tij në krye të bankës?... Jo një por dy herë dhe pa e parë të nevojshme të bëjë me dije shumicën e shqiptarëve të tjerë se si ndodhi që, duke përdorur çelësat e bankës u vodh paraja e tyre. Shtatëqind e tridhjetë milion lekë, që edhe vetë guvernatori e pranoi. Por ai vazhdon me qetësi guvernancën e tij...

Ngjet rëndom në Shqipërinë tonë kështu, ku jo më shumë se njëzet e ca vjet më parë, njerëzit, domethënë

ne dhe pararendësit tanë, jo thirrreshin në prokurori, por shtyheshin drejt e në burg për më së paku 8-10 vjet, vetëm nëse u “vidhej” fjala nga autocensura e vet dhe dilte nga goja e bëhej e lirë.

Sigurisht kanë ndërruar kohët dhe rendet shoqërore, demokracia është rendi i shtetit të së drejtës. Dhe shteti ka institucionet që e bëjnë këtë në bazë të ligjit. Por edhe në këta njëzet e ca vjet shteti po e bën në mënyrë të diferencuar drejtësinë dhe ky është një pohim i përsëritur, një e vertetë e trishtë. Është klasa e madhe, ajo që përbën shumicën, njerëzit e thjeshtë e të papushtetshëm të së cilës prokuroria dhe gjykatat i trajtojnë, i ndalojnë dhe i dënojnë kur gjykohen fajtorë në bazë të ligjit. Kurse ajo “klasa” tjetër (kasta) e të pushtetshmëve, **gubernatorët** e të gjitha pushteteve në Shqipëri nuk i kemi parë të gjykohen a dënohen ndonjëherë edhe kur akuzat publike e skandalet monstruoze kanë qenë të dallueshme, të dukëshme, të prekëshme dhe thjeshtësisht të vertetueshme, sipas opinionit në shumicë të publikut.

Dhe si në një tymnajë ankohen të gjithë për drejtësinë e padrejtë. Madje me të madhe ankohen për drejtësinë edhe vetë **“gubernatorët”** e të gjitha niveleve, anipse për të gjithë ata së bashku, miq dhe armiq të betuar gjykatat dhe organet e drejtësisë kanë qenë gjithnjë engjëlli mbrojtës i tyre, i të gjithëve pa dallim. Ndërsa me të drejtën e Zotit ankohen ata shumë e shumë nevojtarë që janë drejtuar me besim tek tempulli i drejtësisë dhe ndër dhjetra vite kanë marrë prej andej padrejtësinë dhe zhgënjimin..., duke sjellë në kujtesën e trishtuar shijen akoma të athët të gjyqeve “popullore” të diktaturës, epoka e të cilave

nuk është edhe aq e shkuar... Farsa e tyre shëmbëllen jo rrallë edhe sot.

Edhe për vjedhjen e bankës janë ndaluar e arrestuar disa punonjës të saj, të cilët pandehen si të fajshëm për çfarë ka ndodhur aty. Ndërsa “turmat” e ngritura tani, në tjetër kohë e me tjetër vetëdijësi kërkojnë të dijnë për paratë e pasurinë e tyre, pjesë të së cilës po i gërryen përditë vjedhja dhe korrupsioni i pa krahasueshëm me ndonjë vend tjetër në Europë. Dhe kanë kërkuar thjesht dorëheqjen e guvernatorit të bankës. Sepse u bë një modë e neveritëshme kjo, që për skandale të përmasave kaq të mëdha, të politikanëve dhe administratorëve të lartë, gjykimet përfundojnë... me **pafajësi**. Siç ka patur edhe tjetër gjyq, po për vjedhje thesari (aso here lingota ari), që ka përfunduar me një të dënuar, që e kish vjedhur arin me gomar (!)... një tjetër gjyq të bujshëm po për skandal të madh qeveritar, që ka rezultuar 5 me zero, duke rrëzuar zë e figurë, madje duke shpërfillur edhe një demonstrim nga më të mëdhenjtë të zhvilluar në Tiranë ... e sa e sa skandale të tjerë me korrupsion. Dhe mbi “gërmadhat” e kësaj botës së vjetër është ndërtuar në të gjitha herët pushteti i ri. Kështu ka ngjarë në mënyrë ciklike përgjatë periudhës trazitive të demokracisë, një model ky që ka arritur tejngopjen e vet të neveritëshme, deri në kufijtë e vdekjes së shpresës së njerëzve të këtij vendi. Për të cilën, thuhet se vdes e fundit...

*Panorama, 5 shtator 2014*

## Pse është kuqluar kaq shumë Shkodra?

Nuk është dekoruar ndonjë qytet tjetër në Shqipëri me flamuj e postera, si Shkodra në këtë kohë zgjedhjesh. Ndërsa krahasuar me vetveten, asnjëherë herë tjetër Shkodra nuk është “mbështjellë me kaq shumë beze (flamuj)” sa kësaj here. Kushdo që e viziton, besoj se nuk gjen asnjë përfaqësues me ndonjë qytet tjetër cep e në cep të Shqipërisë. Partitë-koka të koalicionit të qeverisë e kanë kuqëluar kaq shumë Shkodrën, sa ngjan se ajri do të thyhet nga rëndesa e purpurit. Pamja, e të gjitha rrugëve dhe shesheve të qytetit, të krijon një shije të zvargur, që të zë frymën. Gjithçka me tepri, nëse ka ndonjë masë për gjëra të tilla. Së jashtëmi kështu, ndërsa në thelb është një karshillek i paparë herë tjetër, i cili shfaq në vetvete një sfidë të dyfishtë që i bëhet atij qyteti. Një para e madhe që derdhet lumë për propagandë, në ditë të rënduara thatësire të mirëqenies, shfaqur dukshëm në papunësinë në rritje dhe në hollimin e përditshëm të mjeteve të konsumit, së pari.

Por është edhe një trysni e veçantë psikologjike gjithashtu, për një qytet, që në çfarëdo rrethanash e gjendjesh e ka shfaqur në shumë mënyra bezdinë nga pamje, qoftë edhe të përafërta me këto të tanishmet. Shkodranët kanë qenë gjithëherë refraktarë me propagandën edhe në kohët kur kjo gjë paguhej shtrenjtë... Padyshim ata janë qytetarët më antipropagandistë të Shqipërisë, kjo është e gjithëpranuar heret. Dhe bash për këtë shkak, por falë edhe talentit genuin të banorëve të tij, është qyteti me thesarin më të pasur të anekdotave e barcaletave, si mënyra më elitare e talljes me propagandën e propagandistët. Po atëherë, pse pikërisht në Shkodër kjo “mësimje” propagandistike? Çfarë synojnë autorët e kësaj zgjedhjeje?

Asgjë enigmatike e të pamenduar nuk ka në këtë rast. Ndoshta rrokullisja e kundërshtarëve në qershorin e 2013-ës, atëherë në pushtet e sot në opozitë, është shtysa emotive për një sjellje e gjest të tillë, nga prijësit e koalicionit qeverisës; ajo është lexuar prej tyre si fitorja e parë e thellë e tyre, që e ka ndryshuar njëherë e për shumë kohë raportin politik atje në Shkodër. Po nuk është kuptuar aspak, ose së paku kështu lihet të kuptohet se ajo çfarë ka ndodhur atëherë, posë të tjerash... ka qenë edhe një sfidë e bërë ndaj pushtetit të konsumuar përgjatë tetë viteve, sfidë ndaj mbështetjes së dhënë pa kufizim e për shumë kohë prej tyre, për të djathtët dhe të pakthyer meritueshëm, sipas tyre, por edhe për arsye të tjera që janë thënë shpesh... Sfida dhe jo nënshtrimi është pjesë kryesore e njeriut shkodran.

Kanë kaluar dy vjet prej atëhere dhe tani rrethanat kanë ndryshuar shumë. Zhgënjimi është i kudogjindshëm

në Shqipëri e shumë më shumë në Shkodër; vetëm po të sillësh si struci nuk e dallon. Ndaj të propagandosh në këtë mënyrë mrekulli qeverisëse është si të përmendësh litarin në shtëpinë e të varurit. I vetmi arsyetim që të bëhet të pranosh është ai se projektorët e fushatës, me këtë mjet dhe këtë formë që kanë përgjedhur duan të manifestojnë forcën. Forcën që mbart në vetvehte pushteti, pa menduar se përdorimi pa shkak i saj, aq më tepër në qerthullin e një kontrasti të madh mund të sjellë edhe efektin e kundërt. Siç ndodh rëndom me çfarëdo gjesti apo veprimi që nuk ngjit ...

Se kanë ndodhur në këtë qytet manifestime llamburitëse, njëri syresh në përvjeton e parë të pavarësisë, në nëntorin e vitit 1913. U pat lidhur me vargje dritash kumanorja e Kishës së Gjuhadolit me minaren e xhamisë së Fushë Çelës. *Njëzetmijë vetë, pra gadi gjithë banorët e qytetit morën pjesë*<sup>4</sup>...

Ka qenë një simbolikë, natyrisht. Në kohë të tjera e në rrethana të tjera. Po e vetvullnetëshme, ama.

*Panorama, 3 qershor 2015*

---

4 "Hylli i Dritës"- dhjetor, 1913

## “Mbetjet teknologjike” si ofertë...?

Në vitet e fundit të rregjimit të shkuar, kur kolapsi ekonomik qe bërë evident edhe në fushën që i kishte dhënë frymëmarrjen në grahamat e fundit ekonomisë, asaj të industrisë minerare të nxjerrjes dhe përpunimit, me shpirt ndër dhëmbë u ngritën edhe disa fabrika përpunimi të mineraleve, në zonat mineralmbajtëse të verilindjes së vendit.

Në ato fabrika, për nga teknologjia-beterr, si pasojë e izolimit ekstrem dhe pamundësisë për të blerë (me klering-shkëmbim mall me mall) thuajse asgjë nga teknologjitë bashkëkohore, as nga vendet e lindjes europiane, synohej pasurimi i mineralit të bakrit e kromit, që nxirrej nga minierat, të cilat për më se një gjysmë shekulli ishin shfrytëzuar, me lehtësinë primitiviste të shfrytëzimit, të marrim prej tyre ç’ të mundemi sot. Por ja, që tani i kishte ardhë fundi kësaj mundësie sipërfaqësore të shfrytëzimit. Ndaj u synuan mënyra të tjera për të ristartuar atë dhe për të liruar kështu kalatat e portit të Durrësit prej stokut të mineralit, grumbuj me më shumë dhé se mineral, akumuluar ndër vite, si pasojë e ndërprerjes thuajse të



plotë të mundësisë së eksportit të tij, që për disa vite kishte qenë oksigjeni i ekonomisë së mpakur vafëruese të vendit....

Këto “novitete”, udhëheqësi komunist i atëhershëm i cilësoi si “burma” të mekanizmit të ri ekonomik, që nisi të trumpetohej si propagandë dhe si praktikë e re administrimi, nuk e ndaluan theqafjen drejt greminës, të asaj ekonomie, e cila nuk prodhonte më shumë se bukën thatë dhe prasin (purrinin i thonë në Shkoder), por që për fat e stopoi ndryshimi demokratik i sistemit të kalbur, që sollën erërat e lëvizjeve të tilla në mbarë europën lindore...

Fabrikat e pasurimit, këto mbetje teknologjike që u propaganduan si risi e “socializmit me forcat tona” ishin arnimet e fundit të ekonomisë së shqyer në atë farë feje sa



*Rruga Tiranë-Romanat (Durrës) 1994*

s'kish ku të vije më as arna përmbi arna u sollën si ofertë zhvillimi, që sipas poseduesve të saj do të ndalte kolapsin, i cili, tashmë kishte ndodhur... Njerëzínë e këtushme e kërcënonte uria, pa folur për stadin e lirive të njeriut, të cilat ishin të përjashtuara nga sistemi, që në zanafillen e vet, në mbarim të luftës së dytë botërore dhe tani kishte arritur në finishin e vet rrënimtar.

1.

Edhë këto ditë, përgjatë një muaji, Ministri i sotçëm i Energjitikës, ishte në njërën prej zonave më mineralmbajtëse (me krom) të vendit, në Dibër. U ngul atje, siç mundëm ta shihnim, falë teknologjisë së përkryer të informacionit, për shkak të një palë zgjedhjeve lokale jashtë radhe, që i provokoi njëri prej shtetarëve provincialë brekëgrisur... Edhe ai, duke synuar, të ndërtojë "fabrika" pasurimi. Veçse jo të pasurimit të kromit; për atë gjë, unë nuk e di të ketë folur ndonjëherë të vetme, zoti ministër. Ajo punë është zgjidhur me konçensionet me të cilat po administrohen minierat, sipas qeverisë së tij, të cilat, posë të tjerash bëjnë kurban jetë minatorësh, nevojtarë të raskapitur, prej skllavërisë moderne të koncesionarëve. Por ai ka folur e vepruar me ngulm për të përsosur teknologjinë e sundimtarisë së tij moderne atje. Ndanë e rreth parcelave të mbjella me kanabis ai u kumtoi më se njëherë fshatarve e qytetarëve të Dibrës se, vetëm po votuan partinë e tij do të kenë si dhuratë fonde. Fonde... po për çfarë, për modernizimin e teknologjisë nxjerrëse të mineralit atje, për të shumëpërmendurën "Rruga e Arbërit", që do të ishin vërtetë jetike për t'i nxjerrë nga

mjerimi i skajshëm ata njerëz? Por që janë e do të ishin edhe një aset strategjik për ekonominë kombëtare. Jo, jo, gjëra të tilla nuk rrokin as vëmendjen e jo se jo interesat e zotit ministër. Atij nuk i interesojnë e as nuk i duhen këto, atij i duhen vota për të siguruar poziten e tij, për të përforcuar sundimin e tij dhe të tijve mbi këta njerëz e të mbarë shqiptarëve të mbetur këtu, nga klani a sekta i tij, që quhet parti. Dhe për të sunduar njerëz, për të sunduar një shoqëri e një popull, parakushti i të gjitha kushteve është ta lësh të varfër e ta varfërosh përditë e më shumë atë. Kjo është e njohur në kufinj të aksiomës. Është shumë shumë më e lehtë për një qeveri, e cila vjen si sundimtare, që në vend të ndërtojë strategji për zhvillimin e resurseve pasurore, siç janë në Dibër, bie fjala minierat dhe pyjet të sugjerojë e menazhojë mbjelljen e kanabisit të magjishëm. Sepse sundimtarët në këtë rast kanë dy përfitime të magjishme gjithashtu, prej bimës vdekjeprurëse por që sjell shumë para, progresojnë gjeometrikisht pasuritë e e tyre të pamundimta. Ndërsa kultivuesit - sklevër, me lugën bosh në duar i varfërojnë edhe më shumë, duke i ndërvaruar edhe më shumë tek pasunarët sundimtarë. Për rrjedhojë edhe i sundojnë më lehtë... *“Kështu do politikanë të patënzonë, [të pafé-këtu të pamoral] tue dashtë me gëzue sa ma shumë n’ket jetë, u leverdisë që ligjet e shtetit të vendosen, pa marrë parasysht aspak ligjet e Zotit e ligjin e natyrës; pse për me ba qejf në këtë jetë duhet me jetue në shpinë të tjetërkujt, prandej me marrë financën e shtetit n’dorë e me mbajt rob popullin, për me e ba me punue përdhunë e mos me e lanë me çue krye, për*

*me lyp të drejtat e veta...*<sup>5</sup> - do të shkruante Gjergj Fishta 93 vjet më parë...

2.

Qasja më duket se i shkon sistemit të sotëm politik, funksionimit të partive si mekanizmat lëvizës të sistemit demokratik, në stadin e tanishëm. Prej kohësh është konstatuar prej politologëve dhe prej analistëve të vëmendshëm të korrenteve të politikës, se sistemi i partive këtu është në kalbëzim, në gjendjen e sotme ato janë mekanizma të ndryshkur, që prej kohësh kanë degjeneruar prej misionit të tyre nismëtar të fillimit të pluralizmit politik në fillimvitet '90 të shekullit që shkoi. Interesat e tyre janë larguar tejet larg interesave të popullit; duket se ato shërbejnë interesat e vetëm një grushti "rriqnash" pushteti, që kapërcejnë sa në njërën palë vithe tek të tjerat e pushtetit. Ato i inspirojnë pak, shumë pak njerëzit. Sepse të përshpirtshmen e ka pushtuar paraja, besimi ka rënë shumë, ndaj dhe vota shitet... Dhe lirë, në këtë farë feje. Dibra na rikujtoi se kemi kapur fundin e së keqes. Ndaj dhe është gjithë ky desiluzion, ndaj dhe njerëzit ikin prej këndej dhe duan përditë të ikin.

Barra e ringritjes së shpresës së bjerrur, i bie opozitës. Për të cilën, herë tjetër do të shkruajmë më gjatë.

*Panorama, 16 shtator 2016*

---

5 *Hylli i Dritës, "Ipushkvojte e Shqipnisë e çashtja e zgjedhjeve"1923/12,fq.529-538*

## “Njollat e murrme” të kryebashkiakëve

“Njollat e murrme” ka qenë titulli i një drame të shkruar nga Minush Jero dhe vënë në skenën e teatri “A.Zako Çajupi në Korçë nga regjisori i përmendur shqiptar Mihallaq Luarasi, aty rreth viteve ’70. Shfaqja e parë u ngrit në qiell dhe qëndroi ashtu pezull sa një flakë kashte se të nesërmen kur e pa udhëheqësi, ajo dhe lavdia e saj u zhytën “shtatë pash nën dhé” kurse autori dhe regjisori, gjithashtu nuk vonoi dhe u zhytën në galeritë e tmerrshme të Spaçit e Burrelit... Dhe bashkë me to u fshinë edhe “njollat e murrme” nga historia e teatrit, siç fshiheshin të gjitha njollat ideologjike në terrin e tmerrshëm të diktaturës...

Titulli i dramës fatkeqe vjen si bashkëshoqërim me njollat e hartës së Shqipërisë që kanë murrëtyer territorin shqiptar sot, kur pas zgjedhjeve të reja, prijësa të ri vendor, përgatiten për një start të ri qeverisës. Nëse shfaqja e teatrit asokohe u dha vetëm një natë, njollat territoriale të hartës së Shqipërisë kanë ardhur e janë shtuar e shumëfishuar kohë pas kohe, përgjatë mëse njëzet vjetëve dhe “autorët” e tyre, prijësit e njëjësive vendore të deritashme që kanë qenë

385, jo vetëm rrojnë të lirë e të qetë, po shumica e tyre janë ndër pasunarët e shënuar të këtij vendi... Sadoqë, shumë syresh janë qortuar nga opinion publik për korrupsion dhe dëm të shkaktuar interesave të komunitetit. Por mbi të gjitha për keqtrajtimin më të egër të territorit veçanërisht. Sado që ka patur edhe ndonjë proces hetimor e gjyqësor për mëkatet e prezumuara të tyre, gjithëherë ata janë përcjellë me pafajsi dhe kanë vijuar, jo vetëm të jenë qytetarë të lirë, por edhe si kryeqytetarë me dy, tre e katër mandate qeverisëse në kry të qeverisjes vendore.

Tani, numri i tyre është pakësuar më shumë se gjashtë herë dhe kjo është konsideruar reforma më e mirë e të gjitha kohëve ndërkaluese (tranzitore), qyshsekur në Shqipëri u rrëzua diktatura komuniste dhe u shfaq demokracia si sistem politik edhe i shoqërisë shqiptare. Veçse “njollat e murrme” kryebashkiakëve hedhur në formën e betontë të pallateve shumëkatëshe, krejt vend e pa vend, janë aty. Dhe nuk dihet se si e se kur mund të shlyhen ato ndonjëherë prej gjithë asaj që përbën veshjen urbane të territorit të Shqipërisë.

Qytetet shqiptare nuk kanë të ngjajshëm të tyre në Europë, për nga dendësia e betonizimit dhe pakësimi me progression gjeometrik i sipërfaqeve të gjelbërta. Tirana, së pari, kryeqyteti ynë. Disa prej kryetarëve të rinj janë të rizgjedhur për të dytën, për të tretën a për të katërtën herë. Ideatori i këtij projekti dhe i reformës së centralizimit e reduktimit të numrit të njësive vendore, zoti Edi Rama, tani është kryeministri i Shqipërisë. Dekorativën e vetakorduar për këtë mrekulli ai ka nisur ta ekspozojë saherë që do të shpalosë paradën e tij të sukseseve qeverisëse.

Por, referuar opinionit publik e medieve, ka qenë vetë ai edhe arkitekti i betonizimit të Tiranës, si kryebashkiak i saj. Po a do të mundet tani ai, kryeministri t'i shlyejë "njollat e murrme" të betonta e ta çlirojë territorin nga ky sindrom mbytës? Natyrisht një kërkesë si kjo është përtej kufijve të utopisë; është njëlloj si të kërkosh t'i bëhet transfusion gjaku, një të sëmuri në kóma. Po ta stopojë të keqen, po mundet. Dhe në vitin e parë të qeverisjes që kryeson u duk se do të fillonte ta bënte korigjimin e mënxyrës territoriale. Shenjat se do ta bënte këtë i pati dhënë, madje edhe në formën e tyre më kurajoze e më të egër, në formën e tritolshpërthimeve. Në Jon në Vlorë, në Pogradec, në Tiranë. Pastaj shkoi edhe në një fshat të Tiranës e shembi edhe atje një stallë lopësh, ndërtuar pa leje. Në ndërkohë shpalli një moratorium, teksa vijonte legalizimet duke i dhënë tapitë me duart e tij, duke recituar me emër e mbiemër të legalizuarin, përcjellë me batutën a romuzin e rastit. Po nuk ndaloi në Sarandë, Himarë e gjetkë në "sarajet" e miqve dhe kështu... kush deshti që me njëtin e mirë ta lexonte reformën territoriale edhe si një "mea culpa" të ish kryebashkiakut të kryeqytetit, tani kryeministri rishtar, pati rastin të zhgënjehet shpejt fort. Ndaj nuk qe as nuk është e habitëshme, as e papritur gjithë ajo ç'farë ka ngjarë e ngjet përditë e përnatë këtu e këndeje, sidomos para nisjes së fushatës zgjedhore, por pa u ndalur edhe tani. Mjafton të dëgjosh uturimën e trajlave e betoniereve në Shëngjin edhe në ora dy të natës apo , mjafton të shikosh tabelat me afishe ndërtimtarie shumëkatëshe, kudo përgjatë vijës bregdetare dhe njëherësh të shfaqet si asosacion (bashkëshoqërim)

## Kohë e përlyeme

shembja e kioskave të Lanës në fillimvitet 2000 dhe shumë shpejt pas tyre ngritja e qiellgërryesve që i kanë marrë frymën Tiranës. Autori, regjisori, producenti i farsës... vetë arkitekti është i njëjti. Është ai që ishte...

*Panorama, 25 korrik 2015*



## Punë plehnash...

Tani e më pas, duke filluar nga seanca e fundit e Parlamentit të Republikës, mbajtur në njërën prej ditëve të dhjetëshes së tretë të shtatorit, secili prej nesh, në derën e shtëpisë së tij do të ketë edhe një grumbull plehnash më shumë, në secilën metër katror të mbitokës e nëntokës, do të ketë edhe një grumbull plehnash më shumë, në ajrin që thith, secili prej nesh, do të thithë edhe ca më shumë gazra helmues plehnash se ç'kishte thith deri tash. Sigurisht nuk bëhet fjalë për plehun organik, me origjinë shtazore a njerëzore, i cili është jetik për bimët e lulet, për pemët e frutat dhe që mban gjallë gjithë ekosistemin tonë. Jo, jo, për fat të keq ai ka ardhë duke u paksuar ritmikisht vit pas viti, sidomos qyshkur shkenca i ka servirë prodhimin të frutave e perimeve sistemin hormonal të zhvillimit të shpejtë, i cili e ka zëvendësuar sukseshëm mënyrën klasike - bio të rritjes së tyre... Bëhet fjalë për të importuar mbetje teknologjike, jashtëqitje industriale të Europës.

Kjo është prurja më e re, që udhëheqësia jonë e ardhur mes nesh tre vjet më parë, pas një milion shuplakave tonat, që shporrën udhëheqësinë tjetër, para kësaj...

Në të vërtetë u pa qysh në fillësë se kjo udhëheqësia e re, me punë plehnash do të merrej më së shumti, sepse edhe bekimi i saj prej mendjendriturve të panumërt që ka kjo Shqipëria jonë, i tillë qe. Iu bë thirrje shqiptarëve independentë (më së shumti independentë nga vetvehtja e tyre...!), që të mblidheshin të gjithë plehnat, pa dallim feje, krahine dhe ideje, prej Skraparit e deri n' Shkoder, për të shporrë prijësit e vjetër e për të sjellë plehna të rinj. Dhe pastaj ata, triumfatorë siç erdhën i premtuan rilindjen shqiptarëve, të cilët, deri asoherë paskëshin qenë në agoni e gjysmë të gjallë... Më së pari, do ta bënë këtë, duke i liruar prej plehnave shqiptarët.

E djeshmja na kujtoi se ndër vendimet e para të kësaj qeverie ka qenë edhe ai që ndalonte importin e mbetjeve... Na kujtoi, gjithashtu parakalimin triumfal të zotit kryeministër, i cili kumtoi zbrapsjen e një ligji që paska pasë lejuar eksportimin e pikërisht të këtyre soj plehnash. Ndërsa dje, 63 a 64 copë deputetë të Kuvendit të Republikës vendosën të sjellin, pa kufi, mbetje nga Europa. Dhe meqenëse mbetjet do të vijnë nga Europa, propaganda, kjo zeje e shkëlqyer e vetë zotit kryeministër dhe ndoshta e vetmja e shfaqur deri tani, kërkon mosbëzajtje publike këtu, nisur nga afeksioni gati në ektazë që shqiptarët (independentë...) kanë për Europën. Le të helmohen ata, le të kenë edhe më pak oksigjen në ajrin që thithin, fundja le ta hanë barin të thatë, tharë prej landfileve të panumërta që do të mbijnë në vend të barit. Se kjo ju vjen nga Europa që duan. Me bekimin e prijësve të tyre, që gjithashtu i duan - shprehet ritualisht, i pari i udhëheqësve.

Pa do të pasurohen edhe më shumë, me këtë rast.

-Rreth 120 milion euro do të përfitohen prej plehrave -kumtoi zotëria e tij, kryeministri. Prej shumimit të plehnave, prej mpaksjes së oksigjenit dhe prej shtimit të helmit, në lëkurë, në trup e në gjak, ekonomia e tyre do të inkasoka (arkëtoka) një shumë të tillë të lakmuar. Se që ajo të rilindë, edhe pse prej ardhjes së triumfatorëve vetëm ka rënë e po rrenohet përditë, u dashka bërë edhe kjo!... Po kush do ta mbrojë këtë njeriun shqiptar këtu, prej helmimit të trupit, të gjakut dhe të ajrit të tij? Atë njeriun që këta duan ta pasurojnë me plehna dhe helme? Kush do t'ja kufizojë ndikimin e këtyre agjentëve jetëshkurtues, banorëve të këtij vendi? Do të mund ta kufizojë qeveria, thua, oreksin e pamatë pastaj të atyre fabrikave ricikluese për të sjellë sa më shumë plehna?...

Trajektorja trevjeçare e punëve të qeverisë sonë udhëheqëse (qeveritë tona janë dhe kanë qenë gjithmonë më shumë udhëheqëse e më pak, fare më pak qeverisëse), ka filluar dhe po mbaron me plehna. Plehna, që së bashku me kanabisin e mbjellë në të gjithë territorin, synojnë ta propsperojnë Republikën tonë!...

Athua, vërtetë ne shqiptarët këtë meritojmë?

*Panorama, 24 shtator 2016*

## Kapela e Nastradinit dhe... fushata e burgimeve

Barcaletat me policë në kohën e rregjimit edhe pse për to ska pasë e s' mund të kishte statistikë, me siguri mund të pohohet se kanë qenë më numerozet e këtij zhanri të komunikimit. Po të huazohej një term i medies së sotme të rrjeteve sociale ato kanë qenë më të "klikuarat" (lexo: më të treguarat). Po sjell një rën prej s' di sesave prej tyre : ...Nastradini po ecte rrugës nëpër qytet me një shok. Para Degës së Punëve të Brendëshme i bie kapela nga era. Nastradini, në vend të ulej e ta merrte, bën sikur nuk e shikon e shpejton hapin. Shoku, që po shëtiste me të ulet e merr kapelen dhe i thërret me zë të lartë Nastradinit. Nastradini nuk ishte larguar aq sa të mos e dëgjonte zërin e shokut e megjithatë nuk e kthen kokën. Shoku shpejton hapin e dikur e arrin.

-Qe merre, i thotë, mirë se nuk e ndjeve kryet bosh pa kapelë, po hapin pse e shpejtove?

-Budallá - i kthehet Nastradini shokut - deri sa të merret vesh se e kujt është kapelja aty ku ra, kushedi sa shkopinj han Nastradini...

Barcaletat e kohës së diktaturës kanë qenë mënyra e komunikimit ndër qytetës, kanë qenë zëri alegorik

në mungesën totale të lirisë së fjalës. Kjo është thënë e stërthënë. Frika, por shumë më e madhe neveria; kjo ka qenë ndjesia në përgjithësi e njerëzve për organet e rendit, që asokohe quheshin legalisht organet e diktaturës... Nuk ka qenë më miqësore kjo mardhënie as me xhandarin e kohës së mbretërisë, as më herët në vitet e para të shtetit shqiptar. Sepse ka qenë me prirje më shumë sunduese sesa qeverisëse mardhënia e qeverive shqiptare me të qeverisurit e vet. Gjithherë ka ngjarë kështu.. *Turku, si qeveri, as ka rrahë shqiptarët me dajak, as ua ka ndry gratë ndër kala. Po, por satrapët e Shqipnisë - njerëzit e Qeverisë sonë, posë [përveç] se shqiptarëve ua kanë rjepë deri shpirtin me taksa e pagesa e me plaçkë, i kanë rrahë në dru, e gratë me djepa ua kanë bartë prej kresë (kreut, këtu veriut) së Shqipnisë e ndry ua kanë në kala të Gjinokastrës, si të kishin qenë robina otentotësh [ottentotto-it. njeri i pagdhendur, këtu njerëz të egjër] e jo nana shqiptarësh të lirë Prandej populli shqiptar nuk ka besim në Qeverinë e vet dhe sot e mban për hasëm ma të rrezikshëm, se pati mbajtë dikur qeveritë e hueja.*<sup>6</sup> - thotë Fishta nëntëdhjetëedy vite më parë, aso kohe deputet në Parlamentin shqiptar. Edhe qasja që po shfaqet këto ditë dhe kredoja e kryeministrit është e ashpër, e fortë, ultimative. Do të burgoset 3 vjet dhe 5 vjet kushdo që vjedh energjinë elektrike, ka deklaruar ditën kur ka shpallur këtë fushatë. U është drejtuar kështu rreth 600 mijë shqiptarëve, pra diç më shumë se një të katërtës së popullsisë, që ai dhe qeveria e tij i ka në një listë hajnash të energjisë elektrike.

---

6 *Hylli i Dritës, 1924/2, f. 73-80*

Vjedhja e energjisë është me të vërtetë monstruoze. Edhe mall pa zot të ishte nuk mund të vidhej më shumë. Për rreth 25 vjet është kështu. Kurse këto ditë atmosfera mediatike kumbon me egërsinë e lajmeve me arrestime, thua se asgjë tjetër nuk ndodh në Shqipëri, thua se e gjithë kjo vjedhje mbytëse e ekonomisë publike zbriti rrufe në qiellin e pastër tani, athua se ky nuk ka qenë problemi i trashëguar, athua se këta qeveritarë nuk janë në krye të punëve prej më se një viti. Dhe me siguri në këto shifra, të shpallura deri tani nuk futen as ata që teknikisht bëjnë lidhjet e paligjëshme, pra “sekserët” e hajnisë, që edhe sipas kreut të grupit parlamentar të socialistëve në pushtet janë shumë. Këta, ndryshe nga ata të mësipërmit janë rrogatë të shtetit, të kompanisë shtetore. Ata, duke u rrogëtuar me paratë tona, bëjnë ortakërinë e vjedhjes, e cila pa ndërmjetësinë e tyre nuk do të kishte qenë tamam kaq sa është... Po fushata ka filluar e po vazhdon me ata të tjerët, hajdutët e xhepave si me thënë, ata më të dobtit e të pambrojturit. Ata që nuk janë të qeverisë.

Burgosja, aplikimi i nenit më të ashpër të ligjit është zgjedhur për këtë fenomen, i cili për opinionin shumicë në Shqipëri është ai që, me të vërtetë po e gërryen ekonominë publike. Sigurisht dënimi i fajtorëve, në bazë të ligjit, në këtë rast i vjedhësve, por edhe shpërdoruesve e abuzuesve gjithashtu, është mënyra më e drejtë dhe e saktë. Qeveria për këtë është, për të mirëadministruar pronën publike, por edhe për t’u përkujdesur për të drejtat tona. Kurse forma që po përdoret me bekimin e kryeministrit, ngjan arbitrare. Nëse e ka hak dënimin ai që nuk e paguan energjinë elektrike, ata dhjetrat a qindrat e kilovatëve,

jo më pak e ka hak ai faturisti a elektrikisti që lidh telat jashtë matësit (kundrejt rryshfetit, kuptohet). A nuk do të qe më e udhës të shkurttoheshin disa qindra nga ata faturistët e në vend të tyre të vendoseshin ca matësa të tjerë bashkëkohorë, që janë më të pakorruptueshëm se faturistët ?! Ashtu siç është për shembull ajo karta e celularëve, në të cilën kur të jenë mbaruar lekët njëherësh të janë mbaruar edhe impulset... Edi Rama për këtë është zgjedhur, për të bërë shtetin ligjor, shtetin e mirëfilltë ku në adresën e saktë të shtëpisë, bashkë me të gjithë posten tjetër të të vijnë edhe gjobat kur i ke marrë me të drejtë ato dhe t'i paguash mundësisht on-line, shtetin e qarkullimit rrugor me semaforë e jo me dyzina policësh që të trysnojnë vetëm me pamjen e shëmtuar kur i sheh rrugëve ndërlihdhëse e qendrave të qyteteve, shtetin e rendit e të ligjit dhe jo të tangarllëkut të ministrit të brendëshëm. E kështu reforma do të ishte edhe më pak luftarake me burgje e të burgosur, ajo shifra e humbjeve do të pakësohej patjetër shumë dhe nevoja e shtetit për të blerë energji me valutë do të pakësohej edhe më shumë.

Po a është ky interesi i njëmendtë i vetë qeveritarëve tanë, të cilët janë në këtë rast ata që prokurojnë fondet publike për këtë blerje? E vështirë për tu besuar... Luigj Gurakuqit, ministër financash, në çastin e fundit të jetës në Bari të Italisë, me 2 mars të 1925-ës iu gjetën 350 lira në xhep dhe një... listë borxhesh ndër miq.

A ju duket ndonjëri prej ministrave të sotëm sadopak i ngjajshëm me të ?...

*Panorama, 6 nëntor 2014*

## Skandalet e prijësve si dhunë pushteti

Nëse do të kishte një "zë" të besueshëm në statistikat e shtetit për skandalet, në javën që mbyllet, besoj se denduria e skandaleve të pushtetit ka qenë më e larta e shumë viteve. Skandalet kanë qenë jo vetëm të shumtë në numër, duke mos lënë thajse asnjë ditëpolitike jo skandaloze, por edhe për nga "brumi" kanë qenë skandale shumë të rënda. Kryetari i kryebashkisë, rrethon gjykatën përpara një procesi gjykimi për punët e tija, drogë që hyn e del nga toka, nga deti e nga ajri, përfolur e dyshuar si e komanduar nga zyrat e shtetit, në Policinë e shtetit hyn e përdoret një paisje përgjimi të kundërligjeshme (e dyshuar si e tillë nga Prokuroria e shtetit), një deputet i spikatur (shkrimtar) kërcënohet e shantazhohet halabakçe nga një zyrtar lokal... dhe në burg përfundon, një zyrtar seksoman i provincës. Ndërkohë dy fëmijë kanë humbur jetën në një aksident, rrugës për të takuar të atin e burgosur, dënuar për shkelje ligji të ndërtimit pa leje të strehës së këtyre fëmijëve. Një aksident që si shkak ka, prap një akt korruptiv të një zyrtari të lartë.

Deputeti i kërcënuar, Zoti Ben Blushi e deponon kërcënimin në aulen e parlamentit; aty janë deponuar e



deponohen edhe të gjitha skandalet e tjera. Po në atë sallë, në sallën e zanafillës së ligjeve që drejtojnë Republikën, asgjë tjetër nuk ka ndodhë përveç pohimit të skandaleve, pasuar prej korit të sharjeve të ndërsjellta, që me i “pasë randë edhe rruga”. Tallëse dhe cinike, pa kurrfarë nderimi për republikën e as për popullin. Dhe kaq. Askujt prej tyre nuk i hyn ferrë në këmbë. Askush nuk gjykohet e jo më të dënohet, nga ata. Kur, më së paku vetëm me dendurinë e skandaleve të pohuara këtë javë, pa ripërsëritur se për përbërjen e atij parlamenti është miratuar ligji unikal, i pakundgjendshëm në vendet demokratike, ligji i dekriminalizimit, ai parlament sot ka mjaftueshmërisht arsye për të qenë i shpërndarë. Më së voni sot, kur edhe ka filluar të zbardhet lista e të vetëdeklaruarve si të dënuar nga gjykatat e huaja (dihet, mjaft më të besueshme se tonat) dhe gjykatat shqiptare.

Por kjo nuk ka ndodhë e as ka gjasë të ndodhë; këtë statukuo (gjendje ekzistuese) politike e mban gjallë një pakt i heshtur dhe tinzar, i cili e ka rrënuar shpresën e shqiptarëve. Ekonomia drejt theqafjes dhe cilësia e jetës qytetëse në teposhte (tatëpjetë), qeveria, që në vend të ardhurave për frymë ka shtuar friken e burgimit, në vend të drejtësisë e barazisë përpara ligjit, ka rritur me progresion gjeometrik diferencimin e një grushti pasunarësh të dyshimtë e pushtetarësh të korruptuar, të parekshëm prej ligjit dhe së drejtës, këto e të tjera e kanë bërë të frikëshme të ardhmen e shqiptarëve që duan të jetojnë këtu...

Do të shkruente e do të fliste njëri prej deputeve në shenjë të parlamentit të 1924-ës, Gjergj Fishta: “...*Qeveria*

## Kohë e përlyeme

*shqiptare, me faj të vet ka lanë me u prishë urat e rrugët, ka ba zyret çerdhe klikash e intrigash e shkollat agjenci propagandash e partish, e ma teper me taksa e tatime të paarsyeshme ka shue tregun e fikë popullin; sheh po k'to punë populli shqiptar e me zemer të plastë do të rr'fejë (rrëfejë) se, asnji qeveri e hueja, posë Serbisë, nuk i solli ma dam Shqipnisë se vetë Qeveria shqiptare, n'dashtë t'ia ketë ngjitë vehtes **atdhetare**, n'dashtë **kombtare**, n'dashtë **okcidentale** (perëndimore)...”<sup>7</sup>*

Rrethi ynë vicioz, nëpër të cilin qarkullon e shkuara, po edhe e sotnja, njësoj, është e frikëshme... Edhe sot, si 90 vjet më parë. Mosbesimi i i njerëzve tek politikanët e shtetarët skandalozë, ka plot arsye të cilat shtohen përditë. Bashkë me qeverisjen është korrumpuar edhe sistemi i lirisë së zgjedhjeve, ngjizja e forcave të reja shpresëndërtuese duket e vagëlluar aq sa mposhtja e së keqes që na ka pushtuar, duket mision i pamundur...

*Panorama, 26 maj 2016*

---

7 Hylli i Dritës, 1924/2.fq.74

## “Punë krajlash” ... punë hajnash

Përposë katër dekoratave shumë të larta që Gjergj Fishta ka nga të huajt: “Mearif, kl.II, 1912”, akorduar prej Qeverisë Osmane, “Ritterkreuz, 1912” prej Austro-Hungarisë, prej Papa Piut XI “Medaglia di Benemerenza, 1925” dhe prej mbretit të Greqisë “Phoenix”, 1931, të cilat figurojnë në jakën e zhgunit të fratit, në një foto të vitit 1932, është edhe një tjetër që pak është e njohur dhe rrallë përmendet... *Ka qenë një dhuratë e shtrenjtë prej Krajl Nikollës së Malit të Zi: një komplet (lugë, pirun, thikë) prej ari, që Fishta e mbante në një vend të dukshëm të dhomës së tij në Kuvendin e Gjuhadolit dhe kishte dëshirë t’ua tregonte miqve, duke shtuar, jo pa ironi, se “këto janë punë krajlash” ...<sup>8</sup>*

Ironia që Fishta përdor edhe për një dhuratë të çmuar është, posë të tjerash edhe një ekstrat i asaj mardhënie që ka ekzistuar në atë periudhë të historisë me Malin e Zi, fqinjnin tonë lakmitar verior, mardhënie, shpesh e mbrujtur me pabesi e mosbesim... Po që një elitë shqiptare atëhere, atdhedashës të mëdhenj, të cilët çmoheshin shumë edhe nga të huajt, anipse këta të fundit, herë armiq në

---

8 Tonin Çobani, “Koha Jonë”-14 qershor 2015

potencë e herë pushtues, nuk i donin as ata e as vendin e tyre, domethënë Shqipërinë tonë. Megjithatë, ndër konflikte sipërore ka patur edhe çaste paqeje. Paqja dhe prosperiteti i Shqipërisë, në radhë të parë; ky ka qenë edhe vokacioni shpirtëror i njerëzve tonë të ndritur dhe atë e kanë shërbyer në plotpërputhje me normat e sjelljes së qytetrimin europian.

Sot jemi gati një shekull më vonë, më se një shekull që kemi shtetin tonë shqiptar dhe e gjithë ajo ç'farë përbën mardhënien tonë me shtetin vjen si... punë hajnash. Ne vetë, tashma lakmitarë për të marrë jo vetëm tonën po duke lakmuar e msyrë me çdo kusht edhe atë të tjetrit, gjënë, sendin, pasurinë, fjalën e shpesh herë edhe erzin (nderin) e përjashtojmë pa asnjë kufi të ndryshmin nga ne. Më e lartë vjen temperatura e kësaj sëmundje-epidemi në këto ditë zgjedhësh kur sipas rendit të gjërave në sistemin demokratik të administrimit rindërtohen institucionet. Bile këtu nis e këtu bitis, këtu fillon kjo si "punë hajnash", në këtë gjasme demokracinë tonë... Kudo rrugëve ndër qytete e qendra administrative, por edhe në ambjente të mbyllura, kafené a zyra e njëjtë është tema e diskursit, i nderë duket tonaliteti emotiv i fjalës që e përbën atë; fitoi ai po ia vodhi ky, kaq u hodhën në atë kuti e kaq u zbrazën prej asaj kuti, një ritual i pështirë që nuk po din të ndalet nga njëra palë zgjedhje në tjetrën.

Sepse është ndërtuar keq që në fillesë.

Si mund ta bëjnë arbitrin ndërmjet palëve vetë palët? Komisione të administrimit e të numërimit të zgjedhjeve si tonat nuk gjenden kund tjetër dhe, prandaj mosbesimi inkandeshent parashkruan gjithnjë gjendje shpërthimi.

Sepse kështu janë konceptuar. Njëra palë, në mundësi e gatëshme jo vetëm për të ruajtur votat e veta, por për të zhvatur e zhbërë votat e tjetrit, është e ngarkuar të ruhet prej aktit të njëjtë në mundësi të rivalit, gjithashtu. Rivali çmohet gati si armik që duhet fundosur me çdo kusht, mundësisht duhet asgjësuar. A nuk ka ka qenë e tillë e gjithë retorika e z. Edi Rama, kryetar i shumicës qeverisëse, mbushur jo vetëm me ironi e përbuzje për kundërshtarët në pakicë, por edhe me shantazh për popullin votues, duke e kërcënuar se po votoi ata “që s’i duhen dreqit një lek” nuk do të ketë fonde dhe projekte zhvillimi? Pa i rënë syri në qerpik për qortimin ulëritës të medias e publikut. Sa trishtuese! Por jo vetëm kaq...

Cilat do të jenë kredencialet e kryetarit të ardhshëm të bashkisë së Elbasanit, tashmë të rikonfirmuar me diferencë të madhe votash (!) në takimin e parë që do të bëjë me gazetarët-përfaqësuesit e opinionit publik ( aq sa të tillë ata janë)? Fare pak ditë më parë ai, me me zë e me figurë prej babaxhani i ka ftuar ata të mos publikojnë gjëra të papëlqyeshme për kryetarin, sepse do humbasin punën! Janë të paperceptueshme me modelet europiane të demokracisë ndodhi si këto, me ato të Putinit a Erdoganit, mundet, po.

Në cilin vend tjetër rreth nesh a kudo në Europë, sheh në gishtat e qytetarëve votues shenjën e bojës së pafshishme, i ngjashëm në thelb me një çip, me atë që policitë moderne ndjekin personat në vëzhgim? Një shenjë kjo e skllavërisë moderne të njeriut të lirë shqiptar, në kohën kur revolucioni teknologjik ka tejkaluar edhe fantazinë më të përparuar.

## Kohë e përlyeme

Të tillë sistem zgjedhor na kanë ndërtuar politikanët tanë. Ndërsa vëzhguesit ndërkombëtarë, dashamirë e miq të vendit tonë të vetmen mundësi të evidentimit të përparimit të procesit kanë... krahasimin me zgjedhjet e mëparëshme, pasi kanë shpërvjelë mëngët për të numëruar në Vorë a gjetkë dhe enumeracionin e ulur të incidenteve. Ndërsa 260 mijë votues më pak se dy vjet më parë, domethënë rreth 10% më pak, kanë dalë të dielen me 21 qershor në votime, thonë shifrat. Sigurisht ka shumë arsye, po nukli (bërthama) rreth të cilit përmbliidhen të gjitha arsyet është rënia ulëritëse e besimit tek klasa politike, tek ata që organizojnë e menaxhojnë zgjedhjet, tek ata që zgjidhen e më pas administrojnë shtetin e së drejtës dhe ekonominë tonë. Rrugën e lirisë për të abstenuar, po, atë e kanë lënë të lirë dhe për këtë bëjnë kujdes ligjëvënësit tanë...

*Panorama, 25 qershor 2015*

“Me mih n’ujë”<sup>9</sup>

Një takim me njerëzit e ujit ka qenë puna më e fundit që ka bërë i pari i qeverisë. Në ligjërimin me to, si gjithnjë i përgatitur me të gjitha mjetet e përherëshme që ai përdor këso rastesh; tonaliteti i ashpër i ligjërimin, shpërfillës për të gjithë bashkëbiseduesit, por i prerë në fund të fjalëve të spërdredhura; autoritar (është kryeministër apo jo) po më pak ironik kësaj here, u ka thënë atyre, se tani e tutje, s’mund të jetë më lojë puna e ujit. U ka thënë atyre, por për të dëgjuar ne të tjerët, të ndërvarurit e tij në qeverisje. Jo vetëm ujin që rrjedh nëpër tubat e nëndheshëm, shumica prej hekuri të ndryshkur e të rrënuar, por edhe për ujin e puseve nëpër oborre, qofshin ato të hapur prej vetë banorëve, në tokën e tyre - pronë private apo prej gjyshërve a katragjyshërve të tyre. S’ka më! Tani, si për gjithçka edhe për ujin, të gjithë do të jenë nën hyqmin e qeverisë.

Në mjeshtrinë e tij për të bërë show, për të propaganduar si të mira e si të drejta a si të bukura e të pëlqyeshme,

---

9 *bëj një vërë në ujë, punoj kot, flas kot-Fjalori i Gjuhës shqipe- (Çabej, 2005-2010)*

gjëra dhe ndodhi që në realitetin përreth janë të kqija e të padrejta sa s'ka, të papëlqyeshme e të dhunshme dhe jo të lira, kryeministri, Z. Edi Rama, ia ka dalë ta realizojë të veten. Edhe kësaj here si në mjeshtrinë e gjuetisë, në tjetër anë i ka lëshuar zagarët e në tjetër anë është gjahu...

Tani kur qeveria e tij po i shkoklohet e shprishet përditë e më shumë, kur gjithë punët e saj janë rrokopujë e në teposhte, tani kur edhe idhtarët e tij qëndrestarë, mëditës të paguar, zyrtarë e të tjerë mbrojtës publikë, janë stepur disi prej ekraneve e prej portaleve e se përballojnë më kollaj mbrojtjen si më parë...ai u hodh tek uji.

Uji, në të vërtetë është një prej shumë halleve të mëdha të shqiptarëve. Edhe sot pas 26 vjetësh, asnjëra prej qeverisjeve nuk ka mundur t'i furnizojë me ujë qytetet e bujtinat shqiptare, kudoqofshin. Ani pse uji, jo rrallë herë i ka përmbytur e është kthyer në rrezik për ta. Shqipëria, njëri prej vendeve të para në Europë për rezervat ujore, ende nuk ka ujë të pijshëm të bollshëm për banorët e vet të mbetur këtu. Mirëpo, zoti kryeministër nuk i ka mbledhur ata njerëz në atë sallë që t'ju flasë për këtë, nuk ka ndonjë plan e projekt për ta shpalosur para tyre e nëpërmjet tyre për ne të tjerët të qeverisur prej tij. Jo, jo. Kjo, sipas tij, nuk është punë e tij (!) Punë e tij është të na bëjë me dijë të gjithëve se, tani e mbrapa nuk do të ketë njeri që s' do të paguajë ujin. Sepse ujin e ka në pronësi ajo, dmth qeveria. Me para apo me burg. Është apo nuk është ky «shteti që do të bëjmë». Ashtu si kohë parë me dritat u betua se do ta bëjë zap edhe ujin.

Mirëpo përpjekja e tij tashti nuk ka vezullimet e mëparëshme. Krahu i tij i djathtë, ish ministri i



mbrendshëm, ai me të cilin e kish nisur kryesisht zulmën e vet për të bërë shtetin “që duam”, nuk mund ta ketë më në krah. Sepse këtij të fundit i janë ngatërruar keq fort krahët. Ai tani, sipas akuzave që shtohen përditë ka rrëshqitur në krahun e keqbërësve. Ndaj ligjërimit i mjeshtrit kryeministër vjen disi i vakët. Sepse burgimi i fukarasë për drita të papaguara, kërcet fort, fort përpara mbrojtjes “me thonj” prej burgimit të veqilit të tij në krahun e keqbërësve, që i shtohen akuzat përditë, për trafik droge e keqbërje të tjera.

Fundja fjalët shkojnë sa shkojnë, po duhet bërë edhe ndonjë punë për tu mbështetur fjalët mbi to. Ndoshta ish dashur të mbilleshin edhe ca rrënjë pemë frutore a bimë të tjera të dobishme më shumë se rrënjë kanabisi , ndoshta ish dashur të hapej edhe ndonjë kilometër rrugë në vend të pistës së avionëve të vegjël të destinuar për transport droge, ndoshta do të duhej bërë e mundur të eksportohej ndonjë tjetër prodhim shqiptar, sado modest në vende fqinje të Europës dhe jo vetëm kanabis e nënprodukte të tij.

E atëherë, ligjërimit i mjeshtrit nuk do të ishte kaq i thatë...Se kësaj pastaj i thonë: “me mih n’ ujë”

*Panorama, 9 nëntor 2017*

II.

Fishta... dhe hijet përreth



## Fishta... dhe hijet përreth

Gjergj Fishta ka lindur me 23 tetor 1871 dhe këto ditë, gati një shekull e gjysmë më pas, ai shënohet në kujtesën tonë nëpërmjet një akti aspak nderues; shtëpia ku ai kaloi disa prej viteve të fëmënisë së herëshme në Fishtë të Zadrimës është akoma në këmbë por e rrënuar pak pa u rrëzuar përdhé... Fishta, me 30 dhjetor 1940 do të mbyllte sytë e do të nisej për në botën e amshuar. I përcjellë me nderime si askush deri atëherë, nga brenda e jashtë Shkodrës, nga *qytëta e malcia*, nga mbarë Shqipëria fund e maje, por edhe përtej Shqipërisë. Nderime e vlerësime të pafundme superiore. Jo vetëm nga dishepujt e tij, për të cilët qe ylli polar, por edhe nga personalitetet më të shquara të shkrimtarisë e të kulturës në vendin e vet, në Ballkan e në shtete përreth të Evropës: *Maksimillian Lamberz, Norbert Jokli, Petrotta, A.Balldacci, Erëin Stranik, Gabriele d'Annunzio, Karl Steinmetzi...*, *Faik Konica, Aleksander Xhuvani, Lasgush Poradeci, Asdreni, Koliqi, Lefter Dilo, Martin Camaj... etj., etj.* I rrethuar me lavdi si askush deri atëherë në Shqipëri, Akademik i Akademisë Mbretërore të Italisë, i dekoruar nga Turqia, Austria, Greqia dhe Vatikani,



*Fishta, Asdreni, Poradeci dhe Koliqi.*

la një opus të plotë e të realizuar letrar, shtrirë në të gjitha gjinitë: lirikë, epikë, dramatikë, satirë, eseistikë dhe publicistikë. “Kot mundohen grekët e sotëm të gjejnë në letërsinë e vet një vepër ma të plotësuese se “Lahuten”- shkruan për të Konica, në revistën “Albania”<sup>10</sup> të të cilit, Fishta boton shkrimet e tij të para... S’ ishte e para e as e mbramja herë, që autori i “Juvenilia” [Mjeda] deklaronte aty, në kuvendin-tempull të

Françeskanëve, se ai në repertorin e vet të pasun nga literaturat e hueja s’kishte takue as s’njihte nj satirik ma të madh<sup>11</sup>- kumton At Danjel Gjeçaj një përjetimin e vet.

... Sot, duke qenë Shqipëria kjo që është dhe hierarkia e vlerave e dyshimtë, pasionante, emotive dhe më pak reale e shkencore se sa në vendet e tjera të qytetëruara, dy janë hijet që i bëhen “universit kulturor Fishtë”.

10 Pal Duka-Gjini [Danjel Gjeçaj], Gjergj Fishta, jeta dhe veprat, nga Albania shtator 1908, fq.264

11 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta, jeta dhe veprat, fq.62

Të parën, hijen e madhe ia bën sistematikisht shteti shqiptar, me veqilat e vet. Fishta, i parë hënëkeq me burokracinë në përgjithësi dhe me mediokritetin kulturor, në veçanti, e sakaq i pakursyer e i pamëshirshëm në luftën e tij, pagoi haraç si askush tjetër ndër shqiptarë. Hap-e-mbylljet e disahershme të “Hyllit të Dritës”, njohur e pranuar si më e madhja dhe e përkryera tribunë e mendimit intelektual, kulturor e letrar shqiptar të kohës, qe një taksë mjaft e lartë. Po ashtu, “Visku...”, pjesa e dytë e poemës “Gomari i Babatasit”, vlerësuar si një pikë kulmore e satirës kombëtare shqiptare, nuk mundi të publikohej në gjallje të tij; Zogu nuk e lejoi. Madje, në rrethana të mosdashjes e të mospranimi, Fishta, më se njëherë u detyrua të emigrojë edhe fizikisht... Për të mbërritur te shteti shqiptar i regjimit komunist të Enver Hoxhës, që, siç dihet synoi dhe bëri çmos për fundosjen e autorit të “Lahutës së Malcis” në pusin e harresës kombëtare. Atë, “apostullin e atdheut të vet...”,<sup>12</sup> siç thotë Baldacci, e deshi medoemos të mënjanuar, për këtë arsye të anatemuar, të paragjykuar: shkurt të asgjësuar si shkrimtar, si mendimtar e veprimtar, si atdhetar... si gjithçka ai ishte. Duhej mbuluar me terr lavdia e tij dhe duhej ngritur mbi të idhulli (Zoti) i rrejshëm i regjimit kriminal. Dhe kjo vijoi jo pak, por një gjysmë shekulli. Më pas... Nga shteti shqiptar, Fishta është dekoruar me titullin “Nderi i Kombit” në vitin 2002<sup>13</sup>, gjashtëdhjetë e

---

12 “At Gjergj Fishta, 1871-1940 (botim perkujtimuer)”, Shkoder 1941, fq.529

13 Dekreti i Presidentit nr. 3567 datë, 21.11.2002

dy vjet pas vdekjes, dhjetë vjet pas vendosjes së rendit të ri demokratik në Shqipëri..., të cilin ai e shërbeu përgjatë gjithë jetës me veprimin e vet.

Hija tjetër është ajo që i rri sot e gjithë ditën përmbi krye, në formën e xhelozisë, në formën e shpërfilljes nën petkun e “të moskuptuarit” dhe “të vjetërsisë”. Jo se nuk është folur në këto njëzet e ca vite për Fishtën, por sistematikisht duke synuar përdorimin e tij sipas konjunkturës kulturore të qeverive që shkojnë e vijnë. Kasnecë të shërbimit kundër janë marrë shpesh me polemikat e tij, shpesh duke i keqinterpretuar ato, të cilat në thelbin e tyre kanë pasur realitetin shqiptar të kohës së vet, kudo ku është shtruar çështja kombëtare në përgjithësi a në çështje të veçanta të saj, sidomos në lëmë të arsimit a të besimit, si çështje kulturologjike, por edhe si çështje kombëtare e shtetformuese.

Hije i bëjnë edhe ato njerëz të fushës së letrave që Fishtën e përcjellin me heshtim a me vardisje rrokull, shpesh edhe me shtrembërim buzësh, si shprehje e modës modernitare, pa prekur asnjëherë thelbin e gjësë, që në rastin në fjalë është vepra. Ajo sot është e botuar në një version të plotë, përmbledhur e paraqitur nga një redaksi studiuesish. Unë shpresoj se do të ketë edhe të tjera versione në kohët në vijim, sepse njerëzit vullnetmirë, gjithherë aty janë edhe kur kohët janë të turbullta a të këqija. Se Fishta vetëm mirësi i fali Shqipërisë, shtetit, kombit dhe popullit të vet.

*Panorama, 22 tetor 2015*

## Pse stisen flirte të Fishtës me fashizmin?

*-Replikë me Nasho Jorgaqin për Fishten-*

Në një shkrim të paradoditëve, nën titullin: “A flirtoi Fishta me fashizmin?”, Nasho Jorgaqi shkruan: *Për fat të keq, kleri katolik shqiptar, që trashëgoi një traditë të shkëlqyer në historinë tonë kombëtare, në prag dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk u gjend me ato forca që u hodhën në luftë kundër pushtuesve fashistë. Përkundrazi, kleri katolik, në një mënyrë a në një tjetër, i hapi rrugën pushtimit italian, e mirëpriti ushtrinë agresore, duke i cilësuar legjionet e saj “pëllumba të Krishtit”, e mbështeti “rendin e ri fashist” dhe u vu në rolin e bashkëpunëtorit të tij. Për këtë flasin qartë arkivat, dokumentet e viteve 1939-1944...<sup>14</sup> Dhe në qendër të arsyetimeve, për të përmbushur idenë e paracaktuar vihet Fishta: “Fishta, dashur pa dashur, flirtoi dhe u kthye ose u përdor si ithtar i pushtuesve”.*

Në të vërtetë, asnjë personalitet shqiptar i kulturës, rezident i përhershëm në truallin ku lindi nuk ka marrë nderime e vlerësime të pafundme superiore sa At Gjergj Fishta, në gjallje të vet, po dhe përtej, në nisjen e jetës së pasosur. Jo vetëm nga dishepujt e tij, për të cilët qe ylli polar, se kjo do të qe e zakonitë dhe e papërfillëshme për

---

14 Gazeta “Dita”, 2.10.2016



t'u përmendur, por edhe nga personalitetet më të shquara të shkrimtarisë e të kulturës në vendin e vet, në Ballkan e në vende përreth të Evropës: Maksimillian Lamberz, Norbert Jokli, Petrotta, A.Balldacci, Erëin Stranik, Gabriele d'Annunzio, Karl Steinmetzi, Agostino Gemelli..., Faik Konica, Aleksander Xhuvani, Lasgush Poradeci, Asdreni, Koliqi, Lefter Dilo, Martin Camaj... etj.,etj. I rrethuar me lavdi si askush deri atëherë në Shqipëri, deri me 30 dhjetor 1940, kur mbylli sytë.

Njëri syresh, Luigi Federzoni, shkrimtar, publicist dhe politikan i rëndësishëm i kohës, pas vdekjes së Fishtës shkruan " *Në të [Fishten] kemi pa se gjallonte e rrahte zemra e shpirti i kombit fisnik shqiptar me të gjitha bukuritë e miteve origjinale, të traditave mistike e kalorse, të dokeve besnike të vjetërsisë, të ndjenjave heroike. Secili nesh ka kuptue se Gjergj Fishta kishte me të vërtetë lartësinë e Poetit Kombëtar. Tashti e dijmë se vepra ka për të mbetë në mende e në nderim të shqiptarëve*<sup>15</sup> .E, është e ditur se Federzoni përposë se kryesuesi i Akademisë Italiane që edhe ministri fashist i Italisë. Por, siç shihet ai vë në dukje të tjera" flirte" të Fishtës, me atdheun, me kombin, cilësi, të cilat kumbuan megjith forcën e autoritetit dhe të dashurisë së pakufishme që ai gëzonte prej popullit të vet, por edhe prej elitës (kontemporane) bashkëkohore europiane. Dhe nuk përmend aspak ndonjë flirt me fashizmin... Duhet të vësh syze shumë të imta për të kërkuar gjilpërën në kashtë, siç thuhet dhe prap zor se mund të gjesh qoftë edhe një

---

15 "Gjergj Fishta" numër përkujtimuer, botuar nën kujdesin e revistës "Shkëndija", Tiranë 1941, fq.6

nuancë flirtimi të Fishtës me fashizmin edhe përmes këtij pohimi të Federzoni-t, i cili do të ishte i interesuari i parë t'i atribuonte nderimit të Fishtës flirte me to.

Akademik i Akademisë Mbretërore të Italisë, Fishta, ka marrë edhe shumë më heret 4 dekorata shumë të larta; "Mearif kl.II, prej qeverisë osmane, me 1912, "Rittekreuz" prej Austro-Hungarisë së 1912-tës, "Medaglia di Benemerenza, me 1925 prej Papa Piut të XI-të, "Phoenix", me 1932 prej Mbretit të Greqisë. Po ka edhe një dhuratë simbolike prej Krajl Nikollës së Malit të Zi, Fishta. Dhurata është një "teste" (12 copë) lugësh e pirunjsh ari, të cilat Fishta i kishte vendosur në një vend të dukshëm në Kuvendin e Gjuhadorit ku banonte dhe kur vizitorët e tij të shumtë e të shumsyresh e pyesnin për to, ai thoshte, jo pa ironi: "punë krajlash" <sup>16</sup>.... Dhe, nëse dhuratat e nderimet për të e aq më shumë anëtarësimin në Akademinë e Italisë, do t'i çmonim edhe si rrjedhojë e flirteve të Fishtës, do të duhej të thuhej se ai ka flirtuar edhe me Malin e Zi...

Ndokush priste që kleri katolik shqiptar, atdhetaria e të cilit kishte konfirmë historike të bëhej palë me njësitet guerrile partizane dhe atentatet e tyre ideologjike, gjatë luftës së dytë botërore, por më parë është mirë të silltet në përmendje të publikut Konferencën e Paqes, në vitin 1919. Atë delegacion, produkti i dobishëm historik i të cilit është i njohur për Shqipërinë, e kanë përbërë dhe kryesuar klerikë si Mons. Luigj Bumçi e At Gjergj Fishta dhe atdhetarë si Mid'hat Frashëri. Kurse një dërgatë e "Missëve" (antarëve të sipërpërmendur të këtij delegacioni), në një audience

---

16 T. Çobani, *Koha Jonë*, 14 qershor 2015

tek Papa Benedikti i 6-të bëjnë të mundur të shpëtojnë nga kthetrat e fqinjëve Korça e Gjirokastra. Apo nuk çmohet si i tillë dhe brenda dimensionit të lirisë kombëtare - Kongresi i Manastirit dhe gjithë ajo çka u bë aty për gjuhën shqipe, si premisë e parë e ekzistencës së kombit!... Dhe roli i Fishtës aty, sigurisht që është i njohur.


Klerikët shqiptarë katolikë, nuk qenë aq të paditur e të painformuar sa të mos e kuptonin murtajën që do të vinte, me instalimin në pushtet të komunistëve. Madje si dhe atdhetarët e tjerë të vërtetë të Shqipërisë ata e paralajmëruan këtë rrezik që vinte prej kësaj murtaje. Apo, mos vallë kërkohej që prelatët katolikë të rrëmbenin pushkët e të dilnin në mal me partizanët dhe vetëm kështu do ta shërbenin kauzen e Lirisë?!...Për kauzen e Lirisë, kontributi i tyre është, pa më të voglën mëdyshje i paqortueshëm. Sikurse është i paekuivok qëndrimi i tyre gjithëherë përkundër rregjimeve, në krah të vegjëlisë. Është, gjithashtu fakt i njohur se Fishta që aspak i preferuar për rregjimin e kohës kur jetoi, në opozitë publike me të dhe gjithmonë në mënyrë konsistente në krahun e vegjëlisë e jo të rregjimeve. Madje për një periudhë dyvjeçare u detyrua të largohej prej vendit të vet, nën presionin e rregjimit. Kurse një tjetër prelat të Kishës katolike, Dom Gjon Gazullin, rregjimi mbretëror e dënoi me varje, si kundërshtar të vetin, kurse i vëllai, pati thujse të njëjtin fat në rregjimin pasues.

Në shërbim të idesë së flirtimit të Fishtës, në shkrimin e mësipërpërmendur sillen edhe kujtimet e At Zef Pllumbit... Është shumë e besueshme gjithçka shkruan Pader Zefi për Fishten, ai që një dishepull i spikatur i tij, që me të tjerë bashkëvëllezër franceskanë të vegjël e të

mëdhenj e kanë përjetuar si ata e kërkush mospajtimin e Fishtës me pushtimin. Çdo aludim tjetër që tejkalon mospajtimin me fashizmin është i kërkuar, jo i vërtetë dhe jo historik... Dhe, më së paku jo dashamirës dhe fyes për vepren e 38 martirëve të kishës katolike, lumturimi i të cilëve do të bëhet këto ditë... Në përmbyllje, ballazi me letrën që Fishta i paska shkruar një koloneli në Shkodër, të cilën e perdor si ilustrim shkrimi në fjalë, po sjell artikullin që shkruante "Corriere della Sera", me 31 dhjetor 1940, të nesërmen e kortezhit madhështor të Fishtës, me titull:

**"Vdekja e Gjergj Fishtës - poeti kombtar shqiptar"**

Erdhi lajmi nga Shkodra se për shkak të një goditje zemre, ka vdekë sot në mëngjes At Gjergj Fishta i Urdhnit Françeskan (OFM), akademik i Italisë dhe shkrimtar i shquem shqiptar. Fishta, i lindun në afërsi të Shkodrës në vitin 1871, mbaroi studimet fetare në Bosnje dhe u kthye në Atdhe mbasi u shugurue meshtar. Në Shkodër themeloi shkollën françeskane dhe filloi botimin e së përkohëshmes "Hylli i Dritës". Të shumta janë botimet kulturore dhe letrare të cilave u dha jetë dhe zhvillim ky rregulltar. Poemat e tij, krijimet dramaturgjike dhe shkrimet e tij, qysh në fillim u drejtuen në



*përgjithësi për dhanjen e impulsit të zgjimit të ndërgjegjes atdhetare shqiptare. Si drejtor i Shkollës Publike të françeskanëve në Shkoder, futi aty gjuhën kombtare qysh nga viti 1902, kur ajo ishte e ndalueme rreptësisht nga Qeveria osmane. Mbas lëshimeve të kushtetutes turke të korrikut 1908, shqiptarët, të cilët kishin luejtë një rol me randësi në atë revolucion, deshten të mblihdnin forcat intelektuale dhe t'i përfshinin në një bashkësi të përbashkët, por vështirësia e parë në të cilën ndeshën ishte njësimi i alfabetit. Në Kongresin shqiptar të mbledhun për këtë qellim mori pjesë At Gjergj Fishta, i cili ia arriti që të bante që alfabeti latin të pranohej, që ma vonë u ba i përbashkët dhe zyrtar për të gjithë Shqipninë. Mbase u ba një ndër eksponentët kryesorë të Shqipnisë së ringjallun, ai mori pjesë në Konferencën e Paqës në Paris dhe ma vonë u emnue deputet dhe zevendes- kryetar i parlamentit. Në shenj mirënjohje, si mik i singertë i Italisë, për meritat e tij ndaj vendit të vet dhe për ulerat e botimeve të tij, u ftue në majin e shkuem me marrë pjesë në Akademinë Mbretnore të Italisë. Ndër publikimet e shumta të At Gjergj Fishtes kanë randësi krijimet poetike të frymzueme në përgjithësi prej legjendave shqiptare dhe të prime me përkujtue ndjenjat kombtare. Veç poemës në tridhjet kangë të titullueme "Lahuta e Malcise", ai ka shkruie himne kishtare, lirika të ndryshme dhe satira me karakter politik. Luigi Federzoni ka marrë masat që Akademia e Italisë të ketë përfaqesuesin e vet në funeral, dhe i ka dërgue telegram ngushllimi familjes, kryeministrit të Shqipnisë, ministrit të Arsimit të Shqipnisë, parisë së etenëve françeskanë sidhe "Institutit Skenderbeg", anëtar i të cilit ishte i ndjemi i shquem.*

Panorama, 6 tetor 2016

## Fishta - analist dhe polemist

*...e kushdo ia mohon a ia ngushton popullit këtë liri e këtë përfaqësim, ai asht tyran (tiran), autokrat, diktatuer (diktator)*

Që Fishta është jo vetëm poeti, por shumë më tepër se kaq, një figurë poliedrike e kulturës kombëtare shqiptare, është pranuar tashmë si aksiomë ndër qarqet e studiuesve të tij dhe njerëzve të letrave shqipe, në përgjithësi. Opusi letrar që ai ka lënë rrok të gjitha gjinitë e shkrimtarisë, lirikë, epikë, dramatikë, eseistikë dhe publicistikë.

Publicistika e Fishtës është ajo pjesë e krijimtarisë së vet, disi e eklipsuar prej asaj që është çmuar e vlerësuar si vepra homerike shqiptare, prej poemës së tij epike, "Lahutës së malcis". Megjithëkëtë, pa asnjë mëdyshje, publicistika, ashtu sikurse edhe satira, është një nga kulmet e krijimtarisë së tij, e njëherësh njëra prej majave ku ka arritur tradita e shtypit tonë demokratik. Ndonëse më pak i studiuar në këtë lëmë, për arsye të njohura e që lidhen me misionin historik regresist të forcave jo kulturëdashëse, për ta rrëzuar me çkusht e çmim personalitetin e madh,

Gjergj Fishta është e do të mbetet në aradhën e publicistëve më të mëdhej kombëtare të bashkëkohësisë së vet, përkrah Fan Nolit, Faik Konicës , Luigj Gurakuqit e ca të tjerëve..

Kontakti i tij aktiv e i paprerë ndonjëherë me shtypin e kohës, që fillon me 1899, me të përditshmen “Albania” të Faik Konicës e s’dahet për më se dyzet vjet të gjalljes së tij, është argumenti i parë për të provuar pohimin e mësipërm. Artikujt e Gjergj Fishtës i gjejmë në rreth 16 tituj të përkohëshmesh e fletorësh, e shumta e tyre ndër më prestigjiozet organe të shtypit shqiptar: **“Albania”**, **“Elçija (ma vonë Lajm’tari) e zemrës së Krishtit**, **“Zani i Shna Ndout”**, **“La Nazione Albanese”**, **“Leka”**, **“Grueja shqyptare”** , **“Shkëndija”**, **“Rivista d’Albania”**, **“Posta e Shqypnisë”**, **themeluar prej tij, gjithashtu, etj.** Boton në to krijimtari letrare e religjioze, por boton ndërkohë esë dhe artikuj të tjerë publicistikë. Mund të përmenden ndër to: *“Grueja shqyptare në Shkoder”* - përgjigje e një artikulli të botuar në revisten **“Minerva”** ose *“Fjalimi i permort’shëm mbi kufomen e Avni Rrustemit”* në **“Politika”** e Vlorës, maj 1924.

Ndërsa *“Hylli i Dritës”*, e themeluar prej tij në vitin 1913 dhe e drejtuar po prej tij në 15 prej rreth 20 viteve që ajo doli është, padyshim revista më kualitative e kohës në Shqipëri dhe pasqyrë e standartit kulturor të vendit tonë në kulturën kontemporane (bashkëkohore) europiane. Artikulli prezantues i numrit të parë *“Perlimi (program,detyra) i Përkoshmjes”*, që përbën edhe fillesën e angazhimit përkushtues të Fishtës në këtë fushë, i cili do të vijojë me një ritëm fort të dendur e që do të zgjasë përreth tri dekada, deri në frymën e fundit, me 30

dhjetor të vitit 1940. Në faqet dhe në numrat e saj gjen të trajtuar gjalljen e jetës shqiptare, etnosin dhe zhvillimet kulturore, nëpërmjet gjinive të mirëfillta profesionale publicistike, që nga lajmi e deri tek përshkrimi, artikujt e gjatë analitikë, por edhe polemistë. Rubrikat, që e kanë ndjekur gjatë “Hyllin...”, “**Lajme rrokull Shqipnisë**” dhe “**Lajme rrokull botës**” kanë pasqyruar e ndjekur rregullisht jetën publike shqiptare dhe bashkëkohësinë europiane, me të njëjtin ritëm e mjeshtri si shumë prej revistave europiane të kohës.

Është “Hylli i Dritës”, kjo krijesë e çmuar dhe për fat jetëgjatë e publicistikës shqiptare, megjith tri ndërprerjet gati të dhunëshme e peripecitë e panumërta të mbijetesës, përmes së cilës, themeluesi i saj, Gjergj Fishta shpalosi dy dhuntitë ndër më të çmueshmet e ndërkohë, çuditërisht jo fort të përmendurat: talentin dhe erudicionin e tij prej **analisti** si dhe inteligjencën e talentin e jashtëzakonshëm, gjithashtu prej **polemisti**.

*Analisti:*

Janë të mjaftë artikujt që mund të merreshin për të ilustruar pohimin e mësipërm. Mjafton të citojmë disa prej tyre: “*Liria e zgjedhjeve e obstrukcioni i opozitës*”<sup>17</sup>, “*Asambleja Kushtetuese*”<sup>18</sup>, “*Ipeshkvijtë e Shqipnisë e çashtja e zgjedhjeve*”<sup>19</sup>, “*Kleri katolik i Shqypnisë*”

---

17 “*Hylli i Dritës*” 1923, nr.10 fq.433

18 “*Hylli i Dritës*» 1923, nr. 11, fq 181

19 “*Hylli i Dritës*” 1923, nr.12,fq.529



e bashkimi i kombit”.<sup>20</sup> Janë të gjithë kryeartikuj të “Hyllit...” Ata, vërtet nuk firmosen nga Fishta, praktikë e zakonitë kjo e shtypit të kohës, por është shkencërisht e



njohur dhe e pohuar që ato janë produkt i penës së tij, janë artikuj të shkruar prej dorës së tij, që në akord me moralin e rregullat e Urdhnit Françeskan, të cilit Fishta i përkiste, mbeten e publikohen si anonim. Në to, jo vetëm preken, por trajtohen e interpretohen të mbarat e mbrapshtitë më themelore të politikës shqiptare të kohës...” Zgjedhja e parlamentarëve për ne asht një çashtje kryekput gjallnore

për të cillën - pohon Fishta tek **“Liria e zgjedhjeve dhe obstrukcioni i opozitës”** - I madh e i vogël e kemi detyrë me u interesue e me u orvat, qi këto zgjedhje të dalin sa ma të dobishme për ekzistencën e përparimin e shtetit t'onë. E diku më poshtë në këtë artikull filozofon: “M'shka pështetet ndryshimi ndërmjet një shteti civil e institucional e një tjetri barbar, autokrat e despotik ?- pyet, e në mënyrë retorike përgjigjet: Mbas mendimit tonë të gjithë ndryshimi përmblihet m'kta qi shtetent e gjytetnueme e konstitucional ligjt i kanë të

---

20 “Hylli i Dritës” 1924, nr. 9,10 fq. 377

*preme mbas nevojve reale të popullit, me relacion ndaj kohet, ndaj mendorjeve të vendit, ndërsa ndër shtete barbare e autokrate kto ligj përgjithsisht vendohen vetëm...mbas egoizmit t'sunduesve e rrallë e kurr mbas nevojve të popullit, që lanë e kjanë...nuk asht ligja që formon popullin por populli formon ligjen"*

Siç kuptohet lehtasi koncepti filozofik e politik i Fishtës për shtetin është pa asnjë mëdyshje ai demokratik. Spjegimi i tij, i dallimit të tipeve të shtetit: demokratik, civil e konstitucional (kushtetues) nga shteti i tipit autokrat e despotik është tepër i argumentuar. Forca e logjikës është e pakundërshtueshme, siç është ndërkohë konseguent edhe qëndrimi legal e këmbëngulës për shtetin demokratik, kundërshtues e denigrues kundër shtetit autokratik. Tek artikulli, aso kohe i bujshëm **"Delikti i Mamurrasit"** shkruan: **Për me sundue një shtet, nuk asht mjaft dhelpnia, dredhia, intriga, bataqçillëku, rrena, tradhtia: duhet nder, dije, urti, burrni, qe se çka duhet. Po, por dija, urtia, nderi, burrnia, po u zëjshin (mësoheshin) në shkollë e, madje, me shumë mund e djersë, e jo ndër kafeshantana të Europës, e mejhane e paçexhiane të Tiranës, tue luejtë "tavëll" e "bixhoz", e tue pi "mastikë"**<sup>21</sup>.

-Sparta ka krijuar Likurgun e jo Likurgu Sparten- shkruan Fishta-se mos të kishin kenë vetë spartanët bujarë...na Likurgut kurrë emnin s' do t'ja kishim ndie, mesa emni i disa kopistave e sekretarëve ngrehalucë të Tiranës, që në një shqype të keqe, rrinë sot tue përkthye do ligj, të cillët s'i përshtaten kurrkund popullit shqiptar, mbasi një fshisë rrameçë t'i qesë jashta zyrëve. Prandaj e lyp, domosdo arsyjeja, qi populli të jetë përfaqësue sa

---

21 "Hylli i Dritës", 1924/2, f. 73-80)

*ma plotshim (në mënyrë sa më të plotë) e të jetë kryekëput i lirë në të zgjedhun t'atyne delegatëve t'vet, qi në një Asamble a Parlament do të presë (këtu: krijojë) ligjin n'emen të tij; e kushdo ia mohon a ia ngushton popullit këtë liri e këtë përfaqësim, ai asht tyran (tiran), autokrat, diktatuer (diktator).<sup>22</sup>*

Analiza e sipërcituar është e vitit 1923 dhe siç lehtas dallohet, ajo është e qenësishme dhe e vlefshme shumë edhe sot pas 92 vitesh, në teatrin politik shqiptar. Dhe vetëm po të nisesh nga ky fakt, pra jetëgjatësia e analizës politike-publicistike ke pohuar argumentin më me peshë në favor të vlerave të pakontestueshme, të dallueshme e të një cilësie *par excellence* në këtë fushë të krijimtarisë së Gjergj Fishtës. Vërehet në krejt analizën publicistike fishtjane, krahas aftësisë së dalluar intelektuale edhe kurajoja civile për t'i publikuar pikpamjet e tij, ani pse në ta shumtën e rasteve e thujse gati gjithnjë shkojnë përkundër "rrjedhës", pra kundër mendimit zyrtar... Dhe kjo i ka kushtuar jo pak atij dhe veprës së tij edhe në bashkëkohësinë e vet, në gjithë veprimin e vet publik e kombëtar në vitet '20 - '30. Mjafton të kujtojmë mbylljen tri herë radhazi në mënyrë të dhunëshme të krijesës së tij - Hyllit të Dritës, fondamenti më i rëndësishëm kulturor i kohës.

Porse, të pretendosh diçka të thuash për Fishtën si publicist, pa përmendur e vënë në krye të radhës **polemikën** e tij, zëne se nuk ke thanë asgjë. Madje, në këtë "zeje" ai është i pakundshoq. Nëqoftëse studiuesit e veprës së tij letrare, fishtologët e kanë vlersuar edhe

---

22 H.D.1923, nr. 10. fq 433

satirën e tij si një kulm, mendoj se ai kulm ngrihet mbi këtë kualitet dhe arritje monumentale në këtë fushë të publicistikës. Njëri prej studiuesve të tij të zellshëm e vlerëson kështu: *"Polemika e tij nuk bëhet për çeshtje vetjake, polemika e Fishtës ka si yll polar përmirsimin e vendit moralisht, çfarosjen e veseve, luftën kundra "atdhetarëve me barkun kodër".*<sup>23</sup>

Sikurdoherë, tribuna publike e polemistit Fishtë do të mbetet prestigjozja e françeskanëve "Hylli i Dritës". Njëpër faqet e saj janë botuar mëse 20 artikuj e kryeartikuj (ese) polemistë. Disa prej tyre si: **"Çashtja e kryeqytetit e kleri katolik"**, **"Kombësia e kleri katolik"** **"Gabove Hilë"**, **"Ismet Toto para gjykatores së Hyllit të Dritës"**, **"Mbi një banalitë botue në të përkohëshmen "Zgjimi"**, **"Tash që u ba Shqipnia duhen perbâ (bërë) shqypetarë"** ... kanë mbizotërue atmosferen intelektuale politike shqiptare të viteve 20-30. Kjo, sepse në thelbin e vet këto polemika kanë rrok e trajtue raporte delikate shqiptare, siç është raporti ndërmjet kombit e fesë, ose ai ndërmjet besimeve të ndryshme fetare në Shqipëri. Me kompetencë, me erudicion e dije të madhe, me dashuri të pakufishme për dheun dhe popullin e vet. Gjithësesi këto janë rrugë e rrugica të historisë së kulturave së popujve, të destinuar vetëm për të kaluar nëpër to njerëz të mëdhenj. Dhe Fishta ynë e kishte fituar këtë privilegj me veprën e vet.

---

23 Lefter Dilo në *"At Gjergj Fishta 1871-1940" - botim përkujtimuer, Shkoder 1941.*

## Nga Kukli në Fishtë dhe hierarkia e dekoratave

Në Kukël është përruar muzeu i Ndre Mjedës, faza përmbyllëse e asaj që është pagëzuar si Qendra kulturore e muzeale “Ndre Mjeda”.

Kukli është një fshat i vogël diku ndërmjet Lezhës e Shkodrës, i cili shtrihet në fushën e Zadrimës deri në shpatin e këndejmë të malit të Kakarriqit. Kísha e ngjitur pak në shpat, prej ku lahet me shikim krejt fusha është ndërtuar para 100 e ca vjetësh; rreth vitit 1906 është projektuar dhe ka nisur ndërtimi i saj, prej famullitarit të atëherëshëm të katundit, Dom Ndre Mjeda. Ai kaloi aty tridhjetë vite të jetës; aty shkroi e lëmoi lirikat dhe tingëllimat e tij - perla të letërsisë shqipe, aty shkroi poemat “Andrra e Jetës”, “Lissus”, “Shkodra” shkroi librat e gjuhës shqipe për nxënësit; aty ka këmbyer korespondencën me Gustav Majerin e albanologë e gjuhëtarë të tjerë, miq të tij evropianë. Banonte dhe shërbente aty me petkun e meshtarit edhe përgjatë viteve 1921-1927 kur qe deputet i parlamentit të parë shqiptar për dy legjislatura... Ndre Mjeda, poeti, albanologu, gjuhëtari, politikani kaloi aty dhe katund m'katund nëpër Zadrimë,

rreth tri dekada të jetës së vet, në fillimshekullin e njëzetë. Ishte famullitar i Kuklit; aty u mësoi besimtarëve të tij, bashkë me ritin e lutjeve, edhe ritin e nxënjes. Ata përfantuan prej tij plot dije të tjera për botën e vogël rreth tyre dhe për atë botën e largme atje përtej, por edhe ai mësoi me to vlagën e tokës e buisjen e sythit. Ai u solli atyre të parat makina bujqësore, të cilat aso kohe, me zor i kapërdinte edhe ëndërra e tyre më e bukur. Gjërat e Mjedës, që akoma jetojnë në Kukël, janë kisha e vogël dhe qela, të dyja të skicuara dhe ndërtuara prej tij. Qela, një ngrehinë e stilit neoklasik, ka përfunduar së ndërtuari në vitin 1913. Kisha, prej tri vjetësh e rikonstruktuar, duke respektuar me përpikmëri elementet arkitekturorë të objektit të kohës kur qe ndërtuar, ngjan me cilëndo simotër të një fshati të Spanjës, Italisë a të Polonisë, ku poeti pat studiuar, po edhe të Austrisë, Kroacisë a Sllovenisë. Në patalogun përpara saj, parvjet është vendosur shtatorja e poetit dhe të trija së bashku tani kanë krijuar një unit arkitekturor mjaft estetik. Shtatorja, një krijesë artistike shumë e realizuar, e lakmuar edhe për një shesh të Shkodrës a Tiranës, është vepër e mjeshtrit Sadik Spahija... Zef Balaj, një emigrant i diasporës në Neë York ka qenë donatori i saj, porse shenja të tilla bamirësie, që mbajnë emrat e familjes Ukgjini dhe biznesmenit e intelektualit të njohur shkodran, Gjergj Leqejza, gjen në vitrazhet e kishës e në “ingredientë” të tjerë të objektit muzeal... Kurse qela, shtëpia e famullitarit, ka filluar të mbledhë reliket e poetit, ato pak të mbetura, që akoma gjënden. E fundjma ndër to, që ka mbërrijtur aty 4-5 muaj më parë është edhe tryeza-skrivani 100 vjeçare e poetit. Ndjesia dashamirëse, e fshehur me finesë por edhe

me rrisht të madh, ka mundur ta shpëtojë objektin e vlerë prej betejave ateiste të zhbërjes e të zhbirjes së gjithçkaje të lidhur me fenë e me besimin dhe me bartësit e tij, të nisura në vitin 1966. (Si për ironi të fatit që 100 vjetori i lindjes së poetit). Në vitet e fillimit të atij rrëmeti të madh ideologjik, tryeza është përcjellë nga Kukli, në një kënd të pluhurosur të muzeut të Shkodrës. Ka qenë, si duket e njëjta qasje me sjelljen e qëndrimin ndaj vetë poetit, emri i të cilit përgjatë gjysmëshekullit të rregjimit të shkuar jetoi në terr - dritën, që i ofroi rregjimi. Diktatori e kishte emërtuar “klerik popullor”, për ta veçuar kështu prej zulmës që kishte ndërmarrë e do të ndërmernte ndaj bashkëvëllezërve të tij, sigurisht vetëm si arsye propagandistike për paranojën e vet.

Që tryeza të arrijë më së fundi në Kukël, aty ku që vendosur në krye të herës me orenditë e tjera të qelës, një shekull më parë, është dashur një proces i gjatë këmbëngulje e ballafaqje, ecejake nga Muzeu i Shkodres tek Ministria e Kulturës e Tiranës dhe nga kjo e fundit përsëri tek i pari, në itinerarin e një karshilleku të ndërsjelltë absurd... Falë afeksionit dhe mirësisë së poetit të mirënjohur Visar Zhiti, ish ministrit afatshkurtër të Kulturës, tani ajo është aty.

Mjeda i mbylli sytë dhe u nis për në botën e përtejme me 1 gusht të vitit 1937, por ajo, kisha, ndërtaur sipas stilit neoklasik, e vogël por e ngjashme me simotra të tjera në Itali, Poloni ku ai studioi a gjetkë në Europë, jetoi madje mbijetoi edhe pas “tërmetit” ideologjik ateist të vitit 1967, kur u shembën edhe kisha shumë më të vjetra, si bie fjala ajo e Danjës (në Vau-Dejës) e ndërtaur në shekullin e

XIII, në të cilën sipas shkrimeve qe kunorëzuar martesë e Gjergj Kastriotit .

Mjedë qe më fatlumi ndër iluministët katolikë, ai dhe vepra e tij mbijetoi mbështetur mbi atë artificin, “klerik popullor”, me të cilin e pagëzoi rregjimi; vepra e tij u lexua dhe studiua e gjitha në shkollë, posë retushimeve të asaj që kishte motive fetare, “heretike” për rregjimin.

Fatlumsia e dytë e Mjedës qe ardhja si famulltar aty, pesë a gjashtë vjet më parë i Dom Nikë Ukgjinit, i doktoruar edhe në shkencat historike në Zagreb. Dëshira dhe pasioni i tij, bashkëngjitur me donacionet e njerëzve vullnetmirë, nga vendi dhe mërgata dhe me atë të studiuesit të ndjerë Mentor Quku, i cili la një korpus prej dhjetë vëllimesh me hulumtime 40 vjeçare nga jeta dhe vepra e poetit, janë producentët e asaj gjëje që është bërë aty, atij ansambli arkitekturor, mjaft estetik e piktoresk, në oborrin e të cilit, sinkronizuar me gjithçka tjetër aty, rri shtatorja e poetit.

Në përmbyllje të çdo faze të rindërtimit aty, nuk kanë mënuar të vijnë zëvendësministra dhe ministra kulture, një a dy herë ka asistuar edhe kryetarja e parlamentit. Gjithherë ata kanë ardhur në të kryer të punëve, për të bërë aktet solemne të vendosjes së buqetave me lule te shtatorja e poetit a kanë prerë shiritë në inaugurimin e një faze të rindërtimit. Këtë ceremonial bëri kësaj here edhe ministra e kulturës, Znj. Kumbaro dhe përmendi si kontribut të asaj ministrie restaurimin dhe sjelljen e tavolinës së tij të punës prej një salle të mykur muzeu, në shtëpinë e poetit, një proces i cili ka zgjatuar rreth 4 vjet,



përfshirë tre mandate ministrash, pa vënë këtu në llogari ecejaket e dom Nikës, sa në një rën zyrë në tjetrën.

Këtu e këndeje Qendra “Ndre Mjeda” shpresoj se do të jetë një qendër e vërtetë pelegrinazhi kulturor për vendas e të huaj. Unike në llojin e vet siç qe e posaçme edhe vepra letrare e Mjedës në letrat shqipe, siç qe hirplote krejt vepra e tij në dobi të atdheut...Po, si mirënjohje Mjeda nuk mban (me dijen time) ndonjë titull më të “lartë” se atë që i kishin dhënë mëkëmbësit e rregjimit, “klerik popullor”...

Nga Kukli kundrohet lehtas edhe Fishta, një fshat tjetër, jo më larg se 7-8 kilometër nga këtu, fshati ku ka lindur një tjetër iluminist i botës shqiptare Gjergj Fishta, i cilësuar që në gjallje “poeti kombëtar”, dy autoritete dhe formate origjinale letrare, bashkëpunues e bashkëudhëtarë për shumë kohë në çeshtjet më kauzale shqiptare. Mjafton të përmendim vetëm dy prej tyre, Kongresin e Manastirit, kongresin e lindjes së alfabetit të gjuhës shqipe dhe Parlamentin e parë Shqiptar ku të dy qenë deputetë *par excellence* të Shkodrës. Fishta e pati ndryshe rrugën e vet, nuk shërbeu shumë kohë si frat ndër katunde, që të derdhte edhe ai pasionin e misionin e vet në ndonjë kishë të tillë, por të tjera “*pomendore*” (përmendore) bëri edhe në këtë fushë, ai ka skicuar vetë Kuvendin e Françeskanëve të Gjuhadorit në Shkoder dhe Kuvendin e françeskanëve në Lezhë, të dyja godina moderne dhe bashkohore, kurse nga shtëpia e vet në katund, në Fishtë ai qe larguar kur ishte vetëm gjashtë vjeç. Ajo shtëpi është akoma në këmbë, është ajo rrënoja, për të cilën në rrjetet sociale qarkullon inisiativa për të mbledhur donacione për ta restauruar, si refleksion i nderimit e respektit për të. Kurse zotime e

premtime deputetësh e ministrash rrijnë në varg si gjithë ato premtime të tjera të tyre, kurrë të mbajtura...

Fishta që i pari akademik shqiptar anëtar i një Akademie të një vendi europian. U emrua akademik i Akademisë së Italisë në qershorin e vitit 1939.

*-Ai që emnue anëtar i ma të lartit "forum" të intelektualëve të Romës dhe të Popullit Italian për merita e vlerë të shkrimeve të tija, pasqyrë e gjallë dhe shprehje autentike e racës e e gjenisë shqiptare-shkruan "Hylli i Dritës"<sup>24</sup>. Ndërsa Luigi Federzoni, kryetar i asaj akademie thotë: "Në kohë, mjerisht të shkurtë, në të cilën Atë Gjergj Fishta bani pjesë në Akademinë mbretnore të Italisë, ai fitoi çmimin e të tanë antarëve"<sup>25</sup>. Ndërsa Ati i Shenjë, Papa Piu i XII në një audiencë të gjatë në vitin 1940 do ta përgëzonte poetin për emrimin e tij si Akademik i Italisë: "Emnimi i yt si akademik i Italisë asht një nder për Fé, për Urdhën [Françeskan] e për Kombin tand, prandaj unë pors i mëkambës i Krishtit, kam pse të përgëzohem me ty e me... Kombin tand"<sup>26</sup> ...*

Me titullin "Nderi i Kombit" Fishta është dekoruar në vitin 2002, gjashtëdhjetedy vjet pas vdekjes (në gjallje të vet që i dekoruar nga Turqia, Austria, Vatikanin dhe Greqia). Kurse në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, për herë të parë pardje, dashamirë të tij e kujtuan Fishtën nëpërmjet paraqitjes së një libri të ri për të, në vigjilje të 143 vjetorin të lindjes së tij...

---

24 "Hylli i Dritës" mars-prill-maj-qershor, 1939 fq.228

25 "Shkëndija"-Gjergj Fishta, Tiranë 1941, fq. 6

26 "At Gjergj Fishta", botim përkujtimmer, Shkoder 1941, fq.37-38

Frano Kulli

Asnjë titull nderimi nuk mban Imzot Luigj Bumçi, Kryetari i Delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris (1919-1920), kontribuesi i posaçëm i shpëtimit të krahinave shqiptare, Korçës e Gjirokastrës si dhe Vlorës nga aneksimi prej dy vende fqinje asokohe...

Ndërkohë dekoratëshpërndarësit - presidentë të Republikës, kanë dhënë në këta 23 vjet kaq shumë tituj e dekorata gjithnduresh e për gjithkënd... sa edhe vetë mbajtësit e tyre a të familjarë të tyre zor se i ruajnë në kujtesë. Pesha morale e tyre është barasvlerësuar me peshën në gram të medalioneve, ndërsa kujtesa jonë kombëtare dëmtohet përditë e më shumë me hierarkinë e parespektuar të vlerave të njëmendta kombëtare.

*Panorama, 27 tetor 2014*

MJEDOLOGU.  
Lamtumirë Mentor Ouku

Lajmin e vdekjes së tij e mora parmbremë prej Dom Nikë Ukgjinit, njërit prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Mentor Qukut. Vepra e fundit që ata, tashmë e kishin përfunduar, thujse së bashku është Kukli i Ndre Mjedës, një unit arkitekturor e kulturor, ndoshta i papërsëritshëm



në Shqipëri. Është shembëlltyra e një gjëje të dobishme, që mund të bëjnë njerëzit vullnetmirë në dobi të kulturës dhe etnogjenzës sonë kombëtare, me qetësinë e pabujëshme por dhe me dinamikën e ritmin

e lartë me të cilin, kjo kategori e njerëzve dijnë t'i bëjnë gjërat e dobishme, duke shpërfillur e sfiduar zhurmën e bujën që shoqëron shpesh herë, punë ndoshta shumë më të pakta, që bëhen në këtë fushë, sidomos.

Kukli, fshati ku poeti, gjuhëtari, politikani, atdhetari Mjeda shërbeu për tridhjetë vjet, sot është padyshim një qendër e papërsëritëshme pelegrinazhi, jo vetëm për këtë figurë monumentale të kulturës sonë, por ndoshta për gjithë trashëgiminë tonë kulturore kombëtare.

Pararendësi ishte, pamëdyshje Mentor Quku. I dashuruar që heret me këtë figurë shumëdimensionale dhe të përkorë të kulturës Shqiptare, Ndre Mjeden, ai e kish nisur sendërtimin e saj, me hulumtimet dhe studimet e veta, rreth 50 vjet më parë kur ishte mësues atje. Botimet e atyre viteve, në shtypin shkencor e letrar të asaj kohe, qenë zanafilla e gjithë asaj që Mentor Quku, pasi është nisur për në botën tjetër ka lënë në panteonin e trashëgimisë sonë kulturore. Një vepër jetëshkruese në dhjetë vëllime, me më shumë se 4000 faqe, një lëndë – nektar e mbledhur edhe nga dëshmi të shumta të bashkëkohësve të Mjedës, por më pas nga arkivat e mëdha europiane të Romës, të Vjenës, të Polonisë, Gjermanisë, Amerikës ...

Mentori ia arriti të hedhë, kështu themelet e “Mjedologjisë”, një institucioni studimor autentik shkencor. Numri i parë revistës “Mjedologjia 1” bashkëthemeluar gjithashtu prej tij, është edhe më e fundit dëshmi që la para se të mbyllte sytë. Por jam i bindur se nuk ishte as ideja e as projekti i tij i fundit. Njerëzit si Mentor Quku, që në jetën e vet hulumtuese e shkencore kishin ecur gjithnjë me progresion gjeometrik, janë dhe mbeten burim i pashterrshëm frymëzimi, modele të përkryera që vlejné për sot dhe për nesër.

*Shekulli, 2 qershor 2014*

Në kohën që rindërtohen burgje  
a mund të ngrihen tempuj?

Shtëpia ku ka lindë me 23 tetor 1871, Gjergj Fishta, nuk është më. Ai ka qenë rreth tri vjeç, kur familja lëviz e shkon në një shtëpi tjetër, fare afër aty ku tubohen edhe shtëpitë e tjera të katundit. Kjo e fundit është akoma në këmbë, atje në Fishtë të Zadrimës, në fshatin e tij të lindjes, jo më larg se pesëmbëdhjetë kilometër nga qyteti i Lezhës. Pak më larg nga Shkodra, gjithashtu.

Gjergj Fishta (atëherë Zefi i Ndokë Simonit) largohet prej këtu, mbasi mbush gjashtë vjeç. Atë Marjani nga Palmanova, një misionar françeskan venedikas, ua lyp prindërve të vet dhe e dërgon në Shkodër, në shkollën që françeskanët kishin hapur në atë qytet që nga viti 1861, e para shkollë në Shqipëri, që do të ishte “shkolla e të vorfënove, e kambë-zbathunve, e të harruemve, e fshatarëve, që ma vonë do të pagëzohej shkolla “për antonomazi shqiptare”. Aty u shfaq për herë të parë, melodrama shqip “Nata e Këshnellave”, e përpunueme nga Atë Leonardo de Martino - poet arbëresh, me të cilën hapet për herë të parë sipari i teatrit kombëtar...<sup>27</sup>. Në

---

27 Pal Duka-Gjini; “Gjergj Fishta- Jeta dhe veprat”, Romë 1992, fq.21

vitin 1880, në Kuvendin e Fretënve në Troshan, hapet për herë të parë Kolegji Françeskan Shqiptar prej At Marianit të sipërpërmendur dhe At Giampiero nga Bergamo. Fishta (pra Zefi 9 vjeç) është ndër të parët nxënës. Këtu nis udhën e meshtarisë, më pas, prej këtu së bashku me gjashtë vërsnikë të tjerë, në përkujdesjen e At Lovro Mihaçević, aso kohe Provinçial i Provincës Françeskane Shqiptare të këndellur, pas rrënimit të saj të mëparshëm, shkon për studime në Guca Gora, në kuvendin Sutiska për këndimet e filozofisë dhe më pas ato teologjike në Livno, në Bosnje. Kthehet mbasi mbaron studimet në vitin 1893, tashma jo Zefi, por Pader Gjergji. Me 25 shkurt 1894 thotë Meshën e Parë në kishen e Troshanit, taman aty ku edhe e kishte nisë rrugen e vet të apostullimit. Mandej frat i ri në Gomsiqe, në Hot, në Lezhë,... Të shumtat e viteve të jetës i kaloi në Provincën Françeskane në Shkodër, por edhe... në Tiranë, në Korçë, në Manastir, në Romë, në Bruksel, në Vjenë, në "Turki të re", në Amerikë, kudo ku e lyp misioni në punët e mëdha të kombit. Rrallë fort i bie rasti me ardhë në Fishtë. Kthehet përmallshëm, në shtëpinë e të parëve për krejt pak ditë, në ditët e mbrame të jetës, në dhjetorin e vitit 1940.

Ka kaluar gati rreth një shekull e gjysëm prej atëhere. Shtëpia tani është një ngrehinë e cila ka pak të ngjashme në atë fshat e në të tjerë fshatra aty rrotull. Jo vetëm për arsyen se peisazhi arkitekturor i fshatrave, thuajse është përmbysur vizualisht, por edhe për pavlefshmërinë utilitare të saj si banesë. Tani ajo është bosh, pa njerëz mbrenda. Vërtetë, dalëngadalë ajo shtëpi po rrënohet dhe nuk do të jetë e largët dita kur ajo do të shembet. Sigurisht

se nuk do të mbetet ndonjë familje e pastrehë, në këtë rast, e cila do t'i shtohet numrit të fatkeqëve, që gjithsesi nuk janë të pakët edhe në atë krahinë. As nuk do t'i mungojë Zadrimës ndonjë banesë që ka mbartur a mbart vlera të veçanta arkitekturore. Ka pasë ajo krahinë, si edhe jo pak të tjera në Shqipëri, vlera të shënuara të qytetimit, të barasvlefshme me vlera të qytetimit europian, të cilat, janë shuar e fundosur "shtatë pash nën dhë" nga rrëmetet e kohës, por edhe prej përkujdesjes sonë të zhgarravitur për trashëgiminë kulturore e qytetimin tonë. Në Lezhë, marrëzia dhe babëzia ç'qytetëruese ka gjasë ta kthejë kalanë e "Besëlidhjes" në një pijetore... Por shtëpia e poetit, më shumë se si banesë, të grish si një simbolikë, të josh geni i racës së poetëve, zanafilla e gjeniut, që kudo në Europë po edhe më përtej çmohet e nderohet si vlerë identitare... Ky meditimi im vjen si një tis shqetësimi i përsëritur që kam parë e ndjekur këto ditë në medie, veçanërisht në atë të rrjeteve sociale, i cili konvergon (qendërzohet) në një pikë të arsyetimit: përse kjo sjellje e parrespektëshme ndaj një simboli të rëndësishëm të një personazhi simbol të kulturës dhe historisë së kombit si Fishta...! Kjo besoj se përbën nevojën e përkujdesjes për atë shtëpi, restaurimin dhe mirëmbajtjen e saj; kjo është e përbashkëta e gulçimit tonë, gjithashtu.

Fishta ka për banesë pjesën e vet në Tempullin e Vlerave të Kombit, në kujtesën dhe shpirtin e shqiptarëve, kudo janë, anë e kënd botës. Koha e vertetoi se ajo qe e patjetërsueshme. Porse parijsja e vendit e ka për detyrë përkujdesjen edhe për reliket, si për gjithçka tjetër të lidhur me njerëzit e vlerë të historisë së kombit... Ajo



murana, sipër së cilës është vendosur një kryq i madh dhe shënimi: këtu u lind Poeti kombëtar, frati i Madh Gjergj Fishta, meriton të jetë qendra e pelegrinazhit kulturor, për të cilën ka tagër dhe detyrë ta bëjë udhëheqësia. Porse shteti shqiptar nuk e ka dashur asnjëherë përnjimend Fishten, edhe ai i bashkëkohësisë së vet nuk e qasi. Sikur Fishta të mos kishte atë “strehë” gjigande në vetëdijen e popullit, jo vetëm do ta ndalonte a edhe do ta dëbonte për ca kohë, siç bëri, po nuk e di se ç’mund të bënte edhe më... *E shumta e njerëzve të shtetit shqiptar [sot], jo veç nuk duen, por as nuk janë të zotët, me ia sjellë të mbaren e të miren shtetit e kombit, e se prandej këta janë ata mikrobe që janë tue ia pi gjakun e tue ia shkurtue jeten Shqipnisë së mjerë.*<sup>28</sup> - do të qortonte ai shumë e shumë herë kështu, në mediumet e kohës po edhe në parlamentin shqiptar ku qe zgjedhur deputet dhe nënkryetar.

Shteti dhe qeveritë e tij nuk e kanë dashur asnjëherë meritueshëm trashëgiminë kulturore të këtij vendi, sepse ai thesar ka qenë gjithmonë “konkurenti” i qeverive, përgjithësisht të mangëta që ka pasë shteti shqiptar njëqindedyvjeçar. (Padyshim, rrënimtarja më e madhe ka qenë diktatura)

Një tempull, ku do të naltoheshin vlerat e kombit, në të cilin Fishta do të kishte vendin e vet..., Shqipëria ende nuk e ka skicuar dhe as do ta ketë edhe për shumë kohë me gjasë. Përderisa edhe prijësit e Shqipërisë post diktaturë për 24 vjet, më së paku e kanë shpërfillur.

---

28 Fishta-“Hylli i Dritës”,1924/2 fq. 80

## Kohë e përlyeme

Kurse udhëheqësit e sotëm kanë zgjedhë si përparësi të tani për tanishme rindërtimin e rehabilitimin e burgjeve...

Është e pamundur që në kohën kur rindërtohen e shtohen burgjet të ngrihen a të ringrihen tempujt.

*Panorama, 27 dhjetor 2014*

Dritëroi, Pjetër Arbnori, Fishta ...

*(Rikthejeni Fishten në tekstet shkollore)*

Në nëntorin e vitit 2001, në panairin e përvitshëm të librit, që asohere akoma bëhej tek "Piramida" - Qendra ndërkombëtare e Kulturës, ne promovonim nismën tonë për botimin e kolanës së plotë të veprës së Fishtës. Si fillesë ishte vëllimi i parë me Lirika, Mrizi i Zanave. Një nismë, realizimi i së cilës zgjati dhjetë vjet, e natyrisht mes peripecish e travajësh jo të pakta, që të hap një projekt i tillë, i madh në lëndë e në kohë. Por tani nuk përbën interes të flasësh për ato, aq më tepër tani kur kanë kaluar 3 vite që projekti është përmbushur, vepra është në qarkullimin publik, në dorë e në dispozicion të lexuesit



që e dëshiron. E plotë, e përgatitur nga një redaksi me studiues seriozë të letërsisë dhe njohës të thellë të autorit, e pajisur me shënimet e spjegimet e nevojshme gjuhësore, pra një aparat i plotë filologjik. Prandaj po kthehem prap te fillimi. Ndër të ftuarit, në atë promovim ishin edhe Dritëro Agolli, Pjetër Arbnori, Ali Podrimja e plot të tjerë poetë, shkrimtarë, dashamirës të Fishtës e tanët si dhe kureshtarë, gjithashtu... Po përpiqem të perifrazoj fjalët që thanë në atë takim, përposë të tjerëve, Dritëroi dhe Pjetri i ndjerë.

**Dritëroi:**... Unë, sigurisht nuk i mbaj mend shumicën e vjershave që kam shkruar, sidomos ato të viteve të mia të hershme, por vjersha të Fishtës, që i kam mësuar në klasat e para të shkollës, kur isha fëmijë, i kujtoj edhe sot..., tha Dritëroi, dhe recitoi nja dy strofë nga "Lahuta e Malcis", nuk më bie ndër mend saktësisht se prej cilës këngë, nga e para tek e tridhjeta, recitoi poeti Dritëro.

Kurse **Pjetri**, pak a shumë kështu:...Ka shumë që thonë se nuk kuptohet Fishta. Po s'kanë si ta kuptojnë Fishtën, në veprën e të cilit ka ma shumë se 19 mijë



glosa, ata që në fjalorin e tyne kanë në përdorim jo ma shumë se trimijë fjalë..., foli Pjetri i dashur, me atë sarkazmen e vet të njohur, të cilën edhe për do kohë shqiptarë të brezit të mesëm, nuk do ta harrojnë lehtë.

Kanë kaluar prej atëherë 13 vjet, sigurisht për Fishtën është folur e shkruar, jo rrallë. Edhe vepra e tij është botuar. Gjithnjë e pjesshme, po shpesh...Përveç botimit të sipërpërmendur, "Fishta-vepra", në dhjetë vëllime, i cili padyshim është unik për nga përfshirja në të e gjithë krijimtarisë së autorit. Por për më shumë se kaq, për atë aparatit spjegues gjuhësor. E megjithatë, prap në zhargonin e rëndomtë, Fishta ndjehet i pakuptuar. Në shkollat e mesme studiohen, a më shumë përmenden dy prej veprave të tij "Mrizi i Zanave" kur flitet për poezinë lirike dhe "Jerina ase mbretnesha e luleve" (*kështu e titullon autori në vitin 1914 poemthin e tij melodramatik*), kur flitet për dramaturgjinë dhe kaq. Kurse në praktikën e leximeve të rekomanduara në shkolla, praktikë e cila, deri para nja dy vjetësh miratohej nga Ministria e Arsimit, nën okelion: "Libra të rekomanduar për lëndën e letërsisë", në ato lista zyrtare, Fishta përfaqësohej barabar sa një poet, emri i të cilit nuk është më shumë familjar për rrethet e leximit, sesa rrethi i miqve të tij !!!!

Po kështu, pak njihet, sepse pak lexohet a studiohet Fishta edhe në universitete. Një vit më parë në Fakultetin e Gjuhës e Letërsisë të UT, në ditën ndërkombëtare të librit, me 23 prill, në një ekspozitë në korridoret e atij fakulteti kam shquar vështrime habitore për librat e tij që ishin të ekspozuar aty prej studentëve, por dhe një qëndrim dyzues midis shpërfilljes dhe habitës, nga disa prej mësimdhënësve të tyre. Dhe jam ndjerë i trishtuar. Nëpër qarqet e atyshme shpërfillja është e disamënyrshme... Një kandidat për master shkencor nga Lezha në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" nuk gjen një pedagog të lirë

që ta udhëheqë për punimin e saj shkencor mbi veprën e Fishtës!!!... Në Universitetin e Shkodres kështu, aty ku Fishta pati themeluar mësimin në gjuhën shqipe në shkollat qytetse...

Por kam ndeshur edhe sjellje të kundruallshme; ca kohë më parë një tjetër studente e vitit III (Universiteti i Tiranës), Erla A. Velaj, kishte përkthyer nga italishtja, një shkrim të botuar në fundvitin 1940, **“Si e fotografova për herë të fundit Fishtën”**, shkruar nga Allesandro Serra dhe po e përgatiste për ta botuar. Studentja e kërsëruar prej Fishtës, në “gërmimet” e saj studimore kish ndeshur artikullin në formë reportazhi të italianit Serra, i cili shkruan i mrekulluar për Fishtën, pasi kishte lexuar “Lahutën...” , pasi ish njohur me të dhe pasi e kishte fotografuar.<sup>29</sup> (Revista “Shejzat” e Koliqit... Titulli në italisht, *A Scutari con p. Fishta il grande poeta albanese*. Alessandro Serra.) E nuk po përmend emra malësorësh, që kanë mundur të recitojnë me orë vargje të “Lahutës...”. Unë kam njohur jo një, po disa prej tyre...


Një dyzim i vërtetë ndërmjet “Fishtës së pakuptuar” dhe alibisë për ta paraqitur të tillë. Një pakuptimësi që zgjat edhe njëzet vjet të tjera, pas gjysmëshekullit të shkruar. Dhe a do të zgjasë e zgjasë përsëri?

Këtë pyetjen e fundit e kam si kujtesë për Ju, zonja Ministre e Arsimit. Tani që keni premtuar se do të bëni reformë në arsim, rikthejeni Fishtën meritueshëm në tekstet shkollore dhe tek nxënësit e studentët. Fshijeni, kështu “njollën” e të pakuptuarit, që e “fitoi” prej

---

29 *Shejzat*. - Nr. 10-12, 1971, f. 311-313.

Frano Kulli



ndërprerjes zyrtare, gjysmëshekullore të leximit. Poeti kombëtar, do të mund të zërë vendin që ka, nëse, duke u mësuar në shkolla, njohja dhe vlerat që mbart si thesar i kulturës sonë, do t'u transmetohen brezave. Thjesht do të mund të bëhej kështu, ajo që bëhet prej shekujsh në kombet e tjera të qytetëruara, ajo që bëhet në Itali me Dante-n, ajo që bëhet në Britani me Shekspirin, ajo që bëhet në Spanjë me Servantesin, në Gjermani me Gëten ...

*Shekulli, 14 prill 2014*

## Ndërmjet “Mitit dhe antimitit” të Tonin Çobanit

Tonin Çobani, zëdhënësi më serioz i veprës së poetit kombëtar Gjergj Fishta, për nga raporti komunikues mes tij e trashëgimisë letrare të poetit, së paku prej më se njëzet vjetësh, e ka shfaqur qysh heret, në fillesat e publikimit të studimeve të veta njëfarë droje përreth keqinterpretimit të mitit të Fishtës. Heret, qyshsekur do të botonte “Miti dhe antimiti fishtjan”, rreth dy dekada më parë ai e kish qëmtuar e pohuar këtë të vërtetë; këtë përpjesë (ndarje) të tij në dy të përkundërtat e veta, në të përndritshmen gati hyjnore (**mitin**) dhe në të zezën sterrë (**antimitin**).

*“At Fishta u bë pjesë e ndërgjegjes së civilizuar të popullit të vet si poet epik e lirik, si dramaturg, prozator e orator, si burrë shteti dhe aktivist i shquar shoqëror... Ky njeri poliedrik i veshur me petkun e zakonshëm të fratit, që i doli zot problemit të koklavitur shqiptar të gjysmës së parë të shekullit tonë [XX], dashje pa dashje krijoi rreth vetes një aureolë mitike.”* - shënon si veçori të studimeve të veta Tonin Çobani, zanafilla e të cilave nis me “Miti dhe antimiti fishtjan, Tiranë 1999.

Kur poeti ndërroi jetë dhe u nis për në botën e të shumtëve, këndej pati lënë mitin e krijuar përreth tij e veprës që la. Ai qe kthyer në një institucion të ndërgjegjes



kombëtare shqiptare; si i tillë një pikë referimi edhe për të huajt, për miq e për armiq. Por në pak vite, për shkaqe historike dhe jo letrare, miti përreth tij u rropos, ai jo vetëm që nuk mund të kujtohej, po nuk mund t'i përmendej as emri më. Erdhi pra kështu, me heshtjen vetë, antimiti, i cili ndau përgjysë kohëgjalljen me kohëvdekjen e Fishtës, sikurse u nda kështu në dysh edhe vetë miti i krijuar rreth tij.

Vdiq kështu miti dhe lindi antimiti.

Bash këtu, në të mesmen jetë-vdekje, dritë - hijë, lavdi e mallkim, rreket, gjatë gjithë kësaj kohe Tonin Çobani, në punën e paqtë studimore (pa tam tame e trumpeta), për të ndriçuar e shestuar këtë dyzim të krijuar "deus ex machina", shestim të cilin e kërkonte vetë e sotmja, letrare dhe jo vetëm. Qasjen tek miti i poetit, tani që koha kishte ndërruar e kërkonte nevoja për ta risjellë Fishtën në letrat shqipe dhe në kujtesën kombëtare gjithashtu, në vendin e vet të merituar. Jo për ta rikrijuar mitin përmes urrejtjes së antimitit, por për ta risjellë Fishtën përmes veprës së vet, pa lule e lajle, por edhe pa anatema. Përmes analizës sa më të thelluar të thelbit të veprës, e jo të imazhit (as vezullues as të sterruar).

Mbas "Mitit...", Tonin Çobani pason edhe me 4 libra të tjera studimore rreth kësaj figure shumëdimensionale, duke shtjelluar anë e linja të veçanta të veprimtarisë e veprës, vlerën e njëmendtë të saj. Me synimin fisnik për të ringjallë një mardhënie të fjetur me përdhunë të shqiptarëve me një simbolin e vet kombëtar, të lexuesit me letërsinë e tij, të cilën ia kishin shpallur të pavlerë, me njëqind epitete denigruese; prolixse, anakronike, folklorike etj, etj. Synim, të cilin e kanë shpërfaqur qysh heret, në vitet e para pas rënies së

rregjimit, shkaktari i vetëm i gjithë asaj çfarë ndodhi me Fishtë, edhe të tjerë dashamirë; qytetarë mbarë, po edhe ligjërues aulash universitare. Shumë syresh, duke sjellë për publikun, ende të ndarë pro dhe kundër, studime të vlerata përreth tij e veprës së vet. E kanë bërë dendur këtë, profesorë e studentë, kandidatë e doktorantë, sidomos viteve të para pas rënies së rregjimit, duke shuar kështu etjen publike, së paku për... përmendjen pa droje tashmë të Fishtës së anatemuar...

Kurse, Tonin Çobani nuk ka rreshtur, por ka vijuar ritmikisht në sipërmarrjen e vet studimore në përmbushjen e synimit fisnik. Edhe përgaditja në krye të një redaksie me studiues të njohur të korpusit të veprës vijon në kahjen e ringjalljes së kujtesës për vlerat tona të njëmendta...

Së fundi i është kthyer fillimeve letrare të Fishtës. Libri sapo ka dalë nga shtypi.

Dhe e hapur mbetet gjithherë ftesa për lexim. Jo enkas për librin e Toninit. Po, për leximin e veprës së Fishtës, më së pari. Se, prap e prap jemi tek imazhi, i cili edhe ai shpesh përcillet me shpërfillje "modernitare". Jemi prap ndërmjet fjalëve për mitin dhe antimitin. Jemi pra te zhguni i fratit a kostumi i diplomatit pa çékë (prekur) për së thelli forcën e fjalës e të veprimt të tij, çka përbën ashtin e kësaj krijese të posaçme të vlerës sonë kombëtare... Jemi pra në këtë qerthull. Me vetëdije a pa vetëdije, prej adhurimit apo... prej xhelozisë?

Tonin Çobani, po përpiqet prej vitesh të zhdavarisë këtë mjegull...

*Panorama, 6 tetor 2017*

## “Posta e Shqypnis’ “ e Tefë Topallit

Numri i fundit, i “Posta e Shqypnis’ “ këtë vit mbush të njëqindtat, që ka dalë nga shtypi. Dhe masandej aty është mbyllë. Kurse numri i parë ka dalë dy vjet më heret, me 5 dhjetor 1916 dhe në të shënohet: *“Fletorja del per gjith t’Merrkurre e t’shtunde. Drejtimi, mbarshtimi e shtypshkrimi: Shkoder, Kuvendi i Françiskajve. Drejtuer i gjegjshem P.Gjergj Fishta O.F.M.*

Nëqoftëse në historinë e publicistikës shqiptare, organe si “Albania” e Faik Konicës, revista më e madhe dhe më jetëgjatë e Rilindjes kombëtare, “Dielli” e “Vatra” në Amerikë, por edhe të tjera në kolonitë shqiptare në Rumani, Bullgari, Egjypt a tek Arbëreshët e Italisë janë të njohura e të lëvruara në kujtesën e opinionit të interesuar publik shqiptar, “Posta e Shqypnis’” nuk e ka pasë këtë fat. Për të është folur dhe sidomos është shkruar pak. Sigurisht, jo për nga pesha dhe rëndësia e saj në formimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare në një periudhë mjaft delikate të historisë së saj, në kohët e vështira të luftës së parë botërore. As për nga kualiteti publicistik në shumësinë e fletoreve të kohës. Por për një arsye tjetër kontraverse; se ajo u themelua dhe u drejtua

prej Gjergj Fishtës. Dhe e vijoi botimin me bashkëvëllezërit e vet, etërit e mëdhenj françeskanë, që përtej anatemave për to, të cilat zgjatën gati një gjysë shekulli, megjithatë kanë qenë pa mëdyshje në radhën e shërbestarëve më të spikatur të rilindjes e ringjalljes sonë kombëtare. Por duke bashkëpunuar edhe me të tjerë persona po kaq të denjësishtëm. Ndër to ka qenë edhe një ushtarak austrohungarez (duhet kujtuar se Shqipëria asokohe i ishte mirënjohëse perandorisë austrohungareze për mbrojtjen që ajo me diplomacinë e saj i kishte bërë e i bënte). Por... pati në *redakcionin* [redaksinë] e saj edhe një redaktor të gazetës vjeneze : “*Neue Freie Presse*” (1864-1937).

“*Posta e Shqypnis’* ” ishte e vetmja fletore shqipe që botohej atë kohë në Shqipëri... dhe qysh në numrin e saj të parë, ajo porositi: “*N’nji mëndyrë të posaçme po i porositen [porositemi- këtu i drejtohem] inteligjencës s’Shqypnieës s’Jugut. Fletorja e jonë nuk asht fletorja e krahinës së Shkodres; por asht fletorja e Shqypnieës s’madhe*”...

Prof. Tefë Topallit, në librin e vet më të ri “*FOL SHQIP*” i (Botimeve Fishta) me shkrime nga gazeta “*Posta e Shqypnieës*”, ka dashtë t’i ofrojë lexuesit të interesuar një lëndë publicistike të një organi shtypi të vlerë dhe njëherësh të theksojë pikërisht këtë mungesë të saj, sidomos në informimin e opinionit të interesuar sot.

I strukturuar në kapituj si: Tekste për gjuhën, Arsimi në vendin tonë, Zgjedhje për modele gjuhësore, Shkrime kulturore, Ceremoni vdekjeje dhe nekrologji dhe pjesa e dytë: Maximilian Lambertz-i në shkrimet për gjuhën shqipe botuar në gazetën “*Posta e Shqypnieës*”, libri sjell për lexuesin e interesuar një “jetëshkrim” të plotë të njëjës

prej gazetave politike e kulturore të dorës së parë të para një shekulli. Ky ka qenë synimi i tij i shpallur në krye të herës, në parathënien e librit të vet. Por autori, ndër më kompetentët e studiuesve të gjuhës shqipe, sjell gjithashtu edhe përsiatje të vlerta studimore për gjuhën tonë të shkruar në një periudhë kyç të historisë sonë siç ishte fillimi i shekullit të XX-të. "Posta e Shqypnieës" i shërben autorit edhe për të qëmtuar në temën gjithëherë "inkandeshente" të raportit të drejtshkrimimit të njësuem dhe dialekteve. Sidomos atij gegë i cili, referuar debatit gjithëherë zhurmueshëm për të gjatë rreth 30 viteve të fundit, ndjehet më shumë "i kërcënuar", më së tepërmi prej mos përdorimit, sidomos shkrimor. Por prof. Topalli, nuk mënon të shprehë mendimin e vet autentik që gjendet diku në mes të "inkandeshencës" së debatit: "Standartet gjuhësore - kumton professor Topalli - në çdo gjuhë të lavrueme t'i marrësh, nuk janë aq lehtë tronditshëm, këndeje dhe jo aq me vend zhurma dhe shetësimi pa shkak që ngrihet prej dy dekadash për disa koncepte teorike të standartit dhe raporteve të tij me variantet". Ndonëse ai dëshmohej i shkruem qysh prej dokumenteve të para të shqipes, e si i këtillë ka modele në të gjitha rrafshet e gjuhës sonë. Referuar studimeve bashkëkohore gjen arsyetime e konkluzione studimore që shkojnë nëpër këtë hulli : *"një gjuhë vazhdon të jetojë vetëm nëse mbetet e shkruar apo e regjistruar, në njëfarë mënyre, Kjo ngjet, sepse gjuhët e folura nuk lënë asnjë mbetje arkeologjike... mbase kur vdes një gjuhë që nuk është dokumentuar kurrë është njësoj sikur të mos ketë ekzistuar asnjëherë* (Crystal David. La rivoluzione delle lingue, il Mulino-Contemporanea, Bologna, 2005).

Por në kërkim e në vijim të shpresës, prof. Topalli e ka një shtjellë:” Ndoshta - kumton profesori - “gega i fundit” që shkruen “pastër” e me kompetencë në variantin e veriut është studiuesi i letërsisë dhe përkthyesi i njohun, dr. Primo Shllaku, i cili din “me luejtë”, njësoj me gjuhen e shkrueme (në prozë e poezi), në të dy dialektet, si në krijimtarinë origjinale të tijen, ashtu edhe në përkthimet prej disa gjuhëve... E ta kande që, përkrah mikut Primo me avitë edhe 2 emra tjerë: gazetarin kosovar Migjen Kelmendi e ma përtej përkthyesin e shkrimtarit Martin Camaj, Hans Joachim Lanksch-in, të cilët në tre shtete të ndryshme mbajnë një flamur gjuhe...

- Asnji dam nuk i vjen standartit gjuhësor prej përdorimit të njenit a tjetrit variant letrar - do të shprehej Justin Rrota po para një shekulli në “Posta e Shqypnis’ “ për gjuhen gjermane, asokohe të njësuar.

Në fundfaqet e veta libri ka 478 *footnote*. Përposë se si spjegime historike të fjalëve dhe idiomave të përdoruna në përditshmërinë e atëherëshme, por edhe si referencë kulturore e rrethanave të kohës, ato plotësojnë nevojën për të njohur funksionimin e jetës qytetëse të fillimshekullit të shkuar. Shumica janë spjegime fjalësh atëherë të përdorëshme e sot thuajse të vdekura. E kështu ata përbëjnë një fjalës, që njëherësh është një pjesë e begatë nga thesari autentik i shqipes, një pasuri thuajse e shkuar dëm prej harresës, rivitalizimi i së cilës i bën dobi gjuhës shqipe.

*Panorama, 15 mars 2018*

## Fishta si dëshmi e idenditetit shqiptar

*(rreth librit të Viktor Sopit,  
botim i Institutit Albanologjik - Prishtinë)*

Anjëherë nuk është e lehtë të shkruash për Fishten, njërin prej më të mëdhenjëve të kulturës sonë, të vlerësuar e gjykuar në një mënyrë të skajshme kontraverse, herë i rrokulluar si një mit e një tjetër herë i zhytur shtatë pash nën dhé me njëtin (synimin) për ta lënë gjithnjë të ndaluar. E megjithatë, gjithëpërfshirja kulturore dhe intelektuale e tij, në rolin e protagonistit, përreth një gjysmë shekulli, kurorëzimi që në gjallje si poeti kombëtar, vetë vepra e tij, e gjendur ndërmjet lavdisë superiore dhe mohimit absolut, ka qenë megjithatë gjithëherë joshëse.

Antologjia “Fishta-Dëshmi për idenditetin shqiptar” e Viktor D. Sopit, botim i Institutit Albanologjik Prishtinë, vjen si një rëquiem (lutje) i dëshiruar për Fishtën, por edhe si një pulsant kujtëse për veprën e vet dhe për lexuesin e saj gjithashtu.

Autori e sjell këtë buqetë antologjike të përzgjedhur me kujdes e dashuri, si një vlerë të shtuar në edicionet e deritanishme të veprës së Fishtës. Them të deritanishme, sepse sado të duket si punë e kryer, (tashmë vepra e tij e plotë në dhjetë vëllime është e botuar) paraqitja e veprës

së një shkrimtari klasik, siç është në gjithë dimensionin e vet Fishta ynë, asnjëherë nuk ka të sosur. Nevoja për të hulumtuar përreth tij dhe veprës është dhe mbetet e pambarimtë. Fishta, përbrenda një shekulli, atij të njëzetit përjetoi vlerësimin gati mitik në gjallje të vet dhe mënjanimin e përbuzjen tragjike, për gjysmën e dytë të këtij shekulli të mbushur me terr për fatin e shqiptarëve, natyrisht dhe të letërsisë e kulturës së tyre, në përgjithësi. E megjithatë u rikthye vezullueshëm, kur dukej e paimagjinueshme përndritja pas apokalipsit që ishte shfaqur për të...

Në përgatitjen e kësaj antologjie dallohet në rend të parë ndjesia misionare e autorit të saj; nevoja për të kontribuar edhe ai për idenditetin tonë kombëtar, nëpërmjet një dëshmie si Fishta. Ai arsyeton se: "... *leximi i veprës së pasur poetike të Fishtës, në çdo kohë ndihmon në formimin e ndërgjegjes kombëtare dhe në ngritjen e moralit qytetar.*"<sup>30</sup>

- *Apostull të lirisë së atdheut dhe misionar të kulturës shqiptare* - e çmon diku tjetër ai në vlerësimet e nxjerra nga vëzhgimi i hollë prej studiuesi, por edhe nga vetë qenia e tij intelektuale në mision.

Kurse struktura e librit antologjik, siç e ka zgjedhur ta parashtrojë autori ka në bazë përzgjedhjen e një lënde të larmishme e shumë të pasur poetike të Fishtës, duke nënvizuar idenë se Fishta nuk është vetëm "Lahuta e Malcis" e vlerësuar si eposi i shqiptarëve të shekullit të njëzetë. Sopi e sheh Fishten edhe "si lirik të veçantë, si

---

30 *Fishta si dëshmi e idenditetit shqiptar, fq.25*



*satirik të veçantë dhe si poet që shkruan me shumë mjeshtri e inovacion poezi reflektive e religjioze*<sup>31</sup>. Dhe pasi ta kesh kundruar librin e beson dhe përjeton gjithësisht kumtin e autorit të antologjisë.

Mendoj se kjo është jo vetëm risi për librin, por është vetë risia e botimeve dhe ribotimeve këtu e këndeje, të veprës së klasikut të madh. Por edhe gjithçka tjetër rreth saj. Është tamam kjo që vjen si nevojë e lexuesit të tij dhe këtë nevojë e dëshirë, autori i antologjisë: “Fishta-dëshmi për idenditetin shqiptar” jo vetëm ka tentuar ta bëjë që në krye të herës, duke fiksuar në laboratorin e vet këtë linjë, por edhe ia ka arritur ta sendërtojë më së miri atë. Jo vetëm përzgjedhja me sqimë e finesë e tekstit poetik, por edhe shqyrtimi analitik që i paraprin cikleve poetike të përzgjedhura, ia bën lexuesit të lehtë kuptimin, por edhe përndijimin e shijimin maksimal të vlerave sipore estetike të artit fishtian.

Përzgjedhja e poezisë “Methamorphosis”<sup>32</sup> në ciklin prej 8 poezish satirike të Fishtës dhe bashkëlidhja interpretative e bërë nga autori i antologjisë, për satirën e Fishtës ka kërkuar edhe kompetencë njohëse, por edhe kurajo intelektuale, për t’u ballafaquar me keqkuptimin shpartallues (me dashje) në dëm të autorit dhe të veprës, që ka vijuar për një kohë të gjatë tepër. Kjo ka ndodhë mjaftueshëm duke shkëputur nga konteksti logjik dhe satirik i poezisë, strofen:

---

31 *Fishta si dëshmi e idenditetit shqiptar*, fq.26

32 *Gjergj Fishta-vepra, “Botimet Fishta”vëll.7, fq.35*

*Ta dijë Shqypnija  
Pra, e sheklli<sup>33</sup> mbarë,  
Se mâ mbas sodit  
Unë s'jam Shqyptar.*

Kurse sa i përket ciklit të poezive me motive religjioze dhe meditative, pastaj këtu, sigurisht që dom Viktori ndjehet shumë më në fushë të vet. Duke i paraqitur në antologji, të përcjella me analizën e komentet që ai bën për to, padyshim që siguron për lexuesin e Fishtës një kod e një çelës të ri leximi, sidomos për atë zhanërr poetik siç është cikli i poezive të tilla. Që në krye të herës, për arsye studimi, por edhe për të sugjeruar një mënyrë leximi të tekstit letrar, autori i antologjisë i ndan në dy grupe a lloje këto poezi. Në grupin e pare: poezitë **fetare dhe meditative** ai zgjedh e komenton shtatë prej tyre , origjinale të Fishtës, por edhe shqipërime nga Manxoni, bie fjala, si “Të ngjallunit” etj, që përbëjnë një cikël të frymëzuar prej ungjillit (Biblës). Kurse një lloj tjetër i dytë fillon me “Të grishun për muej të Majit” e mbyllet me poezinë “Zoja e Shkodres” dhe përmbledh disa prej poezive fetare **formative**, siç i kategorizon dom Viktori. Tipike në këtë lloj, ai veçon poezinë “Urata e atdhetarit shqyptar”. Në këtë poezi autori vë në gojën e atdhetarit shqyptar një lutje për Zojen e Këshillit të Mirë (Shën Marisë), Pajtores së Shkodres dhe dashamirëses së popullit shqiptar...

---

33 Sheklli (shekulli) -këtu: bota, njerëzit.

*Ndritjau menden Shqyptarvet,  
Qi t'lidhin besë e fe  
E si motit për Atdhe  
T'qindrojnë këta me gajret,  
Qi mos t'u dhimbet jeta  
Për t'mbrojtun dhen e t'Parvet.*

Posë sa më sipër, Antologjia përmban edhe një tubë (cikël) elegjish, lloj për të cilin, autori thotë se nuk “është bërë fjalë sa duhej”. Më duket se edhe këtë e ka arsyetuar mirë, duke i vënë kështu kapak një libri të vlefshëm me poezi mjaft përfaqësuese të Fishtës, një libër deri më tani i munguar...

Përveç përzgjedhjes së poezive të paraqitura në antologji, qoftë mbi motivin e mesazhin që përcjellin, qoftë për nga vlerat artistike me të cilat ato janë realizuar, një tjetër vlerë me shumë peshë në antologjinë e Viktor Sopit është paisja e saj me shënimet filologjike, që në rrafsh studimor shfaqin e mishërojnë një seriozitet të madh. Janë jo më pak se 373 sythe të tilla shpjeguese, për fjalë e fraza të përzgjedhura dhe të përdorura prej poetit nëpër rreth 40 vite të krijimtarisë së tij, gati një shekull më parë dhe jo në më shumë se në 63 poezi të paraqitura në antologji. Një produkt dhuratë për gjuhën shqipe, për përdoruesit e saj dhe veçanërisht për lexuesit e pasionuar të Fishtës.

Filozofia arsimore e Fishtës <sup>34</sup>

Me botimin e plotë dhe në disa versione të veprës letrare të shkrimtarit të shquar shqiptar Gjergj Fishta, lexuesi i interesuar është tashmë i njohur në mënyrë të gjithanëshme me krijimtarinë letrare shumë të gjërë të njërit prej krijuesve më në zë të letrave shqipe.

Gjergj Fishta, autori i “Lahutës...”, prej së cilës ai është cilësuar “Homeri shqiptar”, pas një heshtimi të gjatë, të detyruar prej rrethanave që dihen, tani ai është rikthyer i botuar e i rilindur. Si rrallë tjetër krijues, ai nuk paskësh qenë harruar, ndonëse komunikimi me të qe hermetikisht i mbyllur për gjithë këtë periudhë kohe. Shkrimtar me një kolanë kaq të gjatë, e njëherësh edhe kaq vezulluese, është sot i pranishëm në botën e leximit me gjithçka esenciale të krijimtarisë së vet, e cila është kaq e larmishme. Siç është shprehur njëri prej vlerësuesve të krijimtarisë së tij letrare, intelektual i bashkëkohësisë së Fishtës, Lefter Dilo: “Ai lëvroi të gjitha gjinitë dhe në të gjitha ka shkëlqyer.

---

34 *Parathënie e librit “Filozofia arsimore e akademikut Gjergj Fishta”, të Mark Vujit*

I gjithëvlerësuar si poet lirik i spikatur e përkthyes i saj gjithashtu; epiku, padyshim më i madh i kohës dhe pikë referimi për shumë gjatë; satirik i hollë dhe model për t'u ndjekur; publicist i pakrahasuar; analist e polemist *par excellence* dhe stilist i shkëlqyer, ai u formatua në historinë e letrave shqipe si një krijues shumëdimensional. Elitar me sqimë aq sa edhe popullor deri në përjetësi ai shfaqet përherë aktual, si shkrimtar dhe si mendimtar.

Gjergj Fishta që ndërkohë një veprimtar aktiv shoqëror dhe një patriot i madh, intelektual me devocion të jashtëzakonshëm, me një ndikim superior në jetën e vendit, kontribues i fuqishëm i çështjes kombëtare ende të pa zënë vend. Një humanist dhe përndritës i madh, ndër më të mëdhenjtë humanistë të Shqipërisë në gjysmën e parë të shekullit të njëzetë, me aspirata dhe kontribute të fuqishme në fushë të dijes dhe të shkollës shqipe.

Ky ka qenë edhe një tjetër dimension special i kësaj figure poliedrike, për të cilin është folur e shkruar më pak. Ka qenë, si të thuash, një pamje e eklipsuar disi nga dendësia dhe "rëndesa" specifike e asaj veprimtarisë tjetër të gjërë, sidomos e krijimtarisë poetike, e cila në fund të fundit, ka qenë e botuar dhe e ribotuar, madje një pjesë syresh si epika, e mësuar përmendësh, gati njësoj si letërsia gojore e popujve. Këtë dimension tjetër të Fishtës, bën të na e përcjellë nëpërmjet librit të tij "Filozofia arsimore e Gj. Fishtës", pedagogu - "Mësues i Popullit", Mark Vuji.

Libri është ndër të vetmit studime të plota, në mos i vetmi, të bëra deri tani, që rrok këtë dimension shumë të rëndësishëm të veprimit intelektual të Gjergj Fishtës, të kontributit të tij madhor për dijen e shkollën shqipe,

për tharmimin dhe zhvillimin e mendimit pedagogjik shqiptar. Dhe në këtë kuptim , ky libër vjen përposë se si nevojë edhe si një risi, në botimet e sotme.

*-Meqë u mora me studime pedagogjike - thotë ai - dëshiroja të shkruaja diçka për mësuesin e madh At Gjergj Fishta... Unë alfabetin për të cilin ai dha një kontribut të shquar për ta vënë në duart e shqiptarëve, e mësova në shkollën e tij, nën kujdesin e mësuesit të talentuar Atë Lekë Luli...*

Dhe mendoj se është i mjaftueshëm ky fakt impresionant, për tu besuar se motivi i madh, shtysa e parë e fortë për t'i hyrë kësaj sipërmarrje e ka prirë në këtë rrugë, autorin e librit... I parë në tërësinë e vet, pa hyrë në detajimin e elementëve strukturorë e stilistikë , mbi të cilët është mbështetur libri, sheh dallueshëm dy shtyllat kryesore mbi të cilat ai mbahet; eksperiencia aktive arsimore e Fishtës në shkollën shqipe; atë fetare kryesisht, por sakaq kombëtare gjithashtu, nga njëra anë dhe nga ana tjetër platforma teorike ku qe mbështetur mësimi në këto shkolla dhe sistemi arsimor në tërësi, që autori e ka konceptuar dhe përcjellë në libër si Filozofia arsimore e Fishtës. Si ndërlidhje e të dyjave është eksperiencia e pasur në këtë fushë e Fishtës vetë, drejtorit të liceut të famshëm shqiptar “Illyricum” në Shkoder, një shkollë që për nga kualiteti profesional është në rresht me shkollat bashkëkohore të Europës Perëndimore. Prej dyerve të saj, kanë dalë nxënës me formim po kaq bashkëkohor e oksidental sa vërsnikët e tyre në Europë. Dhe kjo ka ndodhur sepse eksperiencia e pasur ka qenë përfutur më së pari nga aplikimi i një platforme teorike, shkollareske-

Frano Kulli

didaktike e një niveli po kaq të lartë, i një mendimi pedagogjik, fort të pasur e gjithnjë në rritje..

Libri është produkt i një hulumtimi shumë të gjatë të autorit të tij. Kjo dallohet lehtë dhe menjëherë. Mjafton t'u drejtohem referencave të lëndës së konsultuar nga ai, për tu bindur se e ç' dimensioneve të mëdha ka qenë puna që i është dashur studiuesit Vuji, për të arritur tek ky libër, aspiratën e tij të herëshme, por edhe të fshehur për një kohë të gjatë, për arsye që janë të njohura tashmë... Dhe kjo, padyshim është shkak i mjaftë për të shfaqur mirënjohje për të. Në botimet për Fishtën , ky libër vjen si një botim i munguar...

*31 korrik 2007*

III.

Martirët  
dhe ndërgjegjja jonë e përlyeme





Një lutje për Martirët  
në sheshin “Nënë Tereza” ...

Martirët e Kishës katolike në Shqipëri, saktësisht 38 prej tyre, qysh prej nëntorit të vitit 2011 janë në “pragun” e derës së kanonizimit dhe lumturimit të tyre si martirë, në Selinë e Shejtë. Janë përcjellë atje pas një pune përmbledhëse faktesh e të dhënash prej një komisioni të mirëzgjedhur në një proces dioçesan dhe më pas, të vlerësuara e gjykuara në vërtetësinë e tyre, prej një jurie prestigjioze. Është vepruar me atë metodologji skrupuloze dhe precize për nga saktësia ashtu siç dijnë t’i bëjnë punët në aulat e Vatikanit.

Kandidatët për lumturim, martirët janë kryesisht meshtarë por edhe laikë, të ndjekur e martirizuar për shkak të besimit në kohën e diktaturës komuniste, të asaj monstrës, që me ideologjinë e vet kundër besimit e Zotit, në paranojën për t’u shpallur ajo vetë Zoti e filloi “pastrimin” e shtrimin e rrugës së vet, mjerisht të gjatë, me therorizimin pikërisht të njerëzve të fesë e besimit. Kurse njëri prej dy Gazullorëve të mëdhenj, dom Gjon Gazulli, sigurisht shënuar edhe ai në aradhën e martirëve kanonikë, u dënua me vdekje nga rregjimi mbretëror,

më 2 janar 1927. As protestat e Vatikanit, aso kohe dhe të disa shteteve të tjera europiane nuk e ndalën vendimin jetëmarrës të klerikut atdhetar, por dhe një kundërshtar i fortë i rregjimit njëherësh. Fjalët e tij të fundit, të përcjella nga një dëshmitar okular i momentit të ekzekutimit të Gazullorit të shquar qenë: “Po des i pafajshem. Rrnoftë Krishti, Mbreti ynë! Rrnoftë Kisha Katolike, Nana jonë! Rrnoftë Papa, Ati ynë! Rrnoftë Shqipnia dhe shqiptarët e vërtetë!” ...

E varën te “Fusha e Druve”, në Shkodër. Kurse vëllai i Dom Gjonit, dom Nikollë Gazulli edhe ai, i burgosur njëherësh me të vëllanë, iu shpëtoi torturave dhe vdekjes nga Ahmet Zogu, por nuk i shpëtoi dot pushkatimit në vitin 1946 nga Enver Hoxha. Ani pse të dy vëllezërit qenë pinjollë të Gazullorëve, të Gjon Gazullit të famshëm të shekullit XV-të, Ambasadorit të Gjergj Kastriotit në Raguzë (Dubrovniku i sotçëm) shkencëtar ndër më të shquarit në Europën e shek. XV, matematikan, astronom... profesor i Universitetit të Padovës në Itali.

Historitë e martirëve katolikë janë sa të trishta për nga vuajtja, aq kauzale dhe heroike për këtë shkak. Të gjithë, padallim sa ishin të përkushtuar në besimin, në misionin dhe në kauzen e tyre, po aq atdhedashës ishin; modeli më i vërtetë i frymëzimit popullor për liri dhe prosperitet. Gjithmonë në kahun e së mirës dhe të dobishmes.

Rruga e kanonizimit të lumturimit të martirëve ka nisë me këta, pasi u shpall më 10 nëntor të viti 2002, nga prefekti i asokohshëm i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve, kardinali Kreshencio Sepe, gjatë kremtimit të Eukaristisë, në Katedralen e Shën Shtjefnit të Shkodrës.

Me vullnesën e Zotit, në mënyrë që vepra e tyre të shërbejë si shembëlltyra e dashurisë së pa skaj të njeriut. Ajo gjë, për të cilën ka veçanërisht nevojë të madhe e sotmja e shoqërisë njerëzore. Martirët e kishin mishëruar në vepren dhe në gjithë jetën e vet mësimin e Hyjit, në çastin kur po e kryqëzonin (Fali o Zot se nuk dijnë se ç'bëjnë). Kështu kanë bërë edhe martirët e Kishës në Shqipëri; "Fali o Zot!, janë lutur edhe ata për... skuadrën e pushkatimit të tyre.

Kundruall ditëve që kalojnë dhe afrojnë 21 shtatorin e Vizitës së Atit të Shejtë në Shqipërinë tonë rri pritja jonë me adrenalinë në rritje. Siç ndodh zakonshëm në momente emocionesh të mëdha, që sa më shumë i afrohen çastit solemn vijnë në rritje të vijueshme deri në pikën e "vlimit" të tyre. Për shqiptarët, pa dyshim është me të vërtetë një ditë e lume, kjo s'ka nevojë për koment. Njëra prej atyre ditëve që shqiptarët i kanë patur të rralla në historinë e tyre. Ndaj dhe e çmojmë, padyshim dhe presim shumë prej asaj dite, kur fryma e Mesazhit të Atit të Shejtë do të përhapet në atmosferën e Shqipërisë. Unë besoj se kjo është ndjesia pa diferencë e të gjithëve këtu, edhe e atyre që nuk ndajnë të njëjtin besim dhe që Kishën katolike nuk e kanë institucionin e besimit të tyre. - *Dëshiroj të përforcoj në besim Kishën në Shqipëri e të dëshmoj inkurajimin dhe dashurinë time ndaj një vendi që ka vuajtur gjatë pasojat e një ideologjie të së kaluarës - ka arsyetuar në kumtin e vet, vizitën që do të bëjë në Tiranë, me 21 shtator Papa Françesku. Drejt përdrejt, pa asnjë ekuivok. Sheshi "Nënë Tereza" plot me siguri, ka për të qenë dëshmia e respektit dhe adhurimit për vizitën dhe lutjet e Tij. Për katolikët, që Ati i Shejtë dëshiron t'i përforcojë në fe, për të gjithë shqiptarët, njerëzit e një*

Frano Kulli

populli që ka vuajtur gjatë, gjatë pasojat e një ideologjie të së kaluarës... Është posaçërisht e veçantë dhe shumë nderuese për ne si komb kjo qëndresë e pashembullt në besim përgjatë kalvarit të gjatë martirizues e prelatëve të Kishës. Sigurisht është filizi dhe dega e pathyeshme e rrënjëve tona të lashta të krishtërimi. Martirizimi i tyre nën shembullin e Hyjit dhe vlerave të humanizmit, që ata kanë besuar është edhe një vlerë e jona universale qytetërimi. Turpi është për masakruesit, mëkatarët diktatorë, nderi është për Shqipërinë e shqiptarët. Për martirët, së pari. Adhurimi për të do të na përforcojë në besim e në dashuri dhe jo harresa ...

*Panorama, 13 gusht 2014*

## Shenjta Nënë Tereze, lutu për ne... !

E lumja nënë Tereza, shenjtëneshja më e re e kishës dhe e njerzimit mbarë, shfaqet në Sheshin “San Pietro” në Romë, të djelen me 4 shtator, në dimensionin e Shenjtes së Dashurisë dhe Mëshirës. Vjen si “dërgatë” e kongregatës (Urdhërit) së Misionarëve të Bamirësisë. E krijuar prej saj dhe më pas e miratuar prej Ipeshkvit të Kalkutës dhe “*Propaganda Fide*” në Romë, kështu ajo fiton «legalitetin» për të ndërtuar e perfeksionuar mbretërinë e saj të përshpirtëshme të dashurisë dhe mëshirës në tokë. Në fillim e përgjithmonë në Kalkuta të Indisë, por më pas edhe anë e mbanë botës. Në 123 shtete, rreth 750 shtëpi bamirësie, në të cilat gëlojnë më se 4000 motrat me uniformën bardh e kaltër të kongregatës së bamirësisë. Pa shënuar këtu edhe shtëpitë e shërbesat e vëllezëve kontemplativë (soditës, kundrues).

Më pas, së bashku me Atë Sebastian Vazhakala ka themeluar edhe “Misionarët Laikë të Dashurisë”, një lloj urdhëri i Tretë i Misionarëve të Dashurisë.

*Atë Sebastiani, njëri nga 6 vetët që mbante arkëmortin me kurmin e Nënë Terezës, në ditën kur nisi pavdekësia e saj, me 4*

shtator 1997, është njëherësh edhe mbartës i shumë kujtimeve të rëndësishme, përshkruar në kronikën e kësaj miqësie hyjnore në 30 vite jete pranë Nënë Terezës.<sup>35</sup> Bashkëpunimi me të na ka sjellë edhe në shqip, pas botimit në shumë gjuhë të botës kroniken e e përndritëshme pranë Nënës së Lume...<sup>36</sup>. Më pas... Më pas, kështu deri në në çastin që shpëtohet prej botës së tokës drejt botës hyjnore të qiellit, pa u ndalur asnjëherë, në shërbesën e mëshirës për nevojtarët e gjithsojshëm e të gjithkundgjindëshëm (kudondodhur). Ajo i apelon njerëzimit, sot e përgjithmonë, nevojën e përjetëshme për më shumë dashuri ndërnjerëzore, për më shumë vëmendje prej të pasurve për më të varfërit e të varfërve, për më shumë drejtësi prej atyre që kanë në dorë pushtet, për më shumë afri e mbështetje prej të fuqishmëve për të pafuqishmit, për më shumë buzëqeshje, si ilaç për dhimbjet.

-Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe - do ta përsëriste shpesh si devizën e misionit të saj, Nënë Tereza-... Se gjërat e mëdha i bën tjetërkush...

Kur Nënë Tereza kishte fituar Çmimin Nobël të Paqes, në vitin 1979, e takon mbreti i Suedisë e i thotë:

- Unë, nuk po vij në ceremoni. Nuk dua që të jem në qendër të vëmendjes!

---

35 Visar Zhiti, parathënia e librit: *Miqësia ime tridhjetëvjeçare me nënën e të varfërve*, Enti Botues "Gjergj Fishta", 2008

36 Atë Sebastian Vazhakala M.C "Jetë me Nënë Terezën-Miqësia ime tridhjetëvjeçare me nënën e të varfërve", Enti Botues "Gjergj Fishta", 2008

## Kohë e përlyeme

- Madhëri! Mos nguroni të vini- i thotë Nënë Tereza - në qendër të vëmendjes nuk do të jeni, as Ju e as unë. Aty ku është Zoti, nuk bie në sy mbreti!

Shenjtërimi i saj vjen pas lutjeve të pandërprera kurrë asnjëherë, për asnjë çast të vetëm dhe vjen gjithashtu pas veprave të përditëshme e të përorëshme duke jua kushtuar gjithçka të përshpirtëshme të saj, të varfërve, të uriturve deri në pragvdekje, të pamundurve e të papërkrahurve.

Sipas ritualit kanonik shenjtërimi i saj vjen, pas shpalljes *E lume* trembëdhjetë vjet më parë, si mrekullibërëse, si shëruesja e një gruaje indiane të sëmurë me sëmundje të pashërueshme. Me vargun e paprerë të lutjeve, me shpirtin dhe me duart e sajë të imta.

Aty, në Sheshin "San Pietro" do të jemi edhe ne, shqiptarë të ngadoardhur. Me siguri do të ndjehemi ngrohtë nën mbulojen e shenjtërisë së saj. Si gjithë të tjerët, natyrisht. Patetika nuk vlen, heshtja më shumë. Dhe lutjet e saj për ne. Shenjtja jonë Tereze, lutu për ne mëkatarët, lutu për dashurinë e acaruar mes nesh, lutu dhe kërko mëshirë për të shtypurit nën pabarazinë. Si në qiell, ashtu në tokë... Amen!

*Shekulli, 3 shtator 2016*



## Martirët dhe... ndërgjegja jonë e përlyeme

Lumturimi i 38 martirëve shqiptarë nga Kisha e përbotëshme katolike është një nga ato ngjarje që, për nga pesha që ka, por edhe duke mos qenë e zakonit, zënë vend në historinë e kombeve. E paraprirë me gjestin e emnimit Kardinal prej Papa Françeskut, të njërit prej të mbeturve ende gjallë, mbas kalvarit të gjatë të golgotës së mundimeve, Dom Ernest Troshanit, kjo ngjarje është shumë nderuese për ne shqiptarët... Dhe vjen fill (më pak se 2 muaj) pas shenjëtarimit të së Lumes Nënë Tereze, prej tharmit dhe genit tonë.

Është theksuar jo vetëm njëherë se vendi që zë numri 38 i martirëve shqiptarë, nga një popull me më pak se 2 milion banorë asokohe kur flijoheshin ata, në rreth njëmijë martirë të lumë të kishës Universale katolike, përgjatë gjithë ekzistencës së saj, na renditë ne, me plot arsye ndër vendet më të martizuara të Europës. *Ndër një miliard e treqind milionë katolikë që ka sot në botë, një bashkësi prej rreth 500 mijë katolikësh [në Shqipëri] nxjerr prej parzmit të saj 38 martirë...*<sup>37</sup>

---

37 Albert Nikolla, gazeta "Mapo" 08 tetor, 2016

Kleri, elita e fesë, por edhe elitë e kombit gjithashtu, e cila qe kundruall ideologjisë komuniste, që në zanafillë të saj ishte e gatëshme për të rezistuar, qoftë edhe duke u martirizuar. Sepse ajo ideologji, në thelbin e vet kishte kundërshtinë e fesë si dogmë e si besim, por edhe sepse kjo elitë e parandjeu, se sistemi politik që do të ngrihej mbi atë ideologji, do të sillte rrënimin e vlerave dhe gjithë ngrehinën morale të njeriut.

*-Kur të jenë orarë meshtarët, ju duhet ta mbani të gjallë fenë në Zotin, në zemrat e familjarëve tuaj. Komunizmi asht i përkohshëm, feja asht e perjetshme - do të thoshte At' Çiprijan Nika.<sup>38</sup>... Dhe, njëmend Atë Çiprijani do të dënohej me vdekje. Do të dënohej për... veprimtari kundër pushtetit popullor! Po, përveçse ushtrimit të besimit dhe predikimit të tij ndër besimtarë, besimit në Fe e Atdhe por edhe mospajtimit hapur me tërësinë e botkuptimit marksist, mishëruar në veprimin e komunistëve, çfarë krimi tjetër kishte bërë ai dhe ata?!*

Me sakrificat vetmohuese dhe kryqet e tyre ata ishin farkëtuar si martirë... me besim e bindje në Hyjin e gjithpushtetshëm. (Një Enciklikë "Divini Redemptoris" e Papa Piut të XI e datës 19.03.1937 është e dedikuar në mbarë Kishën si pamflet kundër marksizmit. Si teori e si praktikë ateiste.)

Por jo vetëm elita, qe e palëkundur në rrugën e drejtë të lirisë e të besimit. Tre prej martirëve janë laikë, malësorë

---

38 *Kujtime të Antoneta Lacaj, ish nxënëse në liceun e Motrave Stigmatine- "At Leonardo Di Pinto, Profil historik hagiografik, vëll. II, fq.45*

e puntorë; Gjelosh Lulashi, Fran Miraka dhe Qerim Sadiku. Qerimi, prej Vuthajve të Gucisë, ndonëse me emër mysliman, praktikant i besimit katolik me devocion të thellë. Me banim në Shkodër, në punë të vet me një tregtore të vogël; më heret në shërbesë të xhandarmërisë, por frekuent i meshës të së dielës. Katolik i devotshëm, i gatshëm për t'u martirizuar për fenë e vet, si sejcili besimtar i fesë së Krishtit, sipas thirrjes dhe fuqisë së vet shpirtnore... E shoqja, Marija, do të përcillte fjalët e tij, në njërin prej dy takimeve që e kishin lejuar të kishte me të:

-I raskapitun prej torturave, më tha: *"Jam i vendosun. Unë jam shqiptar e katolik. E ket fakt nuk e mohoj kurrë."* Pa ngurrue me dhanë edhe jetën, duke merituar kështu Palmën (larin) e martirit. Kurse para skuadrës së pushkatimit, fjalët e tij fundit kanë qenë: *"I fali të gjithë ata që, në çdo kohë mund të më kenë ba keq. I fali edhe ata që më kanë dënue me vdekje edhe ata që do të më pushkatojnë. Rrnoftë Krishti Mbret, Rrnoftë Shqipnia!"*<sup>39</sup>

At Giovani Fausti, i refuzon akuzat për veprimtari armiqsore në dëm të Shqipërisë duke saktësuar se: *"Jam dërgue në Shqipni si misionar i fesë dhe jo si aktivist partiak, por komunizmin e kam kundërshtue gjithmonë si doktrinë ateiste. Ndërsa, në ditën e mbrame, para skuadrës së pushkatimit do të thoshte: "Jam i gezuem që vdekja më gjen duke krye detyrën time...M'i përshëndetni Jezuitët,*

---

39 Procesverbali i fjalëve të fundit para pushkatimit, me 4 mars 1946, mbajtur nga Tonin Miloti, në detyrën e zëvendës prokurorit: *"Imzot Vinçens Prenushi me shokët martirë, vëll. II, fq.402, botim i Arqipeshkvisë Shkoder-Pult 2016*

*seminaristat, Delegatin Apostolik [Të lumin Imzot Frano Gjinin] dhe Arqipeshkvin [Imzot Gasper Thaçin]. Rrnoftë Krishti Mbret!... - do të thoshte në fjalën e fundit, para pushkatimit. (Procesverbali i fjalëve të fundit para pushkatimit, me 4 mars 1946, mbajtur nga Tonin Miloti, në detyrën e zëvendës prokurorit:)<sup>40</sup>*

Është edhe një tjetër laike ndër to, Marije Tuci... Ajo gjëndet e vdekur prej torturave, çnjerzore në një ditë të tetorit të vitit 1950 në spitalin e burgut. Përreth gishtave të shndërruar në kocka - gjymtyrë i gjendet një gjysë e Rruzares (*varg me rruaza, që kaloheshin me gishta, duke thënë lutjen, te katolikët. Fjalori i Gjuhës së sotme Shqipe, Tiranë 1980*) së zverdhur... Eksperti i sigurimit Hilmi Seiti e kishte "hanger për së gjalli" ...

- Do të të shpërftyroj deri në atë pikë sa as familja jote nuk do të të njohë - i kish thënë.<sup>41</sup> Dhe në të vërtetë, ashtu kishte bërë, makabriteti i tij kishte arrit në skaj...

E gjithë kronika e tyre martire, kullon gjak e tmerr. Lazer Shantojës, në tortura ia kishin thyer gjymtyrët. Veçse nuk e kishin gozhdue, mandej si Krishtin në kryq. E kujt, një dijetari si ai; publicist, që për nga erudicioni mund të kishte të ngjashëm Faik Konicen e madh. Muzikant - pianist, i pari shqiptar që njihte gjuhën esperanto, përposë të gjitha gjuhëve të tjera të mëdha europiane. Atdhedashës si ai... Në ditët e mbrame kur torturat tashma e kishin sjellë në buzë të vdekjes e lejojnë t' amën ta vizitojë. Dhe kur e sheh, ajo u lutet me përgjërëm policëve të burgut:

---

40 *Imzot Vinçens Prenushi me shokët martirë, vëll. II, fq.270.*

41 *Imzot Vinçens Prenushi me shokë martirë, vëll. II, fq.418.*

-Ma vritni..., bajeni këtë mirësi... e mos ma leni djalin me vuejtë mâ kështu..., aman ma vritni sa ma parë. Lekët e plumbit jua paguaj vetë...<sup>42</sup>

Ashtu siç është kumtuar, lumturimi do të ndodhë me 5 nëntor dhe kumti do të shpallet në Shkodër. Sigurisht edhe kjo një simbolikë më vehte. Në Shkodër, sepse aty është edhe "skena" ku u luajt drama, në kufijt e tragjedisë. Aty nisi me radhë interpretimi i akteve të vepres makabre. Kuvendi i Fretënve (franceskanëve) të Gjuhadorit u ba edhe hetuesia edhe prokuratura edhe gjykatorja, ku prokurorët e gjykatësit e sapozbritun prej malit po ndanin fajësinë e bashkë me të vdekjet mizore të atyne..."fajtorëve" të pakurrfarëfaji. Aty u eksperimentuan torturat çnjerëzore, të ngjashme me torturat naziste të Auschwitz-it. Në ndejëset e redaktorëve të "Hyllit të Dritës" u ulën "drejtësibërësit" e rregjimit të "ri". Dhe që aty nëshkruan vdekjet makabre të atyre që bënin... libra, kulturë dhe shërbenin kauzën e Shqipërisë, të atdheut të tyre të shtrenjtë.

Sejcili prej martirëve, me vullnet e me besimin në Hyjin i ka falë ata, xhelatët e tyre. E kanë bërë zëplotë dhe besimplotë, në ditën e tyre të mrame në këtë botën e këtushme. Të bindur dhe të paqtë, në gjithçfarë po bënin. Kurse këta të fundit, xhelatët, serbes e krenarë si atëhere, për vepren e tyre, nuk janë shfaqur kurrë në pendesë. Prej më se një çerek shekulli është pritur, më së paku një *mea culpa* prej tyre, për krimet e bëra. Por kjo nuk ka ndodhë deri sot. E as ka gjasë se mund të ndodhë edhe këtu e

---

42 Imzot Vinçens Prenushi me shokët martirë, vëll. I-rë, fq. 330

## Kohë e përlyeme

këndeji. As përkrahësit e idhtarët e tyre akoma nuk kanë shprehur, së paku një qortim për ta. Ata që ndajnë pushtet në emër dhe me aspiratën e “drejtësisbërësve të malit”. Se nuk mundej ndryshe të... dekorohet e të shpërblehet njëri syresh, Shyqyri Çoku. Se nuk mundej ndryshe të ruhen e të arkivohen bëmat e urdhërdhënësit të krimeve, e protektorit të mizorive me vepra e terma sugjestionues, “shtëpia e gjetheve” “bunkerit” etj. Me spërdredhje të asisojëshme si: “le ta gjykojë historia”... Nuk mundej ndryshe që fotot e diktatorit të zënë thuajse përditë faqe gazetash e ekrane mediesh publike edhe tani kur në Austri është marrë një vendim për ta prishë shtëpinë e Adolf Hitlerit...

Por... unë jam i bindur se idhtarë të tij pushtetarë nuk do të mungojnë në ditën e lumnimit të martirëve. Edhe atë ditë, prapë ata do të jenë aty, me gjestet e tyre prej kameleoni të gjasme nderimit për ta. Në qendër të vemendjes, përballë fotoreportereve, bliceve, gazetarëve, pankartave; të përdëllyer duke mbajtur fjalime...

Sa për të na bërë ne të tjerëve të harrojmë, pse jemi mbledhur sot...

*Panorama, 29 tetor 2016*

Moter Marija, dom Ernesti  
dhe refuzimi i diktatorit

Motër Marije Kaleta, ajo murgesha që me rrëfimin e saj me 21 shtator përloti edhe vetë Papa Françeskun në Katedralen e Shën Palit në Tiranë, ia ka kushtuar heret jetën besimit tek Zoti. Që nga momenti i shfaqjes së thirrjes, në Kuvendin e motrave stigmatine në Shkodër dhe pas pak vitesh e nxjerrë jashtë me dhunë, në marsin e vitit 1946 bashkë me simotrat e tjera stigmatine, nuk është shmangur për asnjë çast nga kjo rrugë. Prej aty kthehet në Pistull, në fshatin ku familjen e saj, dy prindërit Ejllin dhe Shuken së bashku me të, i kishte sjellë dom Ndoc Suma, xhaxhai i saj i caktuar famullitar në atë fshat. Aty, ajo ka përcjellë pastaj gjithë gjithë ditët e vitet e veta deri sot, më shumë të vrazhda se të kthjellta; aty ka vdekur, i pari prifti i kthyer nga burgimi dhe vuajtja e tmerrëshme dhe dy tre muaj më pas edhe i ati... Pa arritur në mesomoshën e saj, aty ka bërë pastaj, ngapak e përditë gjërat e zakonëshme të mbijetesës, duke filluar nga gjërat e vogla... Lutja ka qenë e para, e përditëshmja, e përmbremëshmja e përhershmja dhe e përjetëshmja e saj, e ngrirë në gjunjë, me shikimin e sytë lart drejt Hyjit...

Janë disa prej përjetimeve të mia në fëmijërinë e herëshme, kur familja e saj, tashmë e firuar në dy gra, ajo dhe e ëma, përreth një vit kanë bashkëjetuar me ne në shtëpinë e prindërve të mi...

Marija nuk është feniksi që u ngrit nga hiri, jeta e saj ka qenë si jetët e të tjerëve, kushtuar besimit në Zotin pa asnjë thyerje edhe në kohën e AntiZotit, e gatëshme për t'u flijuar e martirizuar, ashtu si axha i saj dhe si shumë e shumë prelatë të tjerë përpara tij. Ka pagëzuar fëmijë e ka bërë të gjitha sakramentet që i lejonte petku (rroba) i murgeshës (tashmë i përshtatur) e kujdesëshme por e pafriguar, e dhënë e gjitha Zotit. Ajo ka bashkëjetuar mrekullisht edhe me të ndryshmit, ua ka bërë të gjithëve pa dallim, kush i ka dëshiruar ritet sakramentare të fesë, aq të frikëshme për kohën, me një devocion të madh. Rrëfimi i të vërtetave të saj e ka mallëngjyer deri sa e ka përlotur vetë Papa Françeskun, në mbrëmësoren me rregulltarët e rregulltarët e Kishës shqiptare në Katedralen e Tiranës... dhe ky çasti i saj fatlum e ka shpërfaqur shpirtin e madh të murgeshës së vogël në vemendjen e shpërndarë të botës.

Në librin e tij "Viandanti" [Shtegtarë] italiani nga Ferrara, Domenico Bedin shkruan për Marijen: *"Ha ormai 80 anni, piccolina e asciuta come madre Teresa, ma lei é dritta come un fuso ed il suo sguardo é insieme assorto e volitivo. Lavoró tutta la vita in campagna nelle cooperative; ogni tanto, clandestinamente, si trovava con Adelaide e altre amiche da un prete, per celebrare la Santa Messa e confessarsi. Nel suo villaggio e nei paesi intorno tutto sapevano di questa donna segretamente suora, ma nessuno la denunció. Maria divenne il punto di riferimento di ciascun cristiano che di notte o di*



*giorno, con la scusa di scambiare qualche uovo o delle verdura, si recava a casa sua per pregare, ricevere un benedizione, dire il rosario o addirittura far batezzare un figlio.* <sup>43</sup>

(Është tashmë 80 vjeçe, trupvogël dhe e dobët si nënë Tereza, por ajo është e drejtë si një bastun dhe shikimi i saj është i përhumbur në mendime (i përhumbur) e në të njëjtën kohë i vendosur. Punoi gjatë gjithë jetës në fshat nëpër kooperativa; herë pas here, në mënyre klandestine, takoheshin me Adelaiden dhe me shoqe të tjera tek një prift, për të celebruar Meshën e Shenjtë dhe për t’u rrëfyer. Në fshatin e saj dhe në vendet përreth, të gjithë e dinin që kjo grua ishte fshehtas një murgeshë, por askush nuk e denoncoi. Maria u bë pikë referimi për çdo të krishterë që natën apo ditën, me pretekstin se donte të shkëmbente ndonjë vezë apo perime, shkonte në shtëpinë e saj për të marrë një bekim, për të thënë rruzaren apo madje edhe për të pagëzuar një fëmijë.)

...Dom Ernest Troshani, 86 vjeç, dëshmia tjetër përpara Atit të Shenjtë me 21 shtator është i vetmi martir i gjallë i besimit. Të tjerët u martirizuan heret, ai kujton të parët mësuesit e tij, At Donat Kurti, At Agustin Ashiku, At Davidi,... kanë qenë shumë Anton Harapi, Çiprian Nika, Benardin Palaj... Elita kulturore e kombit.

Kalvari i mundimeve të dom Ernestit ngjan i zakonshëm, në sfondin e të cilit janë iamzhet e 38 martirëve të fesë. I jashtëzakonshëm është rrëfimi i tij përpara Atit të Shejtë, e paimagjinueshme përlotja e Atit të Shejtë për

---

43 *Domenico Bedin, "Viandandi"- Enti Botues "Gjergj Fishta, 2009, fq 32*

sakrilegjin vetmohues të klerikut të persekutuar kaq egër vetëm për shkak të besimit të vet të konservuar.

Shfaqjen në Bulevardin e Tiranës “Dëshmorët e Kombit” të 38 prej martirëve që Kisha katolike i ka futur në procedurën e kanonizimit kishtar, nga 93 që është lista e deritashme e solli vizita e Atit të Shejtë. Pakkush më heret është kujtuar për ta në vitet e lirisë, përveç kishës katolike. Por ata, në ndërkohë janë pjesë cruciale (vendimtare) e historisë së Shqipërisë së shekullit të njëzetë. Janë rezistenca e parë refuzuese e rregjimit dikatorial, duke shërbyer atë me flijimin e tyre, të vetëdijsëm për çka po bënin. Dhe kjo rrallë është përmendur a shënuar... Prijësat tanë, madje janë ndjerë disi të bezdisur, prej përmendjes së tyre ndërsa nuk ka kaluar muaj e stinë pa e kujtuar xhelatin e martirëve, diktatorin, xhelatin e të gjithë shqiptarëve. Për interes të sundimtarisë së tyre, mashtrojnë nostalgjikët dhe i disenjojnë si sfondin e purpurt të festimeve të tyre. Thurin e trillojnë kujtime për të e për bëmat e tij, bile tani po kërkohet rivendikimi i vendit të tij në histori. Idhtarë të tij po edhe historianë (!) ngulmojnë të na e shfaqin si çlirimtari ynë; e veja diktatore, e “qortuar” për shpenzime kafesh pas përmbysjes së rregjimit të tij shkrehet në mall e nostalgji për të në audiencen qendrore të medias publike të Tiranës. Kurse për martirët, viktimat e paranojës së tij... Falemnderit Papa Françesku që me vizitën tënde na i solle në kujtesën tonë të dëmtuar kombëtare. Tani më së fundi është detyra jonë që historia e tyre të trupëzohet në historinë e kombit. Mjaft më me sjellje e spërdredhje të historisë së diktatorit. Është trishtues evokimi i tij...

Frano Kulli

“Askush nuk më tha mua, më fal për rininë e humbur dhe torturat e 18 viteve burg, po unë i kam falë të gjithë, Zoti i bekoftë. I pastë falë i madhi Zot - ripërsëriti atë ditë dom Errnesti. Kjo është thirrja hyjnore për refuzimin e diktatorit, kur nevoja jonë për t’u çliruar prej tij është ende e paplotësuar.

*Panorama, 28 shtator 2014*

## Mesha e parë në Shkoder... si fund dhe fillim

Të përdorësh sot togfjalëshin “Mesha e parë”, më së paku tingëllon si patetike dhe ngjan diç me ulët se e zakonëshme. Përderisa, ashtu si gjithëkund tjetër në botën e qytetruar, nga gjindja që e përbëjnë një popull ka ndër to besimtarë dhe jo, tani edhe këtu ndër ne, ata që besojnë dhe ata që duan ta praktikojnë besimin e tyre kanë tri mundësi, për t’i kryer ritet dhe për të ushtruar besimin bile saktësisht katër megjith bektashinjte, qendra botërore e të cilëve është këtu në Shqipëri. Por nëse flasim për njëzetepesë vjet më parë dhe pikërisht për 4 nëntorin e vitit të shënuar 1990, kur në Kapelën e rrënuar të Varrezave të Rrmajit në Shkodër, do të kremtohej mesha e parë pas ndërprerjes së dhunëshme të këtij rituali të përshpirtshëm, ndërprerje, që ka zgjatur edhe ajo gati një çerek shekulli, do të duhet të bëhet një kapërcim i fortë në kujtesë për ata që e kanë patur në atë kohë moshën e të kuptuarit. Ndërsa brezit tjetër më pas, i duhet të përdorë mjetet e tjera të rikrijimit ideo emocional të atij momenti, nëpërmjet rrëfimit ose fantazisë, kryesisht...

Mesha e parë është në ndërkohë edhe përmbysja e parë. Është zanafilla e përmbysjes së një rregjimi dhe hapja e perdes për t'u shfaqur pamja e lirisë, e së drejtës për tu shfaqur lirisht Zoti në sytë e shpirtit të njeriut, birit të tij. Qenja e njeriut shqiptar si njeri i Zotit kishte mbetë pezull për gati një çerek shekulli, për plot njëzet e tre vite, mbasi "Zoti" i rrejtshëm me fytyrën dhe qenien prej njeriu të egër - diktator ua kish hequr me ligjin e vet të drejtën e shejtë për t'u lutur e për të komunikuar, i biri me të Atin...Shërbestarët e ritit të besimit - klerikët e të tri besimeve iu nënshtruan kalvarit të mundimeve si të Golgotës... Veçmas katolikët.

" Viktimat e para që u pushkatuan në vitin 1945 ishin: poeti i ëmbëlsisë, **Dom Ndre Zadeja**, stilisti dhe përkthyesi i Schillerit dhe Goetës, **Dom Lazer Shantoja**, hartuesi i fjalorit shqip, **Dom Nikollë Gazulli** dhe dhjetëra intelektualë katolikë dhe myslimanë nga Shkodra", shkruan *Delegati Apostolik, Leone Nigris*, të cilin diktatori e shpalli "persona non grata".<sup>44</sup>

**Imzot Frano Gjini**, ipeshkëv, me një letër që i drejtonte Enver Hoxhës, në cilësinë e Delegatit Apostolik, pas dëbimit të Leone Nigris, ndër të tjera i shkruan se "Duem me nderun besnikë deri në dekë të fesë, sikurse besnikë duem me i nderun deri në dekë Atdheut tonë të dashtun". Kjo letër nuk mori përgjigje kurrë, madje u cilësua si akuzë ndaj sistemit. Në fund të vitit 1946, Imzot Gjini, arrestohet

---

44 MARKUS W.E. PETERS, *Përballjet e Historisë së Kishës Katolike në Shqipëri, Qendra Botuese Shoqata Jezuite, Tiranë, botues, Enti Botues Gjergj Fishta, Lezhë, 2010, f. 163.*

## Kohë e përlyeme

dhe torturohet, akuzohet si spiun i Vatikanit e i anglezëve dhe organizatori i Kryengritjes së Postribës. Pushkatohet në zall të Kirit [afër Varrezave të Rrmajit] **në Shkoder**, në vitin 1948.<sup>45</sup> Pas ekzekutimit edhe të Atë Anton Harapit, si anëtar i Regjencës, në shkurt të vitit 1946, dëbohen të gjithë klerikët dhe anëtarë të tjerë të urdhrave që nuk ishin nënshtruar shqiptarë, rreth 80 klerikë misionarë.

Me 2 mars 1946, shpallet dënimi me vdekje për **etërit jezuitë: Atë Giovanni Fausti, Atë Daniel Dajani, për françeskanin Gjon Shllakut dhe seminaristin Mark Çuni.**



*Kisha e Madhe*

---

45 Po aty, fq.164

-Fjala e fundit, para pushkatimit - hakërrohej xhelati...

**Dajani:** "I fali ata që më kanë ba keq. Jam kondend [i qetë, i kënaqur] se po vdes i pa faj, ma mirë se fajtuer" ...

**Fausti:** "Jam kondend se vdekja po me vjen tue krye detyrën teme. Çoni shëndet, [përshëndetni] jezuitve, xhakojve, apostolikëve dhe arqipeshkvoit. Rrnoftë Krishit Mbret!"

**Shllaku:** "Lamtumirë m'i thoni shokëve françeskan dhe të gjithë të njohunve. Rrnoftë Krishtit Mbret! Rrnoftë Shqipnia!" dhe

**Çuni:** "I fali të gjithë ata që më kanë gjykue, dënue dhe ata që do të më gjykojnë. I thoni nanës se i kam Lodovik Rashës 15 napolona borxh dhe t'ia paguej. Rrnoftë Krishti Mbret! Rrnoftë Shqipnia"! <sup>46</sup>

Me 6 mars 1946 u urdhërua mbyllja e "Hylli i Dritës", "Leka" dhe revistave të tjera fetare si: "Zani i ShnaNdout", "Kumbona e së Diellës", "Zgjimi i Djelmnisë", "Bijat e Zojës", u ndaluan librat dhe u mbyllën shkollat, që për regjimin e dhunshëm cilësoheshin si një armë në luftën politike dhe ideologjike. U asgjësuan të gjitha botimet e mundshme dhe u mbyllën të gjitha shkollat katolike si: Françeskane, Jezuite, ajo e murgeshave Stigamtine dhe Servite, në Shkoder dhe në Tiranë. U shkrinë të gjitha shoqatat katolike dhe u konfiskua pasuria e tundshme dhe kjo pasuri, aty e mbas do konsiderohej shtetërore. Preh e përvetësimeve ishin: shkollat, kuvendet, tri shtypshkronjat, ndër to edhe shtypshkronja e Jezuitëve, bibliotekat, muzetë, arkivat etj., të krijuara nga gjysma e

---

46 Dr.Pjetër Pepa, Dosja e Diktaturës, Tiranë 1995, f. 44-46

dytë e shekullit XIX... Padyshim, trashëgimia më elitare e kulturës sonë kombëtare.

Mesha e parë ishte fillimi i fundit të një rregjimi. Ashtu ëndërruam, ashtu kujtuam dhe besuam...

Famullitari i tanishëm i Shkodres, dom Arturi, Artur Jaku, merret me kremtimin e jubileut, të sivjetëm. Me dëshirë e pasion që e shfaq dhe me energjinë që nuk i mungon, që s' mund t' i mungojë një misionari, i cili besimit e shërbesës për të i ka dedikuar jetën, qyshsekur ka pranuar kushtet e përjetëshme para shugurimit meshtar. Sigurisht dëshira ia don që në kremtimet e ngjarjes së shënuar për Kishën, por edhe për Shkodrën e për Shqipërinë të mikpresë, me 4 nëntor 2015, tek varrezat e Rrmajit, aty ku dom **Simon Jubani** pati celebruar meshën 25 vite më parë, bashkë më mjaft të ftuar nga Vatikani; kardinalin Salvatore De Giorgi dhe ipeshkvijtë e Shqipërisë edhe nga prijësat e vendit, autoritete udhëheqëse të vendit. Ftesat i ka dërguar, me dëshirë e me rend e me kohë. Zonjës Ministre të Kulturës, si bashkëorganizuese e kremtimit, qysh në krye të herës. Dom Nikë Ukgjini, që ndan mjaft miqësi me të, ia ka falë zvarritjen e pafalëshme për rindërtimin e murit ballor të rrethimit të Varrezave të Rrmajit. Thjesht për lejimin për ta bërë këtë gjë, se finacimin... e bëjnë disa besimtarë bamirës. Kështu Zonjës Ministre i mbetet vetëm të vijë në kremtimin e ngjarjes së shënuar.

Me "Mercedes" apo "Jaguar" ...?

*Panorama, 3 nëntor 2015*



## Papa Françesku, gjërat e vogla dhe...statusi

Për ardhjen e Papës në Shqipëri tani nuk po flitet. Edhe në ditët e para të lajmit është folur shumë më pak se ç'flitet në raste vizitash, sidomos të formatit të tillë të lartë. Në deklaratimet po edhe në të gjitha komentet, pas kumtit të vetë Atit të Shejtë, të së dielës së 15 qershorit në Shën Pjetër në Romë, më shumë ndjehej dhe ndjehet gara ndërmjet Autoriteteve Civile se kush e ftoi dhe për cilin do të vinte; secili prej tyre, sipas rëndësisë siprore që mendon se ka për këtë vend dhe këtë popull, voli e shpalosi më shumë attribute. I pari kryeministri.

-Papa Françesku i është përgjigjur pozitivisht dhe tanimë zyrtarisht, ftesës sime për të vizituar Shqipërinë së shpejti - deklaroi në të njëjtën ditë ai. Edhe Presidenti i Republikës që e risolli në një audiencë diplomatike këto ditë ngjarjen e pritëshme, ripërsëriti me këtë rast mrekullinë shqiptare të bashkëjetesës vëllazërore midis besimeve... dhe kaq. Nuk ka "trompeta", siç jemi mësuar t'i shohim e dëgjojmë edhe për gjëra shumë më të vogla e shumë më të parëndësishme se kjo vizitë, e cila pa mëdyshje është më e rëndësishmja e bërë në këtë vend nga

ndonjë personalitet tjetër botëror, në harkun kohor të 21 vjetëve, pas vizitës së Papës Gjon Pali i II-të, me 25 prill 1993. Po ne jemi të familjarizuar edhe me këtë mish mash alla shqiptar, ku hierarkia e vlerave dhe e gjërave dhe për rrjedhojë edhe dukja, shpërfaqja e tyre është përgjithësisht e rrëmujëshme. Veçanërisht në establishment - in politik e publik të këtij vendi.

Kurse Ipeshkvijtë dhe Autoritetet kishtarë, sigurisht janë duke bërë detyrat e veta, ata më së shumti komunikojnë me grigjen e besimtarëve katolikë, ashtu siç ua do rendi më strikt i misionit të tyre, në rastin e një udhëtimi apostolik që Ati i Shejtë do të bëjë në Kishën tonë dhe më pak po komunikojnë me publikun përtej kësaj grigje. Nuk është njoftuar deri tani ndonjë bashkërendim i detajeve të vizitës i këtyre të fundit me Autoritetet Civile edhe pse, sipas kumtit ftesa për Papa Françeskun është sigluar prej të dy palëve.

*"Dua t'ju kumtoj që, duke pranuar ftesën e Ipeshkvinjëve dhe Autoriteve civile shqiptare, dëshiroj të shkoj në Tiranë me datë 21 shtator 2014. Me këtë udhëtim të shkurtër dëshiroj të përforcoj në besim Kishën në Shqipëri e të dëshmoj inkurajimin dhe dashurinë time ndaj një vendi që ka vuajtur gjatë pasojat e një ideologjie të së kaluarës."*<sup>47</sup> - ka deklaruar Papa. Dhe kështu, nuk mbetet asnjë mëdyshje as për qëllimin e kësaj vizite, e katërta vizitë e Tij jashtë Vatikanit dhe e para në Europë, gjithashtu. Megjithatë, përjetimi sa më realist i kësaj ngjarje të përndritëshme është gjëja e duhur dhe më e mira që mund të bëhet. Është shumë më e dobishme seç

---

47 *Papa Françesku, Selija e Shenjtë, Vatikan me 15.05.2014*

mund të ishin komentet e pafund dhe të pa thelb rreth kumtit, madje dëshira e shpërfaqur rëndom në Shqipëri për ta veshur edhe këtë ngjarje, si shumëçka tjetër këtu, me pak mister. Mesazhi i Françeskut Papë është fare i zgaqur dhe nuk lë aspak vend për të bërë diçka të tillë. Ai vjen për “të përforcuar në besim Kishën në Shqipëri” dhe për të “dëshmuar inkurajimin dhe dashurinë e tij ndaj një vendi që ka vuajtur gjatë.” Ja cilat janë dy motivet kryesore pse Ai vjen në Shqipëri. Në Shqipërinë, së cilës padyshim edhe Ati i Shejtë i njeh dhe ia çmon shumë, si një vlerë të spikatur qytetrimi, bashkëjetesën ndërmjet tri besimeve që shqiptarët mbajnë.

Ai vjen për ata, besimi i të cilëve ka nevojë ende për ripërtëritje, të cilët janë të zhgënjyer me ritmet e ecjes dhe në nevojë për të ringjallur shpresën, të dëmtuar edhe prej pasojave të ideologjisë së shkuar komuniste, po edhe prej reminishencave të saj po e po. Korrupsioni dhe sëmundje të tjera sociale e morale të këtij tipi, që e gërryejnë përditë shoqërinë tonë të trandur nga diktatura, ashpërsia që e ka dominuar butësinë, krimi dhe mungesa e tolerancës, humanizmi i tkurrur e mungesa e skrupujve, prirja që vesi të zëvendësojë virtytin e deri tek shfaqja si parësore e deformacioneve njerëzore, e grijnë përditë besimin tonë dhe shpresën tonë, e cila është në nevojë të thellë për ringjallje... Dhe Ati i Shejtë ofron dashurinë dhe inkurajimin e tij për ne. Inkurajimin që ne të bëjmë atë që duhet për të shëruar vetvehten, të bëjmë e të ribëjmë vetvehten. Duke bërë, së pari gjëra të vogla, por të vërteta. Me sa më pak bujë, pa propagandë, por me gjëra të prekshme e të ndjera. Me më shumë dashuri. Sepse ...

## Kohë e përlyeme

*"Ne s'mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri te madhe", thotë E lumja Nënë Tereza...*

Ne flasim shumë, gjithnjë për gjëra të mëdha dhe me zor bëjmë pak, fare pak gjëra të vogla. E keni vënë re, sa flitet për Statusin e vendit kandidat të akorduar këto ditë nga Europa, sidomos nga politikanët e shtetarët tanë, sikur Statusi të qe Mesia shpëtimtare... dhe jo si një rrugë drejt së mirës, nëpër të cilën kalohet me punë e detyrime të ndërsjellta. Të të gjithëve, por së pari të prijësve tanë. Ata përmendin suksesin, përmbushjen e një objektivi madhor, siç është në të vërtetë Statusi duke mos përmendur asnjëherë se kjo portë e rëndësishme për në Europën, së cilës i përkasim është hapur kaq kaq vonë për ne vetëm për shkakun e përgjegjësitë e atyre.

*Panorama, 11 korrik 2014*

## Për dekorimet si punë... sekretarësh

At **Konrad Gjolaj** dhe At **Leon Kabashi** kanë qenë, njëri mbi të shtatëdhjetat dhe tjeri akoma edhe më i moshuar, kur kanë rihapur kishën e fretërve në Lezhë në vitin 1991. I pari i lauruar në Romë për filozofi e teologji e tjetri, përposë se frat edhe piktor, laruruar në Siena më parë për teologji e përsëdyti në Universitetin e Arteve të Bukura atje. Pader Konradi, që qe caktuar edhe si dekan i asaj kishe në ditët e para të ringjalljes, banonte tek një i afërm i tij, Luigji që e kishte shtëpinë jo larg kishës, te stacioni i trenit...

Portreti "laraman" i fratit, veshur herë me zhgunin e gjatë e here me peliçen dhe kasketen si ato të burgut, bënte sigurisht më shumë se kureshti për ne, miqtë e tij. Ishte mospërshtatja e tij ende me ambjentin e ri jashtë në liri, ndoshta. Por më së shumti ishte ëndja jonë për të folur e shkëmbyer me të biseda letrare, filozofike e tema gjithnurësh. Tashma ai ishte "rishuguruar" meshtar, kthyer nga burgimi i gjatë kund nja një vit më parë, ashtu si krejt vërsnikët e tij, e pakta prej të cilëve kishte mbetur ende gjallë prej lëngimit në ferrin e diktaturës.

Pader Konradi kish qenë fillimisht nxënës i Dom Alfons Trackit, që shërbente në fshatin e tij, në Velipojë, priftit gjerman të ditur, misionar e martir, pastaj më vonë nxënës e bashkëmësues me Fishten në Liceun françeskan "Ilyricum" në Shkoder...

Në një mbrëmje vjeshte të atij viti, duke ecur nëpër rrugët gjysmë të terratisura të Lezhës me pader Konradin dhe me dy miqtë tonë të përbashkët, Francin (Radoja) e Toninin, (Çobani) kemi përjetuar një ngjarje të beftë, të cilën e kujtojmë jo rallë. Në një moment të asaj xhiros sonë të ngadaltë, padrja ndaloi përpara një kioske me dërrasa, në cep të urës, në të dalë të qytetit. Befasi për ne nuk qe vetëm ndalesa e fratit të moshuar, po më tepër vendndalesa e tij... Shitësi i asaj kioske ishte një ish oficer i policisë në vitet '60 (kur ai ishte arrestuar për herë të dytë). Mbasi ai u kthye tek ne, pas asaj bisede pak minutëshe me "shitësin" e kioskës, mësuam se oficeri, të cilin ne e njihnim, si bashkëqytetas, ishte vetë ai, që rreth tridhjetë vjet më parë i kishte vënë prangat në duar fratit.

-E përshendeta dhe i kujtova se ai nuk ka kënë sjellë keq me mua atëherë -vazhdonte të na tregonte padrja. - Kur erdhën me më marrë me "gazin e degës"<sup>48</sup> këtu në oborrin e kuvendit, përpara se me më vue prangat, më tha: shko mbrendë e merr ndoj teshë se do të duhen... E masandej më vuni prangat. Nuk m'i shtërngoi fort e kur më hypën në gaz m'i hoqi.

---

48 *Autovetura ruse "Gaz 69", përdorur nga organet e punëve të brendëshme, kryesisht për arrestimet*

Për kaq frati i moshuar, i cili në burgimin e gjatë ishte argasë me tortura prej atyne që ...” me ja kallxue natës së vorrit” ruante sado pak respekt për prangosësin e tij... Kurse nga fronti i prangosësve, prej asnjërit nuk ka asnjë “meaculpa” asnjë vrasje ndërgjegje të shfaqur, asnjë fjalë pendese. As atëherë, as më vonë e as tani. Përkundrazi...

Padër Konradi, ka vite që është ndarë nga kjo botë; është nisur për në amshim e këndeje nuk ka asnjë dekoratë e nderim tjetër zyrtar. Jo si klerik, por as si mësues e as si autor librash. Dhe jo vetëm ai po asnjëri prej bashkëvëllezërve të tij, gjithashtu (përveç At Zef Pllumit - ish nxënës i tij). As prej atyre tridhjetetete martirëve, që u shfaqen në bulevardin “dëshmorët e Kombit” në ditën e vizitës së Papa Françeskut në Tiranë, nuk ka ndonjë distingtiv nderues për asnjërin në emër të shtetit shqiptar. Sa për martirizimin aq edhe për kontributin sipror që i dhanë kulturës dhe qytetrit tonë. Jo, kjo nuk ka ndodhur deri tani; madje ndjehet disi bezdi edhe me i përmendë. Ndërsa për ndonjërin prej tyre, për Anton Harapin, hidhen anatema, njëlloj si në të shkuarën e rregjimit; kuisling, bashkëpunëtor, tradhëtar...! Kurse, sistematikisht, herë pas here ndër përvjetorë... dekorohen e nderohen persekutorët, xhelatët e tyre. Për njëmijë syresh janë janë shpërndarë medalje kinse si veteran lufte... Dhënë në mënyrë tinzare një vit më parë. E kur nis e buçet zëri qytetës për këtë maskradë, si shpëtimtarë në frontin shtetror të dekoratorëve del e bën apologjinë e medaljeve të dhëna prej shtetit, një sekretar (këshillonjës si kukull) i të parit të qeverisë...

*Panorama, 11 dhjetor 2015*

## Harmonia fetare dhe lapsat e Kryeministrit si një gjest

Harmonia fetare dhe lapsat e kryeministrit, kanë qenë gjërat për të cilat është folur më shumë se për gjithçka tjetër, këtu ndër ne, rreth aktit terrorist të ndodhur jo shumë ditë më parë në gazetën satirike pariziene “Charli Hebdo”<sup>49</sup>. Ligjërimi publik këtu, sigurisht nuk ka përjashtuar komentet e gjithfarëshme rreth aktit tronditës, duke u zgjatur me të drejtë deri thellë në debatin e rëndësishëm rreth pikpëpyetjeve të mëdha se a po e kërcënojnë realisht Europën e botën akte të tilla? A janë ato produkt i përplasjes së trandëshme të qyteterimeve, a janë produkt i indokrinimit ekstremist të besimit islam nga njëra anë dhe nga një anë tjetër, i grricjes deri në kufijtë e fyerjes së padurueshme nga një medium, në këtë rast gazeta pariziene, apo, apo...

Paraqitja e dërgatës shqiptare në manifestimin e paqes atje tërhoqi vemendjen jo vetëm të pjesëmarrësve të panumërt në sheshin e manifestimit paqësor në Paris, po

---

49 *Sulmi terrorist në redaksinë e gazetës ndodhi me 7 janar 2015, ku mbetën të vrarë 12 persona, ndër to edhe drejtori Stephan Charbonnier*



edhe të mediave rrotull globit. "Lakmuesit" e solucionit të prodhuar treguan dy përfitime, i pari dhe më rëndësishmi ecja parakaluese në sheshin Volter të 4 klerikëve shqiptarë të tre besimeve që ushtrohen ndër shqiptarë; mysliman, ortodoks, katolik dhe sekti i bektashijve, i cili ka edhe qendrën e vet botërore në Shqipëri. Imzot Luçian Avgustini, njëri prej të katërtve klerikë pjesëmarrës ma ka treguar si një rastësi, momentin me duart shtërnguar.

- Ne po ecnim së bashku për tek "Charli..." ku do të bëheshin manifestimet e paqes, por sapo u ballafaquam me publikun anash pamë reagimin e veçantë të tyre shoqëruar edhe me fjalë përgëzuese. Më pas vetvetishëm, gati instinktivisht, ne përbashkuam duart - tregon Imzot Luçiani.

Harmonia jonë fetare është e kaherëshme edhe më përpara se krijimi i shtetit shqiptar. Dhe kjo harmoni ka arsye e argumente historike; unë besoj se bashkëjetesa në harmoni ka qenë gjithnjë e njëmendtë dhe asnjëherë e stisur. Sigurisht arsyet janë të shumta dhe specifike. Atë e ka ushqyer në radhë të parë "instinkti" i mbijetesës së njeriut shqiptar dhe në shkallën e vet më të lartë i mosshprishjes së kombit dhe mbrojtjes së identitetit të tij, në mungesën e lirisë dhe të mëvetësisë kombëtare. Dhe gjeste që e manifestojnë ka plot në të shkuarën tonë dhe janë udhëhequr kurdoherë nga njerëz të iluminuar dhe atdhetarë...

Ka ndodhë në përvjetorin e parë të pavarësisë, me 28 nëntor 1913. "*...Njëzetmijë vetë, pra gati gjithë banorët e qytetit morën pjesë në kremtim... në këtë natë, simbolikisht një*

*varg me drita kandilash si varg hyjsh lidhshin minaren e xhamisë së Fushë Çelës me kumbonaren e Kishës së Gjuhadolit.*"<sup>50</sup>

Natyrisht gjesti ishte spontan në njëfarë mënyre, shteti i brishtë shqiptar ishte thuajse formal dhe një qytet i tërë mund të dhunohet po nuk mund të trukohet prej askujt. Aq më tepër të realizosh një gjest të përbashkët të të ndryshmëve, siç është rasti i të ndryshmëve në besim.

Një tjetër gjest rreth tetëdhjetë vjet më vonë, në të njëjtin qytet. Në vjeshtën e vitit 1990, në Varrezat katolike të Rr' majit thuhet mesha e parë pas ndalimit të dhunshëm shtetror të besimit ku marrin pjesë, pa dallim edhe myslimanë e ortodoksë. Dhe shembuj të shumtë të ofron historia jonë dhe jo vetëm në qytete "etalon" si Shkodra por edhe në fshatra të thella, dëshmuar shpesh edhe prej të huajve..." *Ka sa e sa famulli në të cilat vijnë në meshë edhe myslimanët...*"<sup>51</sup> - vjen një tjetër dëshmi shumë e herëshme. Përftimi i dytë, ishin tri lapsa në thilen e xhakëtës së kryeministrit, një paraqitje shich e tij, si simbolikë e lirisë së shtypit dhe që për nga ngjyrat përkonin me flamurin francez. Edhe simbolika e lapsave të kryeministrit si shenjë respekti për lirinë e shkrimit dhe të shprehjes është e bukur, e gjetur e plot sharm, në kontekstin e ngjarjes dhe në vendin ku u shpërfaq. Kjo simbolikë, elementi i dytë i parakalimit solidarizues paqësor, pas klerikëve që gjithësesi ishte i pari, bëri të përmendej për një çast Shqipëria në audiencat e mëdha të botës. Po vetëm për

---

50 *Pal Duka-Gjini [At Danjel Gjeçaj] "Gjergj Fishta - jeta dhe veprat", fq. 92.*

51 *At Lovro Mihaçević: Nëpër Shqipëri 1893-1907-mbresa udhëtimit, Botimet Fishta, fq. 110.*

një çast që ka zgjatur pak. Se pastaj... Pastaj, si gjithnjë ndër këta 24 vjet, së paku, për të vënë paqen politike në Shqipëri kanë ardhur me dhjetëra dërgata nga Europa në Shqipëri... Lapsat e kryeministrave tanë s'kanë bërë më punë dhe kjo është e pakundërshtueshme. Se po të ishin punuar e të punohen me laps të mprehtë politikat ekonomike, patjetër që ne të qeverisurit e kryeministrave tanë nuk do të ishim më të papasurit e Europës, se po të ishin hartuar "me laps" ligjet e këtij vendi e po me laps në dorë të ishte ndjekur e llogaritur çdo hap i zbatimit të tyre, në radhë të parë prej vetë atyre (!) me siguri, tjetër do të ishte standarti demokratik i shtetit ligjor, i lirisë së medias dhe i shoqërisë shqiptare, në përgjithësi. Kur mprehet lapsi i përgjegjësive detyruese që kanë prijësit e një vendi demokratik, nuk mund të ndodhë kurrë që, teksa shugurohen fabrika droge, me lidhje të dyshuara me kastat politike, një rrezikzi vret vehten në burg për tridhjetë a katërdhjetë mijë lekë të vjetra energji elektrike të papaguar se nuk ka pasë mundësi të paguajë dhe duke i rilidhur ato ka rënë në shkelje të ligjit. Lapsat e kryeministrit, do të duheshin, të bënin, në radhë të parë punët më "me laps" këtu në Shqipëri. Sepse kryeministri është "kalemxhiu" i Shqipërisë, i financave publike dhe i mirëqenies sonë, i interesave tona të përbashkëta dhe i prosperitetit të mirëqenies sonë.

Kryeministri ynë në Parisin e "Charli Hebdo"- së ka bërë një gjest, po një gjest, sado domethënës e kuptimplotë të jetë nuk është më shumë se një gjest.

*Panorama, 23 janar 2015*

## Lulet dhe... inflacioni i fjalës luftë

Në Shqipëri ka shumë lule, tani ato shkëmbehen e dhurohen, si një simbolikë e shpeshtë rrespekti e dashurie, ndër njerëzit mbarë, në shoqëritë e të gjitha moshave; tani lulet rriten e kultivohen, jo vetëm në kopshtije por edhe në sera, madje në llojshmërinë e pakuptimtë të njëjësive tregtare në këtë vend, shitblerja e luleve, denduria e njëjësive të tyre është gjëja më për të qenë në Shqipërinë e tregtisë kaotike.

Ky imazh të vjen pas një vëzhgimi aspak të mundimshëm madje edhe krejt rastësor, sidomos në këta dhjetë a pak më shumë vitet e fundit. Ndërsa është e njohur se më përpara nuk ka qenë kështu. Nuk ka qenë më parë mardhënia jonë me lulet, ashtu siç është në Europë. Apo jo?! Tek ne janë shkëmbyer lule si dhuratë me 8 mars, në ditën ndërkombëtare të gruas, kur simbolika e kësaj date e kësaj dite atje ka qenë tjetër gjë; ka qenë ditë kur në vendet me qytetërim të përparuar gratë demonstironin në këtë datë simbolike për të drejtat e tyre të kufizuara e të munguara... Tek ne i janë tundur, në reshta parakalues, tufa me lule udhëheqësit (mostrës së dhunës) në ditën e punëtorëve me 1 maj (çfarë shpifurine estetike e morale, o Zot)... Sigurisht

është në mes gjysmë shekulli i “njeriut të ri”, krijuar në kohën e dhunës (si Dashuri në kohën e kolerës)... Pakditë më parë, në Italinë fqinje përkujtohej jo më shumë se 70 vjetori i ngjarjes kulmore në jetën e grave, kur ato kishin fituar të drejtën e shenjtë të lirisë, të drejtën për të votuar, të drejtën për të zgjedhur e për t’u zgjedhur. Porse lulet kanë qenë dhe janë simbolikë dhe dashuri e lashtë. Kurse tek ne... siç do të kumtonte Konica, shqiptari i madh dhe qortuesi ynë i madh, gjithashtu... “Në Shqipëri lulet i hanë gomerët...”. Edhe pse, bie fjala në Shkoder, vetëm gjatë shekullit të njëzetë janë krijuar rreth 300 këngë qytetare, me emra lulesh e dedikuar luleve... Po prap, duke iu referuar Konicës së madh... “Shkodra është pothuaj vendi më interesant i Shqipërisë së sotme, argjendarët dhe punëtorët e tjerë të saj janë të famshëm në gjithë Europën e Jugës dhe të Lindjes...<sup>52</sup>

Edhe pse sot, lulet janë e përditshmja edhe e qytetarisë sonë, prap se prap vëren një kontrast të hatashëm, nëse këtij trendi të ri (kësaj prirjeje të re) i vë përballë përdorimin inflacionist, të pandalshëm e të pavend të fjalës antonime - **luftë**. Lufta për jetën, luftë politike, luftë për mbijetesë, luftë klanesh,... edhe lufta e nuseve, tani më së fundi, përdorë si titull i një emisioni me shikushmëri të lartë në njërin prej televizioneve tona kombëtare...?!

Deri këtu shkon paradoksi.

Si mund të rrinë pranë njëra - tjetrës këto dy fjalë përjashtimisht të përputhëshme?!

Po, unë mendoj se këtu nuk është vetëm një problem i të menduarit tonë kolektiv të cektë; më shumë se kaq

---

52 F.Konica: “Kopshti Shkëmbor i Evropës Juglindore”, 83

është psikologjia e luftës, që nuk po na shqitet edhe tani, në fillim shekullin e 21-të kur, pas një periudhe të gjatë historike gjendemi më pranë paqes se kurrë, të lirë, të pavarur, anëtar të NATO-s, paktit më mbrojtës të lirisë e të paqes. Më shumë se kaq, janë reminishencat e së kaluarës sonë të skllavërueshme për një kohë të gjatë, ku mendësitë dominante kanë qenë, ato luftaraket... *“Puna është më e lartë se trimëria, kazma më fisnike se palla”*<sup>53</sup> do të theksonte, që më 1922-shin, prap Konica i madh... Dhe padyshim, kumti i Konicës është qortimi dhe thirrja që i bën popullit të vet, një oksidental elitar i klasit të lartë... Më shumë, shumë më shumë se përpara frikës së luftës ne sot gjendemi përpara detyrës për të bërë më mirë gjërat e paqes. Sigurisht nuk është fjala për paqen e përbotëshme, ku kontributi ynë është e do të jetë më se modest. Po për paqen tonë, paqen e shpirtit tonë këtu ndërmjet nesh. Përkundraill shfaqjeve dhe psikozezës së dhunës, e cila ndot çdo ditë mjedisin tonë publik. Dhunë e frikë që shfaqet në fytyrën e taksidarit, zyrtarit, policit, ndërtimorit, faturistit,... në zhargonin parlamentar dhe në fjalimin e udhëheqësit... Kronika të dhunëshme mediatike dhe një garë e çuditshme vrapimi drejt tyre.

Paqja vjen, duke bërë secili gjënë e vet të vogël, të përditshmen e vet; burri të veten, gruaja të veten, nxënësi e studenti të veten, gazetari e politikani të veten... Me dashuri dhe me përgjegjësi. Se ne... *“Ne s’mund të bëjmë dot gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe”*, është kumti lapidar i të Lumes Nënë Terezës.

*Panorama, 12 mars 2016*

## Paç dritë, Imzot Luçjani!

*In memoriam për Imzot Luçjan Avgustinin*

Një libër të vogël me titullin “Dieçezi i Sapës, (1291-1941)”, që për autor ka njërin prej prelatëve të Kishës, të dioçezës së Sapës, dom Gasper Gurakuqin, unë e kam të dhuruar prej dorës së tij, Imzot Luçjanit, pak më shumë se 3 muaj më parë. Pata shkuar në Selinë e tij Ipeshkvnore të Sapës, në Vau i Dejës, me kërkesën për ta ribotuar atë libër. Folëm për tipologjinë e botimit; do të jetë një botim anastatik, arsyetuar. I bisedova gjithashtu edhe motivin tim, si shtysë për ta ribotuar, librin e vjetër.

- Të parët e mij, siç e dini Monsinjor - i thashë - kanë jetuar dhe e kanë ushtruar besimin e vet prej shekujsh në këtë dioçezë, në Zadrinë. Edhe pinjollët e tyre sot, gjithashtu. Po, për më shumë se kaq, mendoj se historia e përmbledhur në këtë libër mund e duhet të transmetohet përtej kohës kur është shkruar... Qemë të së njëjtës mendje, se jo si një copë histori e kishës katolike shqiptare vetëm, po shumë më shumë se kaq, kjo është histori e etnosit dhe kulturës sonë të Zadrinës, në të cilën shtrihet Dioçeza e Sapës, ku feja dhe Shqipëria janë ndjerë e çmuar gjithherë të pandara prej njëra tjetrës nën devizën françeskane: “Fe

e Atme (atdhe)". Aty ku kanë gëluar mërmërimat e para nga fillesat deri tek "ngjitja" në Panteonin e vlerave të kombit, Frang Bardhi, Pjetër Zarishi e Gjergj Fishta, nga Zadrima, At Pal Dodaj e At Shtjefen Gjeçovi nga Janjeva (Kosovë)...

Imzot Luçjani e priti me lumturi lajmin, me një kënaqësi që nuk i shqitej nga sytë dhe gjithë qenja e tij e qeshur, e cila është e shënuar si mirësi, në kujtimet e gjithsecilit që e ka njohur a rasti e ka sjellë ta takojë, qoftë edhe njëherë. Dhe me tonin e tij të ëmbël, ku shqitej mirësi e pamatë, shqiptoi: "Unë e bekoj dhe e uroj megjith zemër, këtu punë të bukur!" ...

U ngritëm dhe vizituam muzeun e dioçezës, historia e së cilës daton 950 vjet më parë, krijuar me mund me objektet e pakta të mbetura prej kohës së gjatë dhe në fund, në përcjellje, dom Simoni (Kulli) - vikari i dioçezës, ndihmësi i tij më solli si dhuratë kryqin e matirëve. Një vepër në teknikën e pirografisë, ku në kornizën e një kryqi, janë gdhendur të përbashkuara, fotot e 38 martirëve, fotografuar e kompozuar prej mjeshtrit Angjelin Nenshati.

Po në zgrihtë të bisedës unë i parashtrova edhe kërkesën time: Parathënien e botimit dua ta bëni ju, monsinjor.

-Po, po patjetër - më tha prerë dhe po aq ëmbël, gjithashtu - me shumë kënaqësi.

Dhe u ndamë kështu atë ditë fundshkurti, të dy të gëzuar e të lumtur, për ç'farë folëm e venduam...Pastaj...

Ky është komunikimi (e-mail) i fundit:

*A Luçjan Avgustini; Mar 21 alle 12:04 PM*

*I dashtun Mons.Luçjani, mirdita. Në vijim të bisedës sonë për botimin e "Dioçezit të Sapës", unë mund t'ju them*



Frano Kulli

*se tashti libri është i skanuar dhe i gatshem për botim Në ndërkohë, pas takimit tonë, unë kam bisedue me dy palet e njerëzve më të afërt e konkretisht me Zef Gurakuqin, kushrini më i afërt nga trangu i Dom Gasprit dhe me Plator Xhanxhafilin më i afërti nip nga linja e nanës dhe të dy më kanë kthye përgjigje jo vetem dakortësie, por edhe shumë falënderuese për mue dhe per Ju, si Ipeshkëv i sotëm i Sapës, për këtë nisem.*

*U zgjata për me të thanë se, pra tashti mbetet vetëm shkrimi Juaj, si Parathenie e botimit ...dhe libri eshte i gatshem per shtyp.*

*Duke ju uruar çdo të mirë, me respekt e besim, ju përshendes. Frano Kulli*

...Sëmundja e rëndë, që iu shfaq, si sprova e dhënë prej Atit, të cilit i qe përkushtuar, bëri që ajo përgjigje të mos vinte kurrë... Ai qe nisur për në rrugën e amshimit dhe ndër punët e mbetura pezull në anën e këndejme të jetës, bashkë me tjerat, të shumta punë mirësie të tij është ... edhe parathënia e pashkruar.

## **KUMTI I DIOÇEZËS SË SAPËS**

*Dioçeza e Sapës sapo ka njoftuar që Ipeshkëvi Mons. Lucjan Avgustini ka ndërruar jetë. Monsinjor Lucjan Avgustini ka lindur në Ferizaj të Kosovës më 23 gusht 1963. Pas Seminarit të vogël të Suboticës dhe atij të madh në Zagreb, më 15 gusht 1989 u shugurua meshtar për dioqezën Shkup-Prizren.*

## Kohë e përlyeme

*Filloi shërbimin në këtë dioqezë si Sekretar i ipeshkvit-ndihmës, Shkëlqesisë së Tij Imzot Nikë Prelës. Që nga viti 1992 kreu njëkohësisht shërbimin e famullitarit të famullisë së Engjëjve të Rojës në Ferizaj dhe atë të përgjegjësit të Karitasit të Kosovës.*

*Në vitin 1994 u transferua si meshtar fidei donum në kryedioqezën metropolitane të Shkodrës (Shqipëri); pas inkardinimit në këtë dioqezë, më 1996 u emërua famullitar i Katedrales, ndërsa në vitin 1998, Vikar i Përgjithshëm, duke dhënë njëkohësisht mësimin e Shkrimit Shenjt pranë Institutit Katekistik Kombëtar. Përveç gjuhës shqipe, fliste edhe kroatishten, gjermanishten e italishten. Sot me datën 22.05.2016 në festën e Trinisë Shenjtë, Ipeshkvi i dioqezes së Sapës Mons. Lucjan Avgustini shkoj në Shtëpinë e Atit Qiellor.*

*Panorama, 24 maj 2016*



IV.

Tymnajë, Show dhe Kohë e çmendur



Tymnaja e Sulltanit të madhërishëm  
në Lezhë.

I gjithë debati i ndezur këto ditë për një pllakë me mbishkrim arab të shekullit të 16 vendosur sipër njerës prej portave të Kalasë së Lezhës, ku pjesëmarrës janë njerëz të prirjeve e formimeve të ndryshme, interpretë të niveleve të dallueshme kulturore, historianë por dhe jo të tillë, kulturologë gjithfarësh e të përkatësive e të religjioneve të ndryshme, e ka pushtuar hapsirën publike. Siç, rëndom ndodh kësi rastesh ndër ne. Ca hahen fort ndërmjet vedit, ca të tjerë ujdisen në mendime, rroftë “sebepi” e secili armohet e parzmohet për të bërë luftën e vet dhe kështu prej disa ditësh “zjarri” nuk fiket. Në midis të zjarrit është hedhur pikpyetja se a duhej vënë saktësisht aty ku është vënë ajo pllakë apo duhej vënë në një tjetër syprinë dere a në ndonjë cep murane të kalasë. Për të përmbushur një nder të harruar të Sulltanit të madhërishëm Sulejman, i cili e paska rindërtuar këtë kala në vitin 1522. E kështu është krijuar një tymnajë si çdo tymnajë që nuk ka thelb por formë, madje edhe formë aspak të hijëshme po më shumë të pshtirëshme. Ngjan se është hedhur një gur n’ujë e njëqind të tjerë, pastaj... bëjnë ta nxjerrin”. Mirëpo,

kësaj here është pak si ndryshe; “gurin” në ujë e ka hedhur e para e këtyre punëve, ministria e Kulturës, zonja Kumbaro. Ceremonialin e vendosjes së pllakës, pllakë e cila, sipas këshillonjësve të saj qenka e rrallë në viset tona e ka udhëhequr vetë zonja ministre dhe unë mendoj se, nëse duhet të debatohet, debati zë fill këtu.

Por për të shmangur keqkuptimin, do çekur në fillim se zonja ministre nuk ka bërë ndonjë mëkat të pashlyeshëm në këtë rast, ëë, fundja është njëra prej punëve të saj udhëheqëse të merret edhe me monumentet e kulturës (qoftë ai monument edhe një pllakë e shkruar në arabisht gati pesë shekuj më parë) dhe gjithë vlerat e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Por a e ka zgjedhur mirë rendin e këtyre punëve në Lezhë, zonja ministre?...

Lezha ka një sit arkeologjik, nevoja për ekspolirimin e të cilit është jo vetëm e papërfunduar, po ai është edhe pak i mbrojtur prej agjentëve dëmtues të gjithësojshëm, në radhë të parë prej atyre urbanë. Lezha ka gjithashtu një begati të dallueshme të trashëgimisë kulturore; përposë Gjergj Kastriotit e vendvarrimit të tij, në rrënojat e Kishës së Shënkollit, pak më poshtë në atë areal, në Zadrimë janë vendlindjet e Frang Bardhit (1606-1643), hartuesit të Fjalorit të parë latinisht – shqip e Pjetër Zarishit (1806-1866), poetit të parë të letërsisë së re shqiptare e asnjë pllakë, së paku si epitaf nuk gjendet në Blinisht, në fshatin e tij të lindjes. Aty fare pranë, në Fishtë është edhe vendlindja e Gjergj Fishtës - poetit kombëtar, shtëpia e fëmijërisë së të cilit po rrënohet dita-ditës; jo larg asaj kalaje, hafiz Ali Ulqinaku (1853-1913), i cili ka qenë myfti i Lezhës aty u mësonte shqip fëmijëve qytetës, atëherë

kur perandoria osmane qe akoma në këmbë dhe kjo gjë ishte akoma blasfemi. Në Kallmet ka qenë ipeshkëv Imzot Luigj Bumçi (1872-1945), që ka prirë delegacionin e rëndësishëm shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, duke mundësuar ndaljen e hemoragjisë së copëtimit të tokave shqiptare prej lakmisë së fqinjëve ( grekë e italianë) siç ishin dy krahina të rëndësishme si Korça e Gjirokastra dhe Vlora...

Dhe mund të vijojë lista e vlerave të trashëgimisë kulturore, siç ka në secilën krahinë të Shqipërisë, ku më shumë e ku më pak, lista të tilla të vlerata. Sigurisht ato janë fundamente të kulturës shpirtërore të shqiptarëve dhe si të tillë, së paku mjaftueshëm janë në memorien tonë historike e kulturore. Por janë më shumë në mënyrë sporadike e rastësore; asnjëherë nuk ka pasë ndonjë strategji të mirëfilltë për mbarështrimin e këtij thesari. Akoma edhe më keq është tani. Asnjë prej këtyre pikave, që secila më vehte mund të ishte një qendër e meritueshme e peligrinazhit kulturor, ku mund të shërbehej njohja me vlerat e kësaj trashëgimie nuk qaset si e tillë. Natyrisht për t' u bërë këto duhet një strategji e mirëstudiuar, duhet vizion e dije, mbi të cilat hartohen politika të posaçme kulturore, po duhen edhe shërbestarë të zellshëm të kulturës. Se ndryshe masandej, merr e bëj ç' të të dalë përpara!

Kësaj here doli një pllakë dhe... fap u vendos në hyrje të kalasë... E gjithë ne të tjerët "bluajmë" si mulliri pa kokrra.



Show me “seksizëm” dhe... shoqja Lenka.

Ca njolla salce përzjerë me revoltë, hedhur mbi veshjet, sigurisht firmato të zonjës Ministre e Arsimit kanë ngjallur debat të madh, i cili ka vijuar përtej atij tri ditëshit që, thuhet se zgjat, për cilëndo çudi që ndodh këtu ndër ne. Nuk ka folur vetë zonja ministre dhe është ndër të paktat punë të mira që ajo ka bërë. Se kanë thënë heret, njerëz të zgjuar që, kur s'ke se çka thua, heshtja është kapak florini. Po heshtjes së saj i kanë ardhur e vijojnë t'i vijjnë në ndihmë skuadrile të shoqërisë civile dhe njerëz me peshë publike, që megjithë përpjekjen e tyre nuk kanë mundur ta zbehin revoltën në rritje për Ministrën, për ministrat dhe për kryeministrin dhe keqqeverisjen e tyre shembullore, më së pari.

Argumentet e apologjetëve janë përmbledhur në një pikë; si mund të silllet kështu me një grua, kanë zgurdulluar sytë disa syresh, profesionistë të mbrojtjeve ministore nëpër ekrane, thua se salca nuk qe salcë po napalm (lëndë djegëse lutarake). Dhe më pas, rrotull “mëkatit” që po bëhej ndaj një gruaje u stisën edhe “show” me “seksizëm”, duke harruar e mënjanuar faktin se është njollosur me salcë - revoltë jo zonja Lindita, po zonja

ministre. Dhe raste të tilla kemi parë të ngjasin rëndom nëpër Europën civile, së paku, qysh në fillimet pas rënies së rregjimit. (Helmuth Kohlin, për shembull, kancelarin gjerman, perkursor i rrëzimit të Murit të Berlinit, kur kishte 17 vjet Kancelar i Gjermanisë kemi parë ta gjuajnë me domate protestuesit)...

Nisur nga përdorimi këto ditë, nuk e di sesa me vend, i termit “seksizëm”, po mendoj edhe unë, si shumë të tjerë, të cilët kanë arsyetuar të vënë theksin e tyre në raportin që zë sot e duhet të zëjë në të ardhmen pjesmarrja sipas gjinisë në jetën publike, të sqaroj se është fjala pikërisht për këtë pjesmarrje ndarë sipas gjinisë dhe jo sipas konotacionit të herëherëshëm që ka vetë fjala seksizëm në shumësinë e fjalëve me rrënjën seks.

Njëherësh shpreh edhe distancimin tim me përdorimin e pavend e të teprishëm të fjalëve që etimologjikisht kanë për bazë rrënjore këtë fjalë. Dhe le të kthehemi te thelbi i asaj që po parashtrojmë.

Këto ditë një zonjë, grua është graduar gjenerale brigade në Forcat e Armatosura të Shqipërisë. E para, thonë, në 104 vitet e shtetit shqiptar. Në krye të Ministrisë së Mbrojtjes kemi, gjithashtu një grua politikane, zonjën Mimi Kodheli. Po t’i referohemi kështu vetëm njërit prej gjymtyrëve të shtetit, pikërisht atij të forcës.

Por, para kësaj, me fillimin e qeverimit rilindas në dy sektorë të tjerë, shumë të rëndësishëm të parave publike (taksave dhe doganave) qenë vendosur dy zonjusha, pa i përmbushur të tridhjetat e moshës së tyre... Mirë, fundja kjo është përzgjedhja e atij që i ka rënë rasti të jetë në krye

të qeverimit tonë dhe bashkë me rrishtun ka edhe tagrin që të bëjë edhe emrime kësajsoji...

Po, më përtej, në ligjin zgjedhor është një raport detyrues për të patur 30 përqind femra të numrit të të zgjedhurve. Madje, nga vetë i pari i shumicës politike aktuale, zoti Edi Rama, aktualisht kryeministër i Shqipërisë, poseduesi i një milion "shuplakave", hipoptekën e të cilave akoma kujton se e ka edhe tani që po mbyll mandatin, ka patur edhe një propozim që kjo shifër të jetë jo 30 po 50. Por edhe të tjerë nga livadhi i politikës, janë dakortësuar me të dhe... nuk është se ka gjetur ndonjë përballje kundërshtuese kjo gjë as nga opozita politike! Pra, nëse nga kjo e thënë shkohet lehtësisht tek e bëra, siç ka ndodhë rëndom me gjërat e rëndësishme sidomos (!), i bie që gjysma e këshillarëve bashkiakë, në të ardhmen të jenë detyrimisht femra. Po dhe gjysma e antarëve të Kuvendit të Shqipërisë të jenë, gjithashtu femra. Pra, gjysma e shtetit, sipas kësaj arithmetike, të kolloniset (administrrohet) nga femra... Një gjysmë e planifikuar si e tillë, pavarësisht cili do të ishte verdikti i zgjedhësve?!...

Kjo gjë ka ndodhur përpjesëshëm në zgjedhjet e shkuara, por rrekja për ta përmbushur këtë ide, është e evidente. Këto ditë, në mediet më të rëndësishme me licensë kombëtare, dukshëm shërbyese të bindura të interesave të politikës, herë në një krah e herë në tjetrin, shumë më shumë se në krah të interesave të publikut, të bën ta besosh se kahja e rritjes së përqindjes është prirja (trendi siç thuhet tani). Po a janë përqindjet e pjesëmarrjes dhe sidomos planifikimi i tyre ato që po e përmirësojnë dhe do ta përmirësojnë edhe më tepër barazinë gjinore? A

respektohen prej së vërteti më fort e më mirë, pikërisht kështu të drejtat dhe liritë e individit, dalluar edhe sipas gjinisë, racës e seksit? Dhe nëse kjo gjë do të ndodhë a do ta bëjë kjo shoqërinë shqiptare më të qytetruar e më demokratike?

Në të vërtetë, i gjithë ky mekanizëm që serviret si modernitet, me fallsitetin që mbart, është vetë demokracia kokëposhtë.

Në demokracinë si sistem politik, mekanizmi rregullues është vetëm vota; çdo devijim prej saj, sado e zbukuruar me lule e me lajle, është gjithçka tjetër veç jo kjo e fundit (demokracia). Aq më tepër, në një vend si ky i yni, ku të gjitha zgjedhjet në të gjitha hallkat e sistemit zgjedhor i bëjnë, kryesisht 2 persona, të dy kampeve përballëse politike dhe për këtë ka një dakortësi të paprekëshme, si mund të ngjasë ndryshe në raportet gjinore politike?! Vetë struktura e parlamentit të sotëm shqiptar, po edhe e të gjitha “parlamenteve” të tjera vendore, janë të pakrahasueshme për nga deformimi demokratik me asnjërin prej vendeve të Europës postkomuniste... Edhe në Bosnje - Hercegovinë, këtu pranë nesh, më se 15 vjet më parë, është votuar me “lista të hapura”, kurse tek ne, në Shqipëri nuk ka gjasë të ndodhë, së paku edhe në palët e zgjedhjeve më të afërta. Argumentet kundërshtuese që ka sjellë vetë Zoti Rama, ndonëse aspak bindëse, në ndërkohë na kanë bërë me dije se asgjë nuk ka ndërmjend të ndryshojë për mirë. Sipas atyre argumenteve, aula e parlamentit edhe në të ardhmen do të vijojë të jetë si një bunker ku do të ketë vetëm lëvizje të komanduara kukullash. Ndoshta kësaj radhe... gjysma gra e gjysma burra. Por me besueshmëri shumë të ulët

sepse do të jenë këto, ato trupa vendimmarrëse, të cilat do të prijnë shoqërinë shqiptare drejt prosperitetit. Përderisa kjo vendimmarrje do të jetë siç edhe është në pak duar dhe në shumë duar të tjera, amorfe që vetëm ngrihen e ulen, si në teatrin klasik të kukullave. Pavarësisht, se e parë së jashtëmi, si dekor kjo barazi gjinore do të jetë e lakmueshme. Ilaçi më i mirë për të shëruar dhimbjen dhe neverinë publike për punët e pabëra...

Zoti Edi Rama, me aftësitë e tij të dallueshme të komunikimit, si agjiprop i përkryer, ka shkuar shumë larg në këtë rrugë. Aq sa po të bësh një bilanc mes Shqipërisë së kuruar prej tij dhe Shqipërisë tjetër, asaj reales, ato janë të papikëtakueshme. Dhe pastaj, si për të devijuar vemendjen publike prej dështimeve spektakolare qeverisëse, stisen tema të tilla, që janë luksi i shoqërive të zhvilluara.

Të tentosh të përmirësosh gjendjen e të drejtave të njeriut, të drejtën universale të të zgjedhurit dhe të zgjedhjes, në këtë mënyrë, duke krijuar raporte laboratorike "barazie", ngjan si reforma e "emancipimit të gruas dhe të gjithë jetës së vendit" e viteve '60, në kohën e atij rregjimit, që gruan e bëri... traktoriste, vinçiere, montatore dhe... që andej edhe udhëheqëse. Dhe portretet e tyre socrealiste muskuloze si të Herkulit...

*Panorama, 28 tetor 2016*

## Debati për kulturën e feve.

Nuk është se po shpiket rrota, që kumti kryeministor i para pak ditëve: “i takon çdo shteti që t’i hapë rrugë mundësisë, që çdo fëmijë të ushqehet edhe me kulturën e feve”, ka ngjallur kaq shumë debat. Sado sipërfaqësisht ta njohësh historinë e Shqipërisë, veçmas atë të viteve ‘20-40 dhe specifikisht mardhënien e shtetit shqiptar me besimin dhe ndërvarësisht edhe me shkollën, të duket se teza e hedhur nga kryeministri, z. Edi Rama për futjen e një lënde mësimi a edukimi fetar, anashkalon gjithë atë mardhënie dinamike mes shtetit e fesë dhe shkollës të 80 a 90 viteve më parë, kohë që përkon edhe me konsolidimin e shkollave shqipe dhe intonimit të tyre me simotrat europiane. Natyrisht është krejt tjetër e sotmja e gati një shekulli më pas, por as nuk është pra se kjo mardhënie është në embrion dhe po lind sot. Statusi i shtetit edhe askohe ishte laik, shteti njihte dhe lejonte shkollat fetare, megjith ulje - ngritjet e shënuara në këtë mardhënie. Në verën e vitit 1932, siç njoftonte shend e verë “Hylli i Dritës”, revista më autoritare kulturore në vend, “Një urdhën i N.M së Tij, mbretit tonë, lajmoi tash do ditë se tekstet

*shkollore do të mbarohen mbrenda dy vjetëve*".<sup>54</sup> Por as një vit më vonë, pati edhe mbyllje të shkollave private, të cilat, siç dihet, ishin kryesisht krijesa dhe të mbarshtuara nga kleri, sipas Dekretit të 22 prillit 1933, në bazë të të cilit mbylleshin të gjitha shkollat private, duke ia akorduar këtë të drejtë shtetit.

Edhe për partizanët e laicizmit skajor, si me thënë, që urdhëruan mbylljen e shkollave fetare (katolike), prap se prap edhe kjo nuk zgjati, falë ndërhyrjes energjike të klerikëve energjikë dhe faktor autoritarë si përfaqësues popullor, në kancelaritë diplomatike...

*...si rezultat i vendimit të Gjykatës së Hagës në favor të pakicës greke të cilët edhe ata kishin dërguar çështjen e shkollave në Hag, dhe vendimi i Këshillit të Lidhjes së Kombeve në favor të Kishës Katolike si dhe interesi bilateral ekonomik i Zogut më Italinë, bënë që në shtator të vitit 1936, shkollat Katolike të hapën serish.*<sup>55</sup>

Dhe arsye fundamentale ka qenë dobia e pakontestueshme e këtyre shkollave në dobi të iluminimit të popullit dhe njësimi të kombit e, pse jo edhe të shtetit shqiptar. Kurse debati asokohe ka pasë për palë personalitete që kanë bërë Shqipërinë, ka pasë shtetarë si Hilë Mosi, Marash Ivanaj, Medi Frashëri dhe përballë në debat, françeskanët e mëdhenj, prirë nga Fishta, shkollat e themeluara prej të cilëve kanë qenë më cilësoret, në akord me shkollat e mira të Europës perëndimore. Madje, linja të debatit kanë qenë edhe përballja ndërmjet pikpamjeve të tilla si: a do të ruajmë si nostalgji të shkuarën e lindjes

---

54 H.D, v.8.n.10/1932, fq.492

55 Markus W.E.Peters "Përballjet e historisë së Kishës katolike në Shqipëri 1919-1996, fq. 8

## Kohë e përlyeme

(reminishencat e Perandorisë osmane) apo do të mbajmë drejtimin perëndimor të shkollës.

Shteti shqiptar, vetëm në periudhën e tij më të errët, atë të diktaturës komuniste, ndërmori aktin e dhunshëm, unikal në planet për ndalimin kushtetues të besimit. Dhe masakren e vet e filloi pikërisht me shkollat e drejtuesit e tyre. (Kujtojmë që të pushkatuarit e parë në grup prej diktaturës kanë qenë: Rektori i Seminarit jezuit At Danjel Dajani dhe dy profesorë të tjerë të atij seminari, At Gjon Shllaku e At Giovanni Fausti, italian. E bashkë me to një nxënës seminarist, Mark Çuni. Kohët e tjera kanë qenë përgjithsisht mirëkuptuese ndërmjet shtetit dhe fesë (besimit) dhe shkollave të saj. Së paku juridikisht, por edhe si praktikë.

Mardhëniet e shtetit me fenë, sot nuk është se kanë ndonjë krisje, as me shkollat e besimeve, gjithashtu. Në reformën arsimore, të ndërmarrë nga qeveria ato, nëse nuk gaboj nuk kanë shënuar gjë për t'u prekur... Madje edhe sipas opinionit publik, ato janë ndër më cilësoret e sistemit arsimor dhe jo vetëm ndër shkollat jopublike... Si të tilla ato e mëkojnë mirë "ushqimin me kulturën e feve të fëmijëve". Ndërsa për t'u aplikuar si një projekt për gjithë sistemin...?

Gjendja e sotme lënguese e arsimit në Shqipëri a mund ta mbajë edhe një kurikul të re, posë të tjerash, edhe delikate?...

Gjithësesi, kumti i kryeministrit, më shumë se si një risi, si një gjest, për t'u lehtësuar nga ngërçet e qeverisjes, vlen se hapi një debat të dobishëm.

*Panorama, 17 prill 2016*



## Kishë-xhamia në Rozafat dhe “ekstremizmi” imagjinar i prof. Xhufit

Në debatin e hapur prej mbas 26 dhjetorit të vitit të shkuar për kishë - xhaminë në Kështjellën e Rozafatit e që po vijon ende, janë shpërfaqur aryetime gjithfarësh e janë improvizuar gjithfarë insinuatash, gjithashtu. Fakti, përreth të cilit kanë gjalluar të gjithë elementet e debatit ka qenë Mesha e dhënë aty në ditën e shënuar të Shën Shtjefnit-pajtorit të qytetit të Shkodrës, nga famullitari i radhës i Shkodrës, don Artur Jaku. Ky ritual i përvitshëm ka zënë fill qysh në fillimet e periudhës post ateiste, në vitin 1995, në kohën kur Arqipeshkëv i Shkodrës ka qenë Imzot Frano Ilia, tash në amshim dhe ç’prej asohere vijon pa ndërprerë. Bëhet aty një meshë përkujtimore, në rikujtim e nderim të kohës para rënies së Shkodrës, nën pushtimin osman, më 1479, kur objekti në fjalë ishte kisha e Shën Shtjefnit. Që prej asaj kohe e mbas kisha u kthye në xhami dhe këtë akt e pranojnë të gjitha palët ndërdebatuese si të vërtetë historike. Dëshmitë e argumentuara vijnë, më së pari prej studiuesve seriozë: Theodor Ippen në “Shqipëria e vjetër”, të tjerë më pas e deri tek Aleksandër Meksi: “Arkitektura e kishave të Shqipërisë në shek. VII-XV. Të njëjtin fakt e

pohon edhe prof. Pëllumb Xhufi, studiuesi dhe njohësi i specializuar i Historisë së mesjetës në një shkrimin e vet të para dy ditëve. Më pas, kur prof. Xhufi merr pësispër të japë drejtësi ndër palët debatuese, sipas gjykatores së vet, arsyeton: *“Sigurisht, meriton vlerësim qëndrimi i matur i komunitetit mysliman të Shkodrës dhe i vetë myftinisë, që nuk i janë përgjigjur provokimit të ndonjë famullitari ekstremist, i cili mendon se jeton në epokën e kryqëzatave dhe çdo 26 dhjetor u prin besimtarëve në një ritual grotesk, që zhvillohet në rrënojat e kishës xhami...”*<sup>56</sup>

Këtu më duket se profesori i nderuar ngutet paksa.

Mesha e shenjtë, sikurse çdo ritual lutjeje o bëhet o nuk bëhet; groteske assesi nuk mund të jetë. Një shëmbëllim i tillë për ritualin e përmendur mund të shfaqet vetëm i vështruar së jashtmi nga një jobesimtar a më saktë një ateist, i cili çdo akt të tillë e percepton dhe e përjeton të papërputhshëm me bindjet dhe ndjesitë e veta. Ateisti, në rastin në fjalë, sikundërse prof.Xhufi pohon të jetë. Natyrisht, e drejtë e respektueshme dhe e paqjetërsueshme e tij dhe e cilitdo, që ka zgjedhë të jetë i tillë. Por që nuk do të thotë asesi se perceptimet e tua janë gjithnjë e vërteta. E aq më tepër t’u imponohen të tjerëve si të tilla.

Ndërsa gjykimi, të cilin profesori ka marrë përsipër të bëjë, duket se rëndon fort mbi njërën palë, ndoshta edhe pse ai është i paazhornuar me të vërtetat më të fundit që lidhen me rastin që merr në analizë. Dom Artur Jaku, famullitari, pohon në krye të herës se për veprimtarinë ka marrë lejen e institucioneve shtetore. Të atyre

---

56 “Gazeta shqiptare, 24.01.2017

institucioneve që kemi dhe, unë mendoj se për shumëçka, zyrtarët tanë të institucioneve të kulturës meritojnë të qortohen pa dhimbë, por jo si neofit (rishtar në besim) që si të tillë favorizokan ndonjerin besim në kurriz të tjetrit, siç don të thotë prof. Xhufi

Njëherësh famullitari në fjalë, siç ai vetë e ka pohuar, ka komunikuar me Myftinë e Shkodrës, Z.Muhamed Syrtari , duke i a theksuar atij se, prej Kishës Katolike nuk ka pasë e nuk ka asnjë pretendim e se prej saj s'janë kërkuar kurrfarë tagrash pronësie mbi objektin në fjalë, në emër të komunitetit katolik, tashmë Monument kulture.

Kërkesa e vetme ka qenë kjo që aty të bëhet një vizitë e pelegrinëve të besimit katolik, në një ditë të shënuar, që përsëritet njëherë në vit, sigurisht me njetin e dëshirën e secilit që e dëshiron një gjë të tillë dhe për to të thuhej një meshë. Madje e ka ftuar Myftinë që, nëse dëshiron, mund të shkojmë dhe të kryejmë së bashku lutje në objektin e sipërpërmendur. "Një meshë, një koncert, një aktivitet kulturor, një moment lutjeje nga të gjitha komunitetet nuk e dëmtojnë këtë monument, përkundrazi i japin një vlerë të rëndësishme për kombin tonë." - është shprehur publikisht famullitari, don Artur Jaku. Dhe, mua më duket, se kurrfarë **mujscharie** nuk ka këtu. (*mujschar-që përdor forcën për të shtërnguar një tjetër të bëjë diçka, që shpërdoron fuqinë a pushtetin për të sunduar me dhunë mbi të tjerët ose për të bërë atë që do vetë; dhunues. fjalori i Gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980).*

Shkodra vetë është një qytet homogjen, dallueshëm si i tillë me rrënjë të thella qytetrimi, dhe aty ruhen vetvetishëm disa ekuilibra, që nuk mund të shprishen ashtu lehtë dhe turravrap sa herë ndodh ndonjë gricje,

qoftë ajo e pëmbrendëshme apo e stisur nga rrethana e faktorë jashtëqytetarë. Shembuj ka plot përgjatë historisë së qytetit, por meqë jemi në të sotmen, nuk është i largët për t'u sjellë në vëmendje rasti i meshës së parë parë në kapelën (kishën e varrezave) e Rr' majit, vjeshtën e vitit 1990, ku në bashkëthyerjen e frikës prej rregjimit kundërfe që po ikte kanë qenë së bashku katolikë e myslimanë, sikurse një javë më vonë, në rihapjen e xhamisë së Plumbit, gjithashtu kanë qenë vëllazërisht bashkë myslimanë e katolikë.

Kishë-xhamia dhe Kështjella e Rozafatit, mbrenda së cilës ajo është, përbëjnë sot një Park arkeologjik dhe si i tillë ai vizitohet prej cilitdo turist a pelegrin, besimtar a laik, shqiptar apo i huaj qoftë. Prej aty kundrohët ai peisazh i mrekullueshëm e i papërsëritshëm, dhuratë kjo e mahnitëshme e Zotit, si bekim i qytetit. Dhe sa më shumë vizitorë, aq më i përmbushur do të qe si institucion, aq më i dobishëm për kulturën tonë kombëtare, monumentet e së cilës vuajnë mungesën dhe jo teprinë e vizitorëve. Pa përjashtuar a anatemuar askënd. Madje shumë më i dobishëm se debati, që më shumë vjen si artific, në të përditëshmen halleshumë të qytetarit shqiptar sot.

*"Qëndrimet a sjelljet e famullitarit Jaku apo, në përgjithësi të klerit katolik (që s' më bëhet mbarë ta quaj "shqiptar", për sa kohë hierarkia e tij është e zënë nga klerikë të huaj) do të ishin një precedent e një shembull i keq edhe për drejtuesit e komuniteteve të tjera fetare"<sup>57</sup>, shkruan në artikullin e tij profesor Xhufi.*

Më së pari do të duhej sjellë në vëmendje një e vërtetë e njohur, që profesori e di më mirë se shumëkush se Kisha

Katolike është universale, sot e që prej zanafillës, status i cili nuk i përjashton klerikët jo shqiptar të jenë në hierarkinë e Kishës në Shqipëri. Po njëherësh do saktësuar një pohim jo i saktë në kumtin e mësipërm, se numerikisht vetëm diç më pak se gjysma e ipeshkvijëve të Shqipërisë janë jo shqiptarë. Sikurse edhe në Romë sot shërbejnë klerikë shqiptarë, si bie fjala dom Marjan Paloka nga Kallmeti i Lezhës e të tjerë. Asnjë dëm nuk i ka ardhur Shqipërisë prej klerikëve katolikë jo shqiptarë. Përkundrazi... Korpusi i veprës së At Giuseppe Valentinit është një fond i çmuar i filologjisë shqiptare, At Lorenzo Viezzoli, posë të tjerash i lë shkollës shqipe një tekst mësimor "Shqypnia-njoftime gjeografike shtetistik-administratore"<sup>58</sup>, që edhe pse hartuar në vitet '20 të shekullit të shkuar, si tekst mësimor për shkollën e Jezuitëve, është i lakmueshëm edhe sot për nga saktësia shkencore dhe skrupuloziteti i studimit; Fulvio Cordignano një fjalor italisht - shqip dhe një tjetër shqip - italisht, fort i çmuar edhe sot, Giacomo Junchu, një gramatikë të gjuhës shqipe, Lovro Mihaçević, një studim etnografik që rrok trevat shqiptare prej Ulpiane (Prishtinë) e deri në Prevezë... e sa e sa. Kurse shembulli i martirizimit këtu në Shqipërinë tonë i At Giovanni Faustit dhe Dom Alfons Trackit e dom Jozef Marksens, shpallur të Lumë prej Papa Françeskut, bashkë me 35 martirë të tjerë shqiptarë janë veçse shembull dhe ftesë nderimi e adhurimi, jo vetëm për komunitet e tjera fetare, por për shqiptarët mbarë...

*Panorama, 26 janar 2017*

---

58 *Botue prej Etnëve Jezuitë, Shkoder 1923. (Ribotimi anastatik me paraqitje nga Willy Kamsi, Botimet Fishta, 2014)*

## Protesta në teatër dhe “teatri” i kryeministrit

Deri dje kryeministri, Zoti Edi Rama, artist për nga formimi bazë, nuk është ndjerë përreth protestës që aktorët e teatrit kombëtar, aktorë edhe nga qytete të tjera kryesore të Shqipërisë, kanë nisur e po bëjnë prej më se një jave, përkundër një projektligji dhe vetë Ministres së Kulturës që e ka përgatitur i cili, simbas tyre u cënon atyre edhe ato liri jo të plota që ato kanë pasë deri më tani për ushtrimin e profesionit të tyre që është aktrimi, teatri pra.

Simbas projektit, i cili me gjasë do të bëhet edhe ligj e gjithë lëvizja teatrore, përfshirë atë të teatrit kombëtar dhe atyre të qyteteve të tjera të Shqipërisë, kërkon të centralizohet administrativisht, domethënë, ndryshe nga çka qenë deri më tani ku trupat teatrore, në njëfarë mënyre administroheshin nga bordet e tyre, tani e masandej do të drejtohen e komandohen vetëm nga një “dorë”, domethënë nga zonja Ministre e Kulturës sot dhe nga ministri pasues nesër. Njëherësh me projektligjin, aktorëve i u është kërkuar të lirojnë godinën e teatrit ekzistues, me arsyetimin e rindërtimit të tij, i cili për hir të së vërtetës është i domosdoshëm, madje ka një nevojë ulëritëse prej kohësh. Veçse, kjo i u është kërkuar atyre, pa i njohur

ata aspak me projektin rindërtues a me ndonjë projekt tjetër të një teatri të ri i cili, më së paku duhej konsultuar në radhë të parë me aktorët si grup interesi. Po edhe me publikun e gjërë qytetas, domosdo. Se po bëhet fjalë për teatrin kombëtar dhe jo për një ngrehinë, që e çfarëdo destinacioni qoftë, nuk mund të kishte rëndësinë e teatrit qoftë edhe si vepër urbane.

Dje, Zoti kryeministër është paraqitur me qëndrimin e vet rreth protestës nëpërmjet bashkëbisedimit me një fansin e vet në facebook (!).

- I ke dëgjuar Robert Ndrenikën e Bujar Asqeriu? - e pyet ai.

- Jo, nuk i kam dëgjuar ata që s' dinë çfarë duan- i përgjigjet Zoti kryeminister. Si gjithnjë edhe kësaj here, në stilin e tij tallës e fyes, përbuzës me këdo e me gjithkënd. Me punëtorë, fshatarë, profesorë e gazetarë... E drejtë që ai ia ka dhënë vehtes qyshekur ka zënë atë karrigen e rëndë të pushtetit të lartë. Edhe kësaj radhe njësoj, pa u vënë sadopak në sedër se po flet për atë specie njerëzie këtu në Shqipërinë tonë, që për aq sa kanë bërë do të mbahen mend e të kujtohen për mirë edhe atëherë kur emri i zotërisë së tij dhe një dyzine kryeministrash të qindvjetshit shtet shqiptar do të kujtohen mjaft më rrallë e aspak me respekt.

Po ka një gjë edhe më përtej mungesës së respektit që shfaqet në formën e talljes e cinizmit, në formën e shpërfilljes dhe të vjedhjes së gjësë publike, pa u përgjigjur qoftë edhe një herë të vetme para askujt. Kqyrja e vetvehtes përmbi gjithkënd mbi tokë prej asaj vendkqyrjes së karriges hijerëndë, nuk është modeli i panjohur për ne të qeverisurit e zotërisë së tij. Ky është profili i udhëheqësit

autokrat që e njëson pozitën e kryeadministratorit të punëve qeverisëse me sundimtarin. Sikur njerëzit të ishin kolon të tij. Taborret e këtij kryeministri janë të akuzuar si dëmtorët më të mëdhenj të ekonomisë kombëtare dhe të prosperitetit të vendit.

-Ne kemi bërë teatro e stadiume më shumë se ç'janë bërë për 26 vjet -tha...

Ja tregon Robert Ndrenikës se çka bërë ai për teatrin... Sa tragjikomike. Në të vërtetë, bëma e vetme e zotnisë së tij është ajo që Roberti, Mirushi e vërsnikët e tyre e mbajnë mend mirë. Ka qenë atëherë kur teatrin desh t'ua bënte kullë..., një qasje që vjen vërdallë edhe tani. Aktorët e kanë shprehur këtë shqetësim dhe këmbëngulja e ministreshës tek projekti i qeverisë, ngjan si detaj regjisorial në një teatër kukullash ku fijet i luan "mjeshtri"... Ndaj dhe duan ta përmbyllin sa më shpejt zërin e protestës së aktorëve dhe sindikatës së tyre.

Nuk e di se ka ndonjë kryeministër tjetër, së paku në Europë, që të ketë dialoguar publikisht me një homologun e vet europian si kryeministri ynë: "Hajdeni investoni, i ka thënë atij, se në Shqipëri nuk ka sindikata që të mërzhisin...". I ekzaltuar, se vendin e vet gjasme demokratik nuk ka sindikata që të mërzhisin... Kjo e vërtetë e trishtë është e njohur dhe e bërë publike.

Edhe sot, tre vite më vonë e njëjta sjellje vërdalloset.

Një autokraci e frikëshme, një ré e zezë për demokracinë, që unë shpresoj se zëri i kultivuar i aktorëve, në rezonancë me zërin e revoltës që zien, do ta zhdavarisë (shpërndajë) këtë ré.

*Panorama, 14 shkurt 2018*



Frano Kulli



*Shkatërrimi i Sahatit të Inglizit, Shkoder 1946  
(foto Gegë Marubi).*



*Shkoder, 1989.  
(Foto Nenshati)*

## Akti i fundit i dramës “Kur shembej teatri”

I prerë, me një kumt të akullt, plot me shpërfillje e shpoti si gjithëherë dhe i bindur se me këto elementë të sjelljes së tij rutinë kryeministore do të ndalë përfundimisht qëndresën e zbehtë të komunitetit të artistëve, disa prej të cilëve ishin të ftuar në një takim për të mos u dëgjuar e për të mos folur, por vetëm për ta dëgjuar atë, Zoti kryeministër, duket se i dha fund edhe shpresave të vagëlluara se godina e teatrit nuk do të prishet. Kështu, me vendimin e tij që kumtoi atë ditë në atë sallë memece ai nënshkroi aktin e fundit të dramës urbane në qendër të Tiranës. Të zaptimit e tjetërsimit të asaj pjesës që ende kish mbetur deri tani e pa zaptuar, në ato pak mijë metra katror që qarkojnë atë ngrehinë, që quhet “teatri kombëtar”.

E rrënuar prej moskujdesit të qëllimshëm sistematik, se sido që ta vërtisësh arsyen nuk bie në përfundim tjetër, me fasadën e vet të vrugnuar, gati të abandonuar, skicuar 80 e sa vjet më parë si “dopolavoro” e italianëve, që ishin atëherë këtu, mirë a keq mbart historinë si ngrehina ku u themelua ai, teatri kombëtar. Dhe, në një vend normal, që qeveriset prej një qeverie të zgjedhur në demokraci,

një shembje e tillë nuk mund të ndodhë. Nuk mund të ndodhë që të shembet historia me një të rënë lapsi të një njeriu. Qoftë ky edhe kryeministër. Se përballë tij do të gjendeshin artistë, zëri i të cilëve do të kumbonte deri sa të shkundte timpanin e veshit të udhëheqësit që nuk dëgjon. Po në kor me ta do të ishin edhe shumë e shumë zëra të tjerë qytetarë, që do ta detyronin udhëheqësin të shikonte derën nga të dilte... Se është shumë dramatike të shembësh e të shkulësh rrënjët e vlerave historike të vendit tënd.

Po, me gjasë kjo do të ndodhë, teatri me të vërtetë edhe mund të shembet (!). Përderisa këtu ndër ne, në këtë mënyrë është zhbirë e zhbërë shumëçka nga idenditeti ynë.

Dhe, nëse kjo do të ndodhë, kush do të mund ta besojë më prej brezave të mëpastajmë se edhe në Tiranë ka pasë ndonjëherë një godinë ku është bërë e luajt teatër?

Asnjë shenjë, asnjë dëshmi s' do të mbetet më, nëse ajo ngrehinë do të shembet dhe diku aty afër vendndodhjes së saj të sotme do të jetë ngritur një ngrehinë tjetër e betontë a e xhamtë, diçka si kubiste, që mbas monstrimit të parë publik që i është bërë atij projekti, me diçiturën poshtë: **Teatri**, fyen rëndë shijen më të zakonëshme qytetare. E do të rrethohet me kulla të larta, e kështu do të groposet thellë e më thellë, kujtesa për godinën e bashkë me të gjithë historinë që ajo mbart...

Në Tiranë vërtet pak më vonë, por në Shqipëri edhe teatri ka një historinë e vet të herëshme. Zanafilla është në Shkodër, në gjysën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Njëri prej emblemave të këtij zhanri të arteve në Shqipëri,

aktori dhe regjisor Lec Shllaku, në librin e vet “Maskat shkodrane”, Shkoder 2002, sjell si fillësë të teatrit të mirëfilltë të komedisë vitin 1860 (?), *kurse salla e parë laike në të cilën u mbart trupa e parë e komedianëve t’Oborrit të Fishtorëve - shkruan ai - që mbas kazermës... që kishin ndërtue turqit ndonjë vjetë ma parë. Garnizoni turk e hoqi prej andej depon e ndërtesa mbeti e mbyllun e po fillonte të damtohej. Me kërkesen e grupeve teatrore, një tregtar nxorri leje prej komandës së garnizonit që ta riparonte e ta përshtaste për shfaqje... (Është viti 1891!)*

Kurse, shumë pak vite më vonë, në fillimin e shekullit të shkuar, vetëm në Shkodër kishte jo më pak se 7 salla shfaqjesh teatri. Pranë shkollave si Liceu Ilyricum i françeskanëve kur ishte futur, me shumë mund e përpjekje gjuha shqipe si gjuhë mësimi, nga drejtori i saj Gjergj Fishta me 1902, njëherësh u ngritën edhe sallonet e para të shfaqjeve. Pra Teatri.

*Salloni i jezuitëve me 450 vende (ishte ngritë që me 1890), i françeskanëve me 300 vende, i motrave stigmatine (1914) me 250 dhe që nga viti 1919 edhe një teatër veror me 600 vende në oborrin e shkollës françeskane. Pas dhjetëvjetëshit të parë të shek. XX vijnë sallonet e shoqërive kulturore të qytetit: Bogdani (me 350 vende), Rozafat (me 400 vende), Vllaznia (me 400 vende), Shkolla e Parrucës (me 400 vende)... Në vitet '30 në Shkodër bëheshin shtatë teatro (ndonjë edhe kinoteatër), me gjithsej 2500 vende. T. Çobani, Koha Jonë, 10.03.2018 .*

Në këto salla janë luajtur asokohe pjesë dramatike, krijime të autorëve shqiptarë (krijime sipas Molierit e Shekspirit), po kryesisht pjesë origjinale nga po autorë shqiptarë, Fishta, Anton Xanoni, Hilë Mosi, Kolë Mirdita

(Helenau), Zef Mark Harapi etj...E interpretë të këtyre pjesëve në sallat teatrore të Shkodrës; Loro Kovaçi, Pjetër Gjoka, Marije Logoreci, Gjon Karma e të tjerë janë më pas bashkëthemelues të Teatrit Kombëtar në Tiranë, që sot duan ta shembin...

E ndërkohë që ngulmohet shembja e teatrit janë ringritur si dëshmi të historisë sonë, shtëpia e gjetheve, domethënë shtëpia e zezë e spiunëve, bunkeri: "bunkart" e ngrehina të tilla që... E ç'përfaqësojnë gjithë këto në historinë tonë? Njërën prej pjesëve më makabre të saj. Po, po të historisë sonë, që s'mund ta ç'bëjmë e s'kemi pse ta fshehim.

Po atëherë, pse gjithë kjo neveri e histeri për godinën e teatrit? Që mirë a keq është shtëpia e parë, është zanafilla e teatrit kombëtar. E cila, për një vend normal është histori qytetrimi.

*Panorama, 17 maj 2018*

“Se njerzit e shtetit s’janë Shqipnia...”

Tregon At Anton Harapi: “Kam ndodhë vetë aty kur një shqiptar i vjeter, tue u ankue një ditë me At Fishten për shpërdorime të disa nënpunsave të shtetit, gadi si i dishpruem i thotë: - Pater Gjergj, shporru Shqipniet, persé [sepse] Shqipni nuk ka! - Fishta, i prekun prej shfrimit të plakut edhe i zemruem, por jo i trazuem po don t’ia spjegojë bashkëfolësit se njerzit e shtetit s’janë Shqipnia... E atëherë plaku, për me i diftue se kishte mbetë i bindun i thotë Fishtës: - Po na s’e kemi ditë mor Zotni, veç prej jush e kemi mësue se shka asht Shqipnia... “<sup>59</sup>

Biseda e kaherëshme, që për mua u bë shtysë të shkruaj për të disaten herë për shembjen e teatrit kombëtar, është bërë në vitin 1923. Gati një shekull më parë. Kaq të tëhuajtura [të largëta] ishin bërë mardhëniet e njerëzve të shtetit me shtetasit, sa për shumicën e popullatës, lëshohej shfrimi i kobshëm: nuk ka mâ Shqipni... Edhe pse kishte kaluar vetëm dekada e parë që vendi i tyre, Shqipëria ishte e lirë pas robërisë së gjatë. Tashma me shtetin e vet, me Kuvendin dhe me qeverinë e vet e me zyrtarë shqiptarë.

---

59 “At Gjergj Fishta 1871-1940”, B. Dema 1941, fq. 51

Por ata, zyrtarët, njerëzit e shtetit pra, kaq shpejt ia kishin bërë borxh njerëzve mbarë të popullit sa “me t’u ndye vetja [këtu: neveritë], shfrenin ata e me të dalë ky gulç zemërimi e neverie për njerëzit e shtetit, tashma jo të huaj e që ti i ke zgjedhë që të të administrojnë vehtjen tënde, lirinë dhe pasurinë, mallin e gjënë dhe sigurinë e jetës. E mandej, në dëshpërim të thellë, njerëzia mbarë i drejtonin sytë tek ata të paktët shqiptarë të njëmendtë; te ata që e kishin provue para ndërgjegjes së kombit se punojnë për vendin, për Shqipërinë, për shqiptarët. Me punën e me vepren e tyre të njëmendtë. Këtë na e thotë historia, e shkuara jonë...

Po a nuk po ndodh kështu edhe sot e gjithë ditën? Gati një shekull më vonë? Rruga jonë e shtetformimit demokratik vërtitet në formë spiraleje dhe ngjitet thuajse hiç. Në krejt hapësirën demokratike që ne dëshirojmë ngjitja është asmatike. Asaj po i merret fryma prej të përpjetave të forta, të stisura. Edhe te kultura, gjithashtu. Tani, kryeministri ka vendosë përfundimish ta shembë teatrin kombëtar të Shqipërisë. Se nuk i pëlqen e nuk i intereson atij e diçka tjetër preferon të bëjë ai në vend të teatrit. Prishjen po kërkon ta rregullojë me ligj, që kështu ta taposë e ta bëjë të paprekshëm aktin e tij të rilindjes kulturore të Shqipërisë europiane. Të ngritur “mbi gërmadhat e botës së vjetër”...

E njerëzia, të habitur e të mpirë gjymtyrëve të mendjes i kanë ngulitë shikimet e tyre në rrugën e ikjes. Të shporrjes prej këtu. Se... ky vend nuk bëhet (Se Shqipni nuk ka.) Bile duket se këtë ia kërkojnë edhe Mirush Kabashit e Robert Ndrenikës, të cilët janë kaq të pezmatuar e me telat e shpirtit të ngritur deri në skaj të revoltës. E do

pak të tjerëve si ata që kanë mbetë këtu në Shqipëri. Se ky vend nuk bëhet, thotë pikëllimi i tyre, (Se Shqipni nuk ka). Të ikin, duket sikur u thonë me apatinë e tyre, Mirushit, Robertit e atyre pak të tjerëve. Njerëzve në shenjë në memorien e kombit, që me punën e vepren e vet na kanë treguar se e duan Shqipërinë më shumë se... njerzit e shtetit. E duan teatrin e kulturën kombëtare shumë më shumë se ministresha e kulturës. E se të tjerë ministra pararendës. Shumë më shumë se ata.

“Sokrati” i Mirush Kabashit na ka bërë të ndjehemi shumë më tepër shqiptar se rituali i qokave të kryeministrit tonë nëpër Ballkan e herë e herë në Europë. Dhe kur u pyet, zoti kryeministër, pas protestës së parë të aktorëve se: a e ka dëgjuar Robert Ndrenikën, ai qe përgjigjur: “Unë nuk i dëgjoj ata që s’ dinë se ç’kërkojnë “ ...

Kryeministri don pra me ngulm ta prishë teatrin. Teksa për t’u vënë në skenë “Gomari i babatasit” drama-satirë e Fishtës, prej veqilave të tij drejtonjës atje, kërkohet që më parë të shihet (kontrollohet) teksti. Edhe pse e shkruar edhe ajo në vitin e largët 1923...E prap kërkohet siguri se mos fshikullimi që u bëhet aty, personazhit të kryeministrit e deputetit të marrë prej rruget e të sjellë në parlamentin e atëherëshëm do të «dogonisë» shefin e veqilit sot.

Njësoj si atëherë... gati 100 vjet më parë.

*Panorama, 15 qershor 2018*



Pjetër Arbnori në oborrin e Kuvendit,  
një mea culpa për politiken ?

Shtatorja e Pjetër Arbnorit, një figurë bust në karakter e zotni Pjetrit me një si tubë fletësh të hapura libr nën krah, simbolika e gjetur me shije e plot art që përmbush edhe artistikisht figurën jo njëdimensionale të Arbnorit, është vendosur në një cep të gjelbër në të djathtë të oborrit të sallës së mbledhjeve të Kuvendit të Shqipërisë. Më saktë sot u bë ceremonia dhe në përmbyllje të saj u zbulua shtatorja, pasi ajo është vendosur aty disa ditë më parë. Ndonëse jo me shumë pjesëmarrës po për nga përbërja e të ftuarve që ishin aty, tuba e njerëzve aty besoj ka qenë ndër më të larmishmet, gjë që nuk nuk ngjet fort shpesh këtu në Shqipërinë tonë. Ishin miq të Pjetrit e të familjes së Pjetrit; të Filipit e Gjystinës, trashëgimtarëve të tij dhe Suzit, bashkëshortes rreth së cilës përbashkohet familja solide dhe shumë e respektuar Arbnori. (njëri prej tyre isha edhe unë). Ishin deputetë të “orëve të para” të Parlamentit të parë, nga të dy krahët e politikës, Ruli, Rexhep Uka, Tonin Alimhilli, Musa Ulqini, Pandeli Majko, Ilir Meta, Tomor Dosti... ish kryetarë e nënkryetarë të tij, Jozefina po edhe Skënder Gjinushi si dhe deputetët e tjerë “të orëve të fundit”, të së djathtës kryesisht, të prirë nga kryetari i opozitës. Ishte edhe kryetari i Bashkisë së Tiranës....

Mjeshtri Sadik Spahija, autori i veprës, në një anë të grumbullit të pjesëmarrësve, I qetë por dhe i emocionuar duket, e shumta thotë ndonjë fjalë të ndërvarur , thjesht rreth elementit simbolik të veprës (fletët e hapura pra) dhe për më andej, në bisedë me miq thotë se vepra është realizuar rreth dhjetë vjet më parë, pasi qe shpallë fituese në një konkurs të bërë asokohe...Pra Pjetër Arbnori, për të ardhur nga studioja e artistit mjeshtrë deri në... oborrin e sallës së asamblesë së kuvendit, aty ku ai ka drejtuar së pari si spikeri i parlamentit pluralist në atë patalogun e gjelbërt ku gjendet tani ka bërë dhjetë vjet të vijë...

Hapjen e ceremonisë e udhëhoqi, zoti Gramoz Ruçi. Sigurisht ai të cilit i takonte ta drejtonte solemnitetin. Se është kryetari i parlamentit sot. Por edhe për një arsye më shumë. Sepse zotëria e ka ndjekur vetë të gjithë procesin e këtij akti, me të gjitha detajet e duhura që akti kërkonte. Përfshirë edhe lejen e kërkuar prej këshillit bashkiak të Tiranës. -Pjetër Arbnori ishte një personalitet politik i vendosur dhe i respektuar. Jeta, vuajtjen ia derdhi lumë, kurse lumturinë ia dha me vonesë dhe ia mori shpejtë-tha Gramoz Ruçi.

Një pohim me fjalë ndjese ?...

Besnik Mustafaj, në fjalën e rastit të shkruar me mjeshtri të përkorë përcolli thujse gjithë mirësinë e Pjetrit e veçmas cilësinë e tij të tolerancës, që buronte prej gjithë formimit kristian të Pjetrit.

-Mirëseerdhe në shtëpinë tënde, zotni Pjetër!-uroi Besniku.- Pjetri ishte pajtues , por jo në dëm të së vërtetës. Nëse do ulej në këtë sallë sot, do të ishte kundërshtar politik i Gramoz Ruçit. Por ai prapë për këtë bust do ta falënderonte atë-tha ai.

Besniku është edhe zanafilla e vendosjes së shtatores së Arbnorit në oborrin e bujtinës së tij politike, sot. Kohë më parë ai, nxitur edhe nga shkrimtari i mirënjohur Stefan Çapaliku, i pati drejtuar një letër kryesisë e kryetarit të Kuvendit me propozimin që të ndërmerrej një akt i tillë. Sigurisht, me staturën që Besniku ka në skarkierën politike të dekadave të fundit. Edhe pse bashkëpunimi i tij i gjatë në politikë me zotni Pjetrin, nuk ka pasë shkuar gjithherë fjollë, si në vaj... Ne, të gjithë duhet ta kishim bërë shumë më përpara këtë.

Dhe kumtin, në përmbyllje të përpjekjes realizuese të tij unë e lexova si një "mea culpa". Për Pjetrin e sjelljen me të. Jo të tijën veçmas po të të gjithëve. Të atyre që koha, duke iua ofruar në krah Pjetër Arbnorin e mirë, ua kish caktuar për detyrë ndërkaq që të modelonin sjellje të përputhëshme, me mirësinë e me dobinë e papërsëritëshme të tij, në krah të lirisë e të demokracisë. E njëherësh për gjithçka të pabërë e përgjithçka tjetër që do të duhej të ishte bërë më mire, përgjatë këtyre gati tri dekadave.

Kurse, Sali Berisha, që Pjetrin e pati pritë meritueshëm në udhën e bashkënisur të hyrjes në rendin e ri të demokracisë, por që nuk e pati përcjellë bash ashtu në përmbyllje, bashkë me Suzanen (bashkëshorten e zotni Pjetrit) zbuloi shtatoren.

Në heshtje. Pa fjalë...

Thua si ndjesë?

*Oborri i Parlamentit, me 19 korrik 2018*

## Koha e çmendur... e Stefan Çapalikut

Segmente kohësh plot dalldi e trandje, që shpesh na kanë rrokullisë deri afër çmendisë e të shprishjes si etnos, ne shqiptarët, kemi përcjellë jo pak herë. Kësi copa e grima kohësh kemi pasë edhe në shekullin më të fundit, kur mirë a keq jemi administruar jo prej të huajt pushtues, por prej shtetit tonë.

Stefan Çapaliku, ka ndarë një periudhë njëzetvjeçare prej kësaj kohe të çmendur, dhe duke i trajtuar ngjarjet e përzgjedhura si lëndë artistike, i ka shtjelluar në romanin e vet më të ri: "Secili çmendet simbas mënyrës së vet". Romani i zhvillon ngjarjet, në qytetin e Shkodrës... Qyteti - ekstrat i rezistencës mbarëqytetare në Shqipërinë e kohës së (kolerës) dikaturës. Dhe është libri i tretë që shkruhet për Shkodren në një hark të gjatë kohor, filluar me "Shkodra e rrethueme" e Marin Barletit, në shekullin e XV, për të vijuar me "Rrethimi i Shkodres" i Dom Ndoc Nikajt në vitin 1913.

Dy gozhdët, që mbajnë të tërhequr litarin e ngjarjeve, në romanin e ri të Stefanit janë ngulur, njëra në vitin 1967, kur Shqipërinë e shpallin shtet ateist dhe tjetra në vitin 1985, kur vdes ai që e shpalli.

Frano Kulli




*Tefë Palushi*



*Pjetër Gaci*




*Pjetër Gjini*



*Kolë Ashta*

*Zef Zorba*



Brenda këtyre dy ngjarjeve të forta, që përcaktojnë edhe segmentin më të ashpër dhe fanatik të komunizmit shqiptar, nxjerr krye një ngjarje tjetër, në dukje e vogël, që është ardhja e televizorit në shtëpinë e vendosur në qendër të romanit.

Ardhja e kësaj kutie magjike, tamam në çastin kur Shqipëria po kthehej në një ishull të shkretë e të pashpresë, e ndan romanin në tre pjesë: Para (ardhjes së televizorit), Gjatë (koha kur nëpërmjet televizorit shikohej bota) dhe Mbas (koha që vjen pas vendosjes së zhurmuesit).

Romani e nisë turrin tregimtar ndërsa jashtë po shkatërroheshin institutet e religjionit dhe brenda po lindte një institut i ri besimi, që ishte televizori, media.

Ai i vë fre kallëzimit në kohën e realizimit të ëndrrës së diktatorit, vdekjes së tij në shtrat.

Veçanërisht gjatë viteve të shndërrimit të shtëpisë së rrëfimitarit në një kinema, kemi rastin të njihemi nga afër me karakteret, të cilat qyteti bujarisht ia ka dhuruar kujtesës së autorit.

Autobiografik, romani është një dëshmi letrare e trupit, shpirtit dhe mendjes së qytetit, përgjatë një prej lëngatave të tij më të pashpresa. Personazhet që lëvizin nëpër ngjarje, por që edhe i parathënë e projektojnë ato, janë aso qytetarësh, arketipe gangull (copë, e pandarë, *Fjalori i Gjuhës së sotme Shqipe, Tiranë 1980*) të një qytetrimi bashkëkohës. Ato vetë përbëjnë sfidën e çmendisë së kohës... Prof. Kolë Ashta gjuhëtari e Prof. Gjon Shllaku helenisti, që së bashku me zozush Netat e tyne (gratë që ishin mësuese) vijnë në orët ma të vona në shtëpinë - kinema, ku është ajo kosherja magjike (televizori), për me knaq sadopak shijet e tyre oksidentale. Përtej bunkerit të madh ku, posaçë (veçanërisht) ata ndiheshin të ndrymë.

Frederik Rreshpja - poeti, liriku i mrekullueshëm, që... qendiste në gjergjef (?) nën hijen e pemës në oborr. Masandej ma vonë, një ditë mësuesja e letërsisë e rrëfimitarit, nxënës asokohe, sapo hyn në klasë, pa filluar mësimin u thotë nxënësve: *"Hapeni të gjithë librin e leximit në fq. 55. Po, po aty te poezia "Rapsodi shqiptare" dhe me kujdes... griseni. Po, po librin. Se autori i poezisë është shpallur armik i partisë dhe i popullit. Dhe as që ia zuri në gojë emrin Frederikut të shkretë."*<sup>60</sup>

---

60 S.Çapaliku: "Secili çmendet simbas mënyrës së vet.", fq.128

Tefë Palushi (karikaturisti) bartësi emblematic i baracaletave - sfida më inteligjente e kohës së çmendur... Për një udhëtim 4 orësh në trenin nga Shkodra në Tiranë, në të njëjten ndejëse me Tefen, cilido i ri student ishte i gatshëm, me gjithë qenien e vet të sakrifikonte çdo qasje tjetër me cilëndo bukuroshe...

Zef Zorba, poeti, përkthyesi, dramaturgu, që... në funddhjetorin 1975 do të përkthente dhe "inskenonte" dramën e dramaturgut dhe romancierit të famshëm amerikan Thornton Wilder.

Neta kojshije, që i kishte kërkuar autorit, tashti student që t'i gjente një fjalor frëngjisht - shqip. E donte për Pjerinin (Pjetër Arbnorin), vëllain, që ishte në burg. Por... mbas disa ditësh kur e kishte takuar Netën e ajo i kishte thënë se Pjerinit i qe dukë i vogël fjalori, ai ishte çuditë e mrekulluar...

E sa e sa, këso personazhesh të papërsëritshëm; Pjeter Gaci i famshëm, me historinë origjinale të krijimit e kushtimit të këngës "Ky marak", e cila kujtohet e rikujtohet prap, shpesh. *(Historia ? Aq e thjeshtë dhe e dliër sa mos me u besue... Në rrugicën përpara shtëpisë së kulturës, aty ku muzikanti i madh përcillte shumicën e orëve të ditës e të mbramjes kalonte shpesh një vajzë, bukuroshe në shenjë e Shkodres së asaj kohe. Viola... Rituali i parakalimit të saj, kishte lanë shej në telat e shpirtit krijues të kompozitorit...dhe kanga u krijua (Lule je, lule ke emnin...).* Po kanga nuk mund të delte pa i shtue edhe gjestin ma të njerzishëm në botë të kompozitorit. Një ditë të bukur ai ndalon në rrugë, jo Violën, po të fejuarin a të shoqin e Violës.

## Kohë e përlyeme

*-Jam Pjeter Gaci- i thotë- A mundesh me ardhë pak me mue deri këtu sipër në studion teme? E i prin për andej.Ngjiten së bashku me zotninë, Pjetri ulet në piano dhe fillon e luan kangën ma të re që kishte shkruar. Mandej rimerr bisedën me të ftuemin e vet:*

*-Këtë kangë, i thotë, unë ia kam kushtue grues tuej. Por kjo kangë nuk mund të dalë (domethanë nuk mund të publikohet) pa bekimin tand... Kaq dhe Pjetri bjen në heshtjen e pritjes së përgjigjes...*

*-Po unë ndjem fort i nderuem zotni Pjetër-i që përgjigjë zotnia.*

*Dhe kështu kanga mori udhë. Një udhë të gjatë e të pandërprerë, tash së paku 40 vjet...)*

Nuh Sahatçija, mjeshtri orëndreqës i pakundshoq, bashkëlidhur me njëren prej historive të tij të ralla: Diku në mesin e viteve '70 në dyqanin e tij, ku tashma ai nuk ishte pronari po përgjegjësi, i hyn një turist i huaj. Gjermanoperëndimor. Dhe i flet gjermanisht:

*-Zotëri, quhem Hans Verter Lomajer. Me 27 nëntor të vitit 1944 kam lënë për të rregulluar një orë të markës "MÜHLE GLASHÜN...- Pa mbaruar mirë prezantimin e vet turisti, usta Nuhi hap një sirtar, hap një tjetër të dytë dhe i jep të zotit orën që qe ruajtuar aty prej 30 vjetësh... dhe i thotë:*

*-Urdhno Zotni, në atë kohë keni pasë për të pague 20 franga. Sot nuk keni për të pague asgja...*

*Ase Pjetër Gjini, muzikanti dukshëm kontravers..."Hymë në Kafë të Madhe me Aleksin. Pjetër Gjini na njeh e na buzëqesh.*

*-Hë daja Pjeter, mese po merresh këto ditë...?*



Frano Kulli

*-Ah, po përpiqem me përkthye në shqip kangen e famshme të Domenico Modunjos "Volare". Me fluturue!*<sup>61</sup>

Një galeri tipash, siluetat e një fytyre perëndimore të qytetit që përpiqeshin ta ruanin statukuonë e tij, me shpirt ndër dhëmbë...

Letërsia shqipe e derimëtashme na e ka përcjellë komunizmin ose nëpërmjet "heronjëve" që i vërdalloseshin Bllokut ose përmes Heronjëve që ngujoheshin burgjeve.

Ky nuk është as romani i heronjëve ndër thonjëza, e as romani i heronjëve me H të madhe... I kohës së çmendur.

*Panorama, 28 dhjetor 2016*

---

61 S.Çapaliku:"Secili çmendet simbas mënyrës së vet: fq.143

## Rrëfimet e dom Gjergj Metës në kishë e përtej

Kur dom Gjergj Meta ka nisur rrëfimin e tij të dytë publik, nëse do të veçojmë kështu vetëm njërrën prej mënyrave të shumta të rrëfimitarisë së sotme publike, atë nëpërmjet librave, ai ka zgjedhur e arsyetuar që edhe shumë prej eksperiencave të veta t' i radhisë në faqet e librit të tij të dytë: " Hyji është Atë me zemër nëne".

Rrëfimi si akt besimi, për besimtarët katolikë është njëri prej shtatë sakramenteve, është akti i pohimit të atyre veprimeve, të cilat njeriu që beson te Hyji ia paraqet Atij, nëpërmjet meshtarit. I pohon në mënyrë të përsëritshme intimen e vet që e arsyeton si mëkatore. Dhe bashkë me të edhe lutjen për faljen e mëkateve. Për shkoqitjen më mirë të kuptimit fetar të fjalës **rrëfim**, dom Gjergji u referohet gjuhëve më të vjetra, latinishtes dhe greqishtes, i referohet Çabejt tonë të madh, vëllimit të tij të gjashtë të Studimeve Albanologjike, i cili shkruan se prejadhja e fjalës sipas Miclosich vjen nga latinishtja *confiteri*, që do të thotë: me tregue, me pranue, kurse sipas Gustav Mayer-it vjen nga fjala tjetër latine *referre* - me referue, me raportue, me nxjerrë jashtë, me tregue.

Shtjellimin e këtij akti, autori e ilustron edhe me eksperiencën të vetat si njeri e si prift. Por, njëherësh edhe me shembuj nga tradita dhe e sotmja e kishës dhe e besimit. Atë Anton Luli, siç i kanë treguar rrëfyesit autor, *i cili ditët e fundit të jetës pas rënien së rregjimit i kaloi ndërmjet shtëpisë së jezuitëve dhe rrëfjestores së Kishës "Zemra e Krishtit" [në Tiranë], mbante gjithmonë në xhep karamelle e ua jepte të gjithë atyre që rrëfeheshin, mbasi kishin mbaruar rrëfimin...*<sup>62</sup> Sigurisht që shembulli sillet si një simbolikë. Dhe simbolika që vjen prej Jezuitit të përvuejtun është e thjeshtë; mbasi i ke "shkarkuar" mëkatet e tua prej vetvetes dhe i ke lëshuar në prehërin e Atij që të don, pra te Hyji, ndjehesh mjaft më pak i "ithët" e mjaft më shumë i ëmbël. I lehtësuar në shpirt e në zemër.

Sigurisht, rrëfimi nuk është një gjë që bëhet lehtë dhe pa emocione. Rrëfimi nuk është një gjest. Këtë sipërmarrje e veprim të besimtarit praktikant, dom Gjergji ka dashtë dhe ia ka dalë ta përcjellë edhe më përtej kishës. Ai e arsyeton dhe e ofron rrëfimin si një mundësi për te të gjithë njerëzit, besimtarë dhe jo, si një gjendje e nevojë e brendëshme për secilin.... "Në përvojën time kur jam rrëfyer - shkruan dom Gjergji - çdo herë që kam praktikuar këtë sakrament për vehte, ka ndodhur një shndërrim, një fillim i ri...". Dhe këtu rrëfimi vjen tashmë si një veprim përtej kishës e besimit, si një akt i qenies shoqërore. Kështu vjen e nevojëshme thirrja për ta bërë këtë secili njeri. Për ta bërë në raport me vetveten, me më të afërmin, me mikun, me të njohurin. Për ta bërë me tjetrin më përtej, me të cilin

---

62 Gjergji Meta, *Hyji është Atë me zemër nëne*, fq 55

e ka lidhur një veprim a një marrëdhënie, cilado qoftë ajo dhe që është pasuar me shfaqjen e të mirës dhe të keqes mbrenda për mbrenda këtij akti a kësaj mardhënie. Në cilindo rast është e nevojëshme një “mea culpa”. Sepse mbasi të jetë bërë ajo, të bën të ndjehesh mirë ty vetë, më së pari. Vetëkuptueshëm të bën të gjendesh përpara një “fillimi të ri”, gjithësesi më të paqtë e më frymëzues për të ardhmen tënde...

*“Mea culpa është së pari personale e pastaj edhe e atyre që kanë përgjegjësi në Kishë - arsyeton dom Gjergji - Sigurisht, unë kërkoj falje për njerëz brenda Kishës, që nuk janë sjellë në përkim me misionin e tyre, sikurse të tjerë kërkojnë falje për mua kur nuk sillem si duhet. Një Kishë që nuk kërkon falje, është një Kishë arrogante”.*<sup>63</sup> Kisha nuk është e nuk duhet të jetë e elitave, kisha është e të vegjëlve, kryesisht e të vegjëlve në pasuri dhe në pushtet... Dom Gjergji, para do kohësh është emruar Vikari (it.ndihmësi, mëkëmbësi) i Arqipeshkvisë Tiranë - Durrës dhe së bashku me superiorët e vet, me Ipeshkvin e vet, e kanë bërë një Mea culpa, para Krishtlindjes së fundit. Nuk besoj të jetë harruar kaq shpejt kumti i tyre asohere se Kisha e Tiranës, në vend të ritualit të pritjes së të pushtetëshmëve të vendit, në ditën e Krishtlindjes, siç kishte bërë që nga rifillimet e veta pas rënies së rregjimit, do të shtrojë një drekë me të papasurit e të pamundurit e qytetit. Për së pari ka ndodhë në Krishtlindjet e sivjetme kështu. Dhe unë e kam kuptuar si një gjest ndjese e faljeje edhe në emër të atyre të tjerëve në Kishë që s’e kanë bërë edhe më heret këtë

---

63 Gjergji Meta, *Hyji është Atë me zemër nëne*, fq.86

gjë. Sigurisht pa shkuar ndër mend me ia mbyllë derën as të pushtetëshmeve, në asnjë rast. Asesi jo! Aq më shumë nëse ndodh që ata hyjnë tek ajo derë me njetin (dëshirën) e mëkatarit që ka ndjerë nevojën e shpalimit të mëkateve dhe lutjen për faljen e tyre, përpara Hyjit...

Dom Gjergji nuk është shenjt, është si gjithë të tjerët, mëkatar edhe ai. Dhe këtë don ta rrëfejë me patjetër, në librin e vet. Jo me një kumt të vetëm a me një frazë steriotipe, po me ngjarje e ndodhi nga vetvehtja. Prej aso ndodhish që rrinë bash në zgrip të delikatesës ndërmjet qenies njeri dhe prift. Siç është mardhënia e tij me pasurinë e me lëmoshën, me tundimin për lavdi dhe ndjesia e përkrahja për njerëzit e periferisë..., dashuria për gjithëkënd, pa asnjë paragjykim për racën, ngjyren a bindjen. Kurse për Kishën, që për të ashtu si për bashkëvëllezërit e tij është nënë dhe nuse ai nuk ngurron të pohojë se: "... një Kishë e varfër është një Kishë e lirë të shfaqë mendimin e saj... Por nëse ajo do të bëjë kompromise, qoftë politike e qoftë ekonomike, me çfarëdolloj pushteti, ajo do të jetë gjithmonë peng dhe e kërcënueshme nga gjithkush."<sup>64</sup>... Dhe sjell në ndihmë të argumentit të vet njërin nga profetët modernë të kishës, kardinal Carlo Maria Martini: "Kisha është e lodhur në Europën e mirëqenies dhe në Amerikë..."<sup>65</sup>. Sikurse sjell në vemendje se vetë Papa Françesku, kërkoi forma të reja pranie nga Kisha në Shqipëri, kur ishte në Tiranë, me 21 shtator të 2014-ës.

---

64 Gjergj Meta, *Hyji është Atë me zemër nëne*, fq.95

65 Gjergj Meta, *Hyji është Atë me zemër nëne*, fq.94

## Kohë e përlyeme


Dhe në përmbyllje të librit, një kapitull i gjatë i kushtohet lutjes së lashtë: "Puna e pendimit". Njëra ndër ato lutje, të cilën Shenjtja Nënë Tereza e thoshte gjithherë në shqip... E bindur, posë të tjerash, se pendimi e liron rrugën e së ardhmes...

*Panorama, 18 shkurt 2017*

“...Se sheklli<sup>66</sup> asht prishë për kah morali”

*(Sa ka rënë pesha e fjalës!)*

**Frederik Rreshpja**, njëri ndër poetët më të mirë të Shqipërisë, liriku më i fundit shqiptar pas Lasgush Pogradecit, siç dhe është vlerësuar, ka patur një vdekje - fikje të vrazhdë. Po edhe jeta e tij, jeta tokësore, thuajse e gjitha e mjerë në një kontrast të hatashëm me poezinë e tij hyjnore. Gjithnji në kufirin e ndërmjetëm të liri - robërisë, krejt i lirë në qenien e tij, ani pse fizikisht i privuar dhunshëm prej saj. Thuajse se gjysmën e viteve të jetës i



---

66 *Sheklli-këtu: bota, njerzia*

kaloi në burg, jeta tjetër si prej asketi e sakaq poezia e tij është refleksi i një jete hyjnore...

Kam patur rastin dhe fatin ta njoh njëherësh kur edhe kam njohur poezinë e tij, në vitin e largët 1973, atëherë kur nëpër duar kisha librin e tij të dytë me poezi, pak mbasi ishte liruar prej burgimit, nuk më kujtohet, ndoshta për së dyti. Libri diçka si në formën e një blloku shënimesh, me format gjatësor krejt pak të hijshëm dhe me një kopertinë të shpërvjelun, të cilën me siguri e kishin "ngatërruar" me dashje ustallarët e shtëpisë së atëherëshme botuese; ngjante si një vizatim i pahijëshme fëmijësh. Ndoshta justifikuar me faktin se më pare Frederiku kishte botuar edhe poezi për fëmijë. Me titullin "Në këtë qytet", të cilin e mbante edhe poema e vetme e librit, që mua më dukej edhe atëhere i lidhur pak me poezitë, mbi të cilat, ti lexuesi jetoje si n' ajri... Impresionuese. Shumë poezi i kujtoj edhe tani, qysh prej leximit të at' hershëm.

Në fillimvitet nëntëdhjetë, tashmë i lirë, por hiç në ekstazë, ai përsëri shfaqej ashtu siç ishte, "kontrapedal", siç qe gatuar. Në vitin 1994 a '95, kur nisën të ravijëzohen, të përfliten e të bien në sy dukuritë e korrupsionit ndër zyrtarët demokratë të shtetit kam dëgjuar edhe një batutë brilante të tij, që edhe sot e kam të kthjelltë në kujtesë: *Asht bâ me të ardhë ma mirë me të thanë hajn xhepush se sa minister...* E solla në kujtesë Frederikun e ndjerë edhe si një homazh për të, për veprën e tij të përkryer dhe në respekt të vuajtjeve dhe dhimbjeve të mëdha deri në zgript të mbijetesës, gjithashtu. Kurse batuten e tij, po e përmend si për të kujtuar një cak në kohë, ku sipas meje fillon një kthesë për keq në raportin e zyrtarëve të shtetit




të ri demokratik, me aspiratën e re të shtetasve shqiptarë, të sapodalë nga qerthulli i trishtë, i dhunshëm i rregjimit diktatorial. Asokohe filluan të përfliten ministrat e rinj për abuzim me pushtetin. Dhe kjo fillesë nuk është ndalur më qysh prej atëherë. Është folur e është folur aq shumë, këtu në Shqipërinë tonë, për këtë dukuri, (që natyrisht nuk është vetëm shqiptare, ajo ka zënë fill prejheri me zanafillen e botës.) aqsa është zhvlerësuar kaq shumë fjala, sidomos ajo për korrupsionin e nuk vlen më një "grosh". Nuk vlen më sepse pas lumit kurrë të ndalshëm të fjalëve - akuza këtu nuk ka pasë asnjë efekt drejtësie, askush nga të përfolurit mëkatarë nuk është ndëshkuar. Rrallë e tek ndonjë peshk i vogël. Derisa dukuria është kalçifikuar dhe ka krijuar arketipin e vet PANDËSHKUESHMËRIA. Në rrjedhën e shtatëmbëdhjetë - tetëmbëdhjetë viteve ka ngjarë gjithnjë kështu tek ne dhe kjo, unë mendoj se është e pa kund ngjashme, së paku këtu rreth nesh, në Europën tonë. Dhe ndodh kështu përditë, sot e gjithë ditën. Thuhen gjithandej fjalë, fjalë, fjalë, që tashma nuk ngjisin askund. Besimi në të mirën thuajse është shuar, kategoritë morale kanë ndërruar dramatikisht kahje; quhesh i zoti nëse je i përdhunshëm, quhesh i zgjuar nëse di ta dredhësh me të pushtetshmin e radhës, quhesh i pasur nëse pasurinë e ke vënë pa punë, quhesh i ditur nëse flet shumë a se ke mundur të pushtosh hapësirën publike mediatike, gazeta apo ekrane qofshin, pavarësisht nga kumti yt ligjërimor. Është stërthënë, se opinionbërësit që kanë tagrin të shfaqen ... në këtë vend, janë diç më shumë se gishtat e njëres dorë. Kurse kontrasti i produktit të tyre me atë të medies sociale është, gjithashtu dramatik, ku e ku larg e të pa

pikëtakueshëm. Por nuk ka qenë gjithherë e gjithmonë kështu.

E çeka edhe më sipër, korrupsioni (siç quhet tani në kohët moderne), pra lakmia për të përfituar nga pushteti, të cilin të tjerët ta delegojnë për ta vënë në shërbim të tyre është i njëhershëm me zanafillen e shoqërisë njerëzore, qyshsekur ajo arriti në stadin që të administrohej nga prijësa të zgjedhur. Por, njëherëshi me të, gjithashtu ka lindur edhe e drejta e sovranit, pra e atyre që të kanë zgjedhur për të të hetuar e së fundi për të të gjykuar nëse ti , prijësi i ke zhgënjyer ata. Dhe përpara këtij gjykimi, pastaj s' të ka vlejtur fytyra një lek... kur e ke shkelur. Ne kemi shembuj edhe nga historia e shtetit tonë të ri (101 vjeçar). Njëri prej tyre, në vitin 1932. Fishta, siç është e njohur bën një polemikë të ashpër me Ministrin e Arsimit të kohës, Hilë Mosi: *"Pse pra do të hidhnoheni Ju, kur themi na se shekulli asht prishë për kah morali ?... Ju pezmin Tuej - për në qoftë se asht pezm e jo tjetër gja - duket e shkrehni më ne jo pse kemi shkruar se duet korrupcioni e muer dhenë, por pse kemi thanë, se ky korrupcion bani ripekursionin (pasqyrimin) e vet edhe në Shqipni e se prandej edhe këtu si gjithkund njeti, s'po ishte vlera e zotësia morale e ditunore timoni i jetës, por rrena, bataqilleku, dredhitë, akraballeku etj., pse me këso fjalësh Ju thoni se akuzojmë kombin, tue cënue në këtë mënyrë nderin e prestigjin kombëtar tonin."* ... E më poshtë vijon polemika *"Veç çka Zotni Hilë, se nuk domethanë gjithherë se cënohet nderi e prestigji i kombit tue ia përmendë të metët e fajet që mundet me pasë. Ju do të keni pa se me ç'fuqi Demosteni nder "Filipiket" [ligjëratat e oratorit grek të Lashtësisë, drejtuar kundër Filipit të Maqedonisë, babait të Aleksandrit të Madh] e Aristofani nder*

*komeditë e veta të pavdekshme  
ua përmendin Athinasve të  
metat... tue mos kursye as  
njerzit ma të përmendun, që deri  
më sot ka pasë njerzimi si bie fjala  
Sokratin. E megjithkëtë grekët  
nuk i mbajshin për pesimistë,  
disfatistë, mësa mbajnë  
italianët për orëzi, shpirtzi  
Dante Aligerin përse ka shkruar:  
**Ahi, serva Italia, di dolore  
ostello/Nave senza nocchiere  
in gran tempesta/Non donna  
di provincie, ma bordello**[Ah,  
Itali skllave,banesë e mjerimit/  
Anije pa lundërtar në stuhi të forte/Jo Zonjë krahinash, po  
bordello !].<sup>67</sup>*



Hilë Mosi -  
Ministër i arsimit 1930-1933

Polemika, zhvilluar 82 vjet më parë, përmendet e citohet edhe sot, në radhë të parë sepse është e pangjashme me debatin intelektual e politik që zhvillohet sot në Shqipëri. Jo vetëm për nga forma e përkryer e etikës publike dhe mjeshtrisë publicistike, por edhe për thelbin e saj, në radhë të parë. Hilë Mosi ishte njëri prej ministrave të kohës (i Arsimit) me një veprimtari 25 vjeçare atdhetare, intelektual i spikatur, por edhe pjesëmarrës me armë në dorë në kryengritjet e mëdha për liri e pavërsësi, në krye të malësorëve, me 1911-tën. E megjithatë, “Hylli...”, Fishta, opinionioni publik, i mishëruar mrekullisht mirë tek

67 *Hylli i Dritës* 1932/12, fq.593-610

## Kohë e përlyeme

“të urtit” siç qe ai, por edhe të tjerë si ai të cilët, shqiptarët i kishin në dritë të syrit, krijonte trandje të madhe tek burokracia shtetërore e kohës, kur mekanizmat e saj shkelnin mbi interesa të shtetasve e të kombit. Sepse atëherë, fjala kishte peshën e fjalës...

*Shekulli, 28 maj 2014*

## Kumti i Atjon Zhitit, si porosi për sot e mot

Në librin e Atjon Zhitit, djalit rrezëllitës të Poetit Visar Zhiti: "Për atë që dua(m)", që u shugurua në ditën e parafundit të gushtit që shkoi kur Atjoni do të mbushte njëzet vjeç, nëse... nuk do të ishte tashmë në botën e qiellit ku është, traktati (eseja) i katërt i tij, titulluar: "Kulla émé nuk asht e vetme" përfundon kështu: *Dhe para se me ba boten përçark e ma përtej, duhet me ba vedin dhe bota asht e bame vetvetiu...*

Ese - ja e shkruar në gegnishte, nisur si një provë, por e shkruar me një korrektesë të lavdërueshme, gati të përsosur, rrokë virtyte dhe veset e njeriut shqiptar, antropologjinë e etnologjinë e tij, me të cilin ai shfaq raporte dashurie të paprekëshme, gati sublime. Evokimi i këtyre vlerave, pesha specifike e të cilave ka rënë dukshëm ndër ne, në kohën tonë tranzitive të integritimit në Europë është një kumt plot vlerë e rëndesë për vetëdijen tonë sociale, publike. Por në rend të parë për vetvehten e sejcilit prej nesh. Kjo është risia që Atjoni, bukuroshi engjëllor, na ka sjellë me këtë kumt.

I njëjti kumt, formuluar në stilet e tyre, na vjen edhe prej Konicës<sup>68</sup> gati nëntëdhjetë vjet më parë. Prej Fishtës gjithashtu, ("Tash, që asht ba Shqipnia, duhen përbâ shqiptarët", <sup>69</sup>. Kadare e ka theksuar jo veç njëherë në përditëshmërinë tonë, sidomos në nyjet-kriza që shpesh e lidhin e shtërngojnë gati fatalisht ecjen e kombit tonë drejt prosperitetit. Sipas shembullit të tyre edhe Atjoni e dikon (e zbraz) kumtin e tij që i del prej arsyes së formuar mirë, por më së shumti prej shpirtit të trazuar djaloshtar. Njëherësh sfidues me mendësinë e brezit të vet, prirë me plot arsye nga moderniteti, ai iu rikthehet vlerave morale. "*Duhet me iu kthye virtuteve, se krahas kulturës intelektuale ka edhe një kulturë morale, e domosdoshme, ku na shqiptarët, jemi shumë ma t'fortë, ishim deshta me thanë, prandaj ia vlen kushtrimi me i ringjallë vlerat e shekujve. Virtutet duen gjindje të virtutshme.*"

Shoqëria shqiptare sot është është në kuotat e saj më të diskutueshme të kulturës së vet morale; virtutit i ka kërcyer sipri vesi dhe ngjan vesi si e para vlerë morale (!) Raporti i virtyteve me veset, ngjan se është kthyer me krye poshtë. Turri për të fituar pa djersë e mund është moda e preferuar. Hajdutëria, fyerja, përdhunimi, poshtnimi i tjetrit çmohen përmbi nderëshmërinë, mosprekjen e gjësë së tjetrit, respektin për vetveten dhe nderimin e tjetrit.

Po kalçifikohet kulti i sundimtarit, duke përbuzë detyrën e shërbyesit amanetqar. Shembulli i zyrtarit të korrumpuar të shtetit po kthehet në model. Dhe ky model

---

68 Faik Konica, "Shqipëria si m'u duk, 1928, fq.54

69 Hylli i Dritës, nr.4, 1930

i shëmtuar ka lëshuar metastazat në qenien morale të vlerave e ata përparojnë duke e mahisur si mos më keq këtë qenie, drejt rrënimit gati të pandalshëm. Boshlleku e deformimi i vlerave morale e ka mbushur vetvehten e njeriut me dëshpërim. Ndaj njerëzit rendin të ikin e duan të ikin. Ikin se nuk kanë mjetet elementare të mirëjetesës, ndaj vrapojnë të ikin për një jetë më të mirë, sigurisht për më shumë para, për më shumë mall e gjë e mirëqenie. Për sigurinë e vetvehtes, gjithashtu. Sepse ajo u cënohet përditë. Prej hajdutit ordiner nga i cili nuk e mbron shteti, prej taksidarit të shtetit, të cilin e stimulon vetë shteti me korrupsionin e kthyer në sistem, nga fodulli në zyra, nga oligarku që ka zaptuar edhe ajrin... Të gjithë, të gjithë e rjepin atë vetvehten e tij...

Por ikin edhe për më shumë qytetari. Ikin edhe prej boshllekut moral, për pak më shumë butësi e për më pak egërsi. Mbushë me pezm ikin. Edhe ata që qëndrojnë pak shpresojnë se mund ta ndryshojnë për mirë. Edhe më pak veprojnë e bëjnë për ta ndryshuar. Ndaj... *duhet me ba vedin dhe bota asht e bame vetvetiu...*"

*Panorama, 25 shtator 2015*

Dom Ndoc Nikaj, 30 botime dhe...  
shtypshkronja “Nikaj”.

Sivjet mbushen 25 vjet nga dita, kur në kapelen e rrënuar të “Vorreve t’Rrmjajit” në Shkoder u tha mesha hymn dhe sfidë, ndaj rregjimit paranojak ateist, e para pas një ndërprerjeje po kaq të gjatë të të drejtës për të besuar. Kjo ka ngjarë me 4 nëntor 1990... dhe rendin e përkujtimeve sivjet në këtë përvjetor e hap paraqitja e ribotimit të një libri të hershëm, që për autor ka njërin prej famullitarëve të radhës, Dom Ndoc Nikaj.

“Histori e Shcypnis” është vepra në dy pjesë; pjesa e parë, botuar në Bruksel me 1902 dhe e dyta, botuar në Shkoder, me 1917”. Tani, të dyja përmbledhur në një libër, me kujdesin e përkorë të famullitarit të ri të Shkodrës Dom Artur Jaku dhe puntorit pasionant të shkencës së historisë, Dr. Dom Nikë Ukgjini.

Lindur në Shkoder 150 vjet më parë, Dom Ndoc Nikaj, prift katolik dioçezan, historian, veprimtar atdhetar, është gjithashtu autori i romanit të parë, shkruar në shqip. Titulli në origjinalin e veprës është: “Marzia e kscatenimi n’filles t’vet” (Marcia e krishtënimi në fillesë të vet). Është historia e martirizimit të Marcies, e cila kallet e gjallë në dhë, sepse



nuk pranon të mohojë Krishtin. Vepra është një rrëfim ndërmjet agjiografisë e romanit, me gjatësinë e një novele. Ndoc Nikaj ka lënë shtatë romane të pabotuara. Është pararendës i prozës në gjuhën shqipe, pararendës i Mihal Gramenos, i Milto S. Gurrës, i prozës së Foqion Postolit, Filip Papajanit, Mid'hat Frashërit, Ernest Koliqit ...

*"Unë fillova me shkrue vakinat (ndodhitë) e kishës, që me ndihmën e Pieter Dodmasejt mbujta me shtyp në shtypshrojen e Propagandës së Romës në vjetin 1888. Mbas atij libri, në shtypshkrojen e Jezuitve shtypa ma t'parin romanzë "Marzia e ksctenimi n'fillesë t'vet" ... e qi kjenë fillesa e botimeve mija. <sup>70</sup>*

Siç është e njohur, më 1897 Faik Konica fillon botimin e së përkohshmes "Albania". Që në fillesë, don Ndoc Nikaj bashkëpunon pothuaj rregullisht me artikuj me përmbajtje politike, shoqërore dhe atdhetare. Me pseudonimin "Nakdomonici" ... Nëpërmjet pseudonimit të Nikajt, bashkëpuntorit të zellshëm të revistës presigjioze, Atë Gjergj Fishta në poezinë satirike "Nakdomonicipedia", në hyrje të vëllimit të tij me satira "Anzat e Parnasit" me përpjekjet fisnike dhe atdhetare të mikut të tij, përqesh hierarkinë e përmbysur të vlerave sociale në Shqipërinë e kohës (1907)...

*Me at' t'bukren histori,  
Qi ke shkrue permbi Shqipni,  
Aq idhnim pa fe nevoje,  
E ndoj borxh edhe n'shtypshroje? ...  
Sot n'Shqipni, more lum miku,*

---

70 D.Ndoc Nikaj:Kujtime të një jetes së kalueme-Plejad,2003

*Histori asht meteliku.*<sup>71</sup>

Më pas, Nikaj do të vijojë edhe me të tjera botime historike, por edhe libra këndimi e tekste të tjera mësimi për shkolla. Të botuara janë rreth 30 vepra të gjinive e zhanreve të ndryshme, pa numëruar këtu ata të lëna në dorëshkrim, një bilanc krijues ky i lakmueshëm për shumë të tjerë vërsnikë të Nikajt por dhe jo vetëm.

Dom Ndoc Nikaj solli të parën shtypshkronjë publike në Shkodër, me 1909. Dhe e para punë në të ishte shtypshkrimi i fletores së vet, **fletores së parë politike të botuar në shqip** me 1910-tën me emrin “Koha”, periodik, i cili gjithashtu do të vijojë të botohet edhe 11 vjet me vonë, deri më 1921, me të tjerë emra “Bashkimi” “Besa shqiptare” dhe “Zani i Shkodres”. Kjo fletore shënon fillësën e të botuemit të librave në gjuhën shqipe, në Shqipëri...

Në një artikull në “Hylli i Dritës”,<sup>72</sup> të vitit 1938, në 50 vjetorin e meshtarisë së tij shkruhet: “...Shpirt energjik e shqiptar në veshtrimin e njimendte të fjalës, D. Ndoc Nikaj kje një nder mâ të parët reaktjonarë qi ndieu me një intensitet të këthellë nevojen e të perhapunit të gjuhës shqype. Shkrimet e tija të shumëta nuk paten qellim tjetër veç me e rrajosë në zemren e popullit dashtrnën e gjuhës amtare... Në vjetin 1892, në sà gjindej famulltâr në Shkrel, Emzot Doçi prej Oroshi rà në Shkrel, kû u formue ndermjet tyne një lidhëje veprimi patriotike, qi mâ vonë dha fryte mjaft të dobishme për ngritjen e indipendencës s'onë kombtare. Kjo lidhëje kje thirrë

---

71 Gj.Fishta-vepra 7-Botimet Fishta 2012, fq.8

72 “Hylli i Dritës”, 1938 nr, 7,fq.383

Frano Kulli

*“Lidhëja e msheftë per Fë e Atdhë”. Kjo lidhëje e msheftë muer të hapun e dha mâ vonë frytet e duehuna në rasen e kryengritëjes kundra Turkis...”*

Dhe si shpërblim për gjithë sa bëri për kulturen shqiptare, për gjuhën, historinë dhe lirinë e kombit të vet... dom Ndoc Nikaj u arrestua nga komunistët më 1946, në moshën tetëdhjetedyvjeçare, me akuzën absurde të planeve për përmbyshjen e qeverisë me dhunë. Vdiq në burgun e Shkodrës pesë vjet më vonë, në janar 1951.

Trashëgimia muzikore e Gjon Kujxhisë dhe...  
qokat kulturore

Gjon Kujxhia vdiq i ri. I ri fort, 23 vjeç. Bombardimeve ajrore të 25 shtatorit të vitit 1943 nuk qe e thënë t'i shpëtonte edhe banesa e tij në Firenze dhe aty iu këput fryma e fundit, djaloshit shqiptar nga Shkodra, student për muzikë asokohe, në Konservatorin "Luigi Cherubini".

Simbas përshkrimeve të miqve të tij bashkëstudentë shqiptarë atje, copat e materialit prej bombardimit rrënimtar e zunë përfundi, me fletoret e pentagrameve hapur, duke punuar në dhomën e tij. Vdekja e mori për vete Gjonin e ri, në kulmin e moshës e të muzës dhe la pezull këndeje në botën tonë, andrrat edhe punët e tij të bukura dhe shumë serioze.



Gjon Kujxhija

Gjon Kujxhisë, *"kanga i a përsolli jeten mbi këtë shekull plot me lot, prej djepit n'arkivol"*, shkruan Ernest Koliqi, njëzet vjet më vonë (*"Shejzat" [Le pléiadi], rivista culturale, sociale ed artistica, Roma 1963.*) I lindur dhe i rritur në një familje qytetare të kulturuar e në një mjedis artistik

siç ishte ai i "Gjuhadolit" të kohës me njerëz të dhënë në shumicë pas së bukurës e artit ku, vetëm njerëzit e familjes së tij formonin një orkestrinë mandolinatë (e përbame prej mandolinash), geni i tij që kultivuar e lëmuar shumë shpejt. Aty në atë oaz të Shkodrës e prej vetë atyre luheshin jo vetëm pjesë nga melodramat e kompozitorit të talentuar dom Mikel Koliqi, i cili më pas do të kalonte nëpërmes fundit të ferrit të burgjeve të rregjimit dhe më së mbrami në amshim do të nisej me petkun e Kardinalit... Por luheshin e këndoheshin aty edhe këngë nga Schubert-i si "Serenata", etj. a "Va pensiero" e Verdit. Luheshin gjithashtu dhe pjesë nga të tjerë autorë të mëdhenj botëror si Bach, Handel, Beethoven, Schubert, etj. Grupit familjar të Kujxhijve iu shtuan edhe djem e vajza të lagjes "Gjuhadol". Gjoni ishte shpirti i shfaqjeve që jepeshin aty. Falë këtij formimi po edhe talentit si dhunti, ai arrin shpejt të realizojë vepra që mbesin. Në këtë moshë, ende të re gjithashtu për t'u shënuar, ai la dy sosh, shumë të vlerata edhe sot. Me interes për t'u e studiuar e analizuar edhe në rrafsh akademike të fushës së muzikologjisë. E para "VALLE KOMBËTARE" vol.I, u botua prej tij, atje në Firence, në qershorin e '43-it. Fillimisht në pak kopje. Me dëshirën për t'i shpërndarë ato kopje ndër miq e mbasi të mblidhte përshtypjet e vlersimet e tyre, me e ribotue, të qortuar e të plotësuar librin.

Sa synim i dlirtë por dhe ekzigjent!

Kurse vëllimi i dytë, për mbas fatit tragjik të autorit, nuk arriti të dalë, por mbeti pezull. Fati i librit të dytë shkoi deri tek shënimi në kopertinën e librit të parë: *Nga i njejt i auktuer per se shpejti do të dalë nga shtypi libri Kangë*

*popullore hengu shkodranë, vol.I. Këndue nga kangatari i njoftun shkodran Zot. Nush Bushati.* Bile, Tonin Harapi, njëri prej atyre muzikantëve të shquar shqiptarë, njohës shumë i mirë sidomos i këngës qytetare shkodrane, ai, që simbas Kolë Gurashit “i ka shti në nota muzikore për me mbet t’pa vdekshme kangët e vjetra t’ëahengut shkodran” do të shkruante më 1991: “Ka që pohojnë se Gjon Kolë Kujxhija ka mbledhë dhe përgaditur për botim atëherë edhe këngët e ahengut shkodran dhe i ka dhënë për shtyp, por deri tashti nuk dimë asgjë për fatin e tyre” (*Gjon Kolë Kujxhija - editimi Eno Koço, 2018*)... Ndërsa, nga muzikologu Mustafa Kantja, vjen dëshmia e publikuar në “Bashkimi i kombit” (24 shtator 1944): “...Kishte qenë shkruar që ato dy vepra të mbeteshin si përmendore e këtij artisti të pafat.”...

Përgjatë kohës së rregjimit të shkuar, Gjon Kujxhija mbeti jashtë përmendjes dhe vepra e tij, ajo e botuara e tjetra në dorëshkrim, natyrisht e pavlerësuar dhe thuajse e përhumbar dhe e tretur. Ashtu siç ka ndodhë në përgjithësi me vlerat e vërteta, që si rregull qenë të papërshtatshme për shijen e rrejshme (preferenciale, propagandistike) të rregjimit. Muzikologu Harapi, vetëm në vitin 1991 mundet ta kërkojë “melhemin” (ilaçin) për të shëruar plagën e harresës dhe përhumbes së qëllim të asaj çfarë la Gjon Kujxhija. Një prej vlerave të njëmendta të artit dhe kulturës sonë dhe trashëgimisë së saj, siç e pohojnë zëplotë muziktarët e njohësit më në zë të këtij vendi....

Këto ditë, të dy veprat vlerësuar si monument të muzikologjisë shqiptare e si një trashëgimí e vyer do t’i paraqiteshin lexuesit të dëshiruar si një botim

serioz, edituar nga Eno Koço. Në sallën e Akademisë së Shkencave, në një pjesëmarrje gjithashtu të dëshiruar, me persona të interesuar e të dashuruar me vlerat e trashëgimisë sonë, Ishin ata që donin shumë të ishin. Të dy veprat në një vëllim, kuruar bukur me shënimet dhe vlerësimet e epërme bërë nga muziktarë e njerëz të kulturuar të bashkëkohësisë së Gjonit. Dhe plot të tjerë pasues ishin gjithashtu aty, mbas ftesës plot përunjësi e të njerëzishme të Nikolin Kujxhisë, nipit e familjarëve që e kshin mbështetur gjithçka me financat modeste familjare... Ndërsa në sallë nuk ishte asnjë zyrtar i kulturës qoftë edhe ndonjëri i rangut të tretë, të Minisrisë së Kulturës. Entit të detyruar me ligj për evidentimin, ruajtjen e mbarështimin e trashëgimisë kulturore! Siç nuk kishte qenë askush prej tyre kur dashamirët e Martin Camajt përkujtonin atë dhe vepren e tij të shënuar si vlerë e sspikatur e letësisë sonë. Sakaq zonja ministreshë në faqen elektronike të institucionit që drejton, nuk mënon të na përditësojë vëmendjen tonë me kalendarin e gjithëfarë qokash që u bëhen prej aty miqve dhe miqve të miqve... Kurse shefi i saj, kryeministri ynë, surprizues si gjithnjë, qokën e fundit një mikut të tij artist ia bën duke i... recituar poezi nga libri i sapobotuar. Në një audiencë aq të lartë publike që zotëria posedon. Për shkak të postit, sigurisht... Ndërsa, ndër pesë vitet e tij kryeministore unë nuk e kam dëgjuar ndonjëherë t'ia përmendë emrin, së paku Poetit Kombëtar, Gjergj Fishta. Jo domosdo si parapëlqim, po një detyrimin e vet si i pari i punëve në këtë vend.

*Panorama, 25 maj 2018*

Humoristi i të qeshurës së mundimshme,  
GJOSHO VASIA

**Gjosho Vasia** i mbylli sytë përgjithmonë dhe u largua nga kjo botë, pak muaj më parë në Trieste të Italisë. Gjoshoja është varrosur në Trieste, atje do të prehet në paqe në pushimin e pasosur. Në dhë të huaj, jo në “fushë t’Rrmajit”, larg Shkodrës së zemrës, që, megjithatë, pak në jetë e gëzoi. Iku duke i marrë të gjitha më vehte, të mirat e të mundimshmet, siç i merr në një ditë të fundit me vehte secili njeri i kësaj bote. Ashtu siç i ka pasë ato në këtë jetë, kë më të pakët e kë më të shumtë. Gjoshoja për fatin e vet të trishtë, pati me shumicë këto të dytat...

Vështirë të gjenden shumë të tjerë si Gjosho Vasia, i cili kishte provuar për një kohë të gjatë, ferrin e dëbim internimit, duke filluar nga mosha e sendërtimit të ëndërrave, në rininë e herëshme, por provën e mundimëshme të torturës dhe vuajtjes e kishte përcjellë gjithherë me gaz, me buzëqeshje. Nëpër sfondin e së cilës, si nëpër eter kumbonin tingujt e kitarës së dashur. Bash kjo nuk është e zakonshmja, e rëndomta a patetikja. Kjo ishte krejt e veçanta në artin e Gjoshos, dhuntia, talenti i tij, i papërsëritshëm te dikush tjetër.



Gjoshoja ishte gjendur në Trieste, në vitin '91, atëherë kur shqiptarët, si zogjtë shtegtarë në tufa,



po niseshin në drejtim të vendeve të ngrohta me diell, po iknin drejt tokës së premtuar. Po iknin të raskapitur nga klima e acartë e vendit të tyre, Shqipëria ua kishte mpirë prej kohësh gjymtyrët e lirisë. Ai e kishte ëndërruar si pakkush atë tokën e premtuar dhe kjo ëndërr nuk i është ndarë për dyzet vjet. Sinjalet e lidhjes me të i kishte të genit të vet, ato ishin instaluar me arratisjen e të vëllait, në

vitin e largët '49. Edhe ai kish ikur, jo me njetin e ikjes, por si rrjedhojë e goditjes dhe e shtytjes së trandshme që po u jepej atij dhe të tijve nga rregjimi mizor që po vinte... Këtu fillon kalvari i djaloshit nga Shkodra e i familjarëve të tij. Pak muaj mësuës në Mirditë, prej aty me pranga në duar në kampin e shfarosjes në Tepelenë, në Çorovodë, Berat, Elbasan, Kamzë... baltë, vuajtje, plagë, vajt, terr, ankth, kalvar mundimesh "me ja kallxue natës së vorrit". Prej aty në Myzeqe... Nëpër të gjithë rrathët e ferrit... Histori më vehte jeta e tij. Gjoshoja nuk pá ditë të mirë, si me thënë, nga e keqja e biografisë. Derisa, një ditë... "këmben" gjithë mundin e jetës, gjithë pasurinë e jetës, pronën e shtëpinë,

*traditën e lavdinë treqindojeçare të Vasijeve me ... dy bileta avioni! Ikën. Në fakt me ikjen e tij, vetëm ndërron skenë sepse dramën e merr me vete! Edhe atje mbetet po ai, Gjoshoja i kitarës, i këngës dhe i humorit, i punës së lodhëshme artistike e fizike Veçse i shtohet edhe një, malli për atë vend që e deshi kaq shumë por që e mundoi kaq fort..." shkruan dr.Pjetër Pepa<sup>73</sup> .*

Gjoshoja, nuk u kthye më fizikisht, por jehona e gjithçkaje të mirë e të mrekullueshme, që ai kishte, i ka rrënjët këtu. Mirësia e tij buis e bleron gjithnjë e nuk vyshket kurrë. Malli dhe nderimi për të rrjedh pa ja dá, qysh prej ditës kur iku prej këtu e derisa mbylli sytë...atje.

**Isa Alibali**, në librin e tij "Në Shkodër të gjithë këndojnë", si dedikim i përcjell nga Shkodra në Trieste edhe këtë urim:

*"Mikut tim Gjoshio Vasija! Që e kujtoj shpesh me dashuri, nderim e konsideratë te veçantë.Kur e patëm pranë nuk ja dijtëm sa duhet vleren e madhe që pat e tashti që ai asht larg e ndjejmë në shpirt mungesën e tij.Le të jetë ky libër përçues i lidhjeve me të afërta shpirtnore dhe njiherit falënderim për gjithçka bëri për shokët, miqtë dhe të gjithë qytetarët shkodranë me talentin e tij të madh. Isa Alibali –Shkodër, 15 janar 1998!"<sup>74</sup>*

### **Paulin Preka:**

*Me Gjoshon kam mjaft kujtime, se me té jam i hershëm në miqësi e art. Ishte shumë i aftë në monolog e parodi, kuplet e imitim. Ishte një kitarist e muzikant brilant. Si djalë edhe ma i shkëlqyer,*

---

73 P.Pepa: "Gjoshio Vasia-meteor i humorit shqiptar" , Enti botues Gj. Fishta, Tiranë, 2001, fq.132

74 Xh.Bushati:"Drita e kujtimeve-studime mbi artin skenik, Shkoder 1998,fq.81

*ishte njeri i përkryer, gjithmonë në qejf. Edhe kur ishte në kulmin e halleve të tija, fytyra e tij nuk shprehte kurrë dramë...<sup>75</sup>*

***Bep Shiroka:***

*E kam njohur Gjoshon që fëmijë! Kemi jetuar në oborrin e tyne. Prindët kishin shumë miqësi mes tyne. Si komik ka kujt i ngjet! Të dy prindët i kishte gazmorë e kur bashkoheshin të gjithë bashkë, ndigjonte e gjithë mëhalla gazin që bahej.*

*“Gjeolog” i artit shqiptar që zbuloi thesare të mëdha e të pashterrshme, e quajtën ata që e njohën dhe vlerësuan punën e tij të palodhshme...<sup>76</sup>*

***Zyliha Miloti:***

*Gjoshoja ishte vërtetë i Shkodrës, por i përket gjithë Shqipërisë. Gjoshjo Vasija ka qenë një Pipo Baudo shqiptar. Megjithëse regjimi ia frenoi sa mundi talentin e shkëlqimin ai prapë u shfaq si një kupletist e parodist i jashtëzakonshëm.<sup>77</sup>*

***Skender Sallaku***

*Gjoshjo Vasija është padiskutim parodisti i parë shqiptar, që me aftësinë e talentin e rrallë arriti aq lart sa pak kush arrin. Mbi të gjitha dinte të komunikonte në mënyrë të shkëlqyer me spektatorin e sidomos me fëmijët. ... E ngacmoja, duke folur për politikë, bëja sikur isha nxehur e flisja me zë të lart. Ai menjëherë shkonte e ngrinte zërin e televizorit e më thoshte: Skënder, ti don me më çue në*

---

75 Xh.Bushati: "Drita e kujtimeve-studime mbi artin skenik, Shkoder 1998, fq.82

76 Po aty, fq.83

77 Po aty, fq.83

burg para kohe. Lene mor Zot atë muhabet e mos ha... "molla" se mue edhe pa këto më fryn era mbas shpinet... E them me siguri se ishte i vetmi, që në atë periudhë të vështirë që kemi kaluar, (e që ti e di mirë se je marrë me politikë kohët e fundit) pra në ato rrethana jashtëzakonisht penguese e frenuese, posaçërisht për të, nuk iu nda anjëherë skenës. Me aftësitë dhe talentin e tij arriti të fitojë aq respekt sa të ja kishte zili çdo artist tjetër.<sup>78</sup>

*Vaçe Zela* Njohja dhe kujtimet e mija me Gjoshon i përkasin një të shkuare tashmë mjaft të largët. Janë ndoshta kujtimet më të bukura sepse flasin për hapat e para të jetës sonë artistike. Isha shumë e re dhe duke ju referuar situatës së atyre viteve, dija pak për të, aq më pak mund të pyesnim.

Unë fillimisht e dija si te internuar në Lushnjë, por shumë më vonë mësova që ai paskësh qenë në një repart pune të ushtrisë... Ajo që m'u ngulit që në fillim dhe mbeti në kujtesën time gjithë jetën për Gjoshon Vasinë ishte aftësia e veçantë e tij për të krijuar atë lidhje si të pathënë, s'dihej se si vinte, mes spektatorit dhe atij artisti të lindur. Sa dilte ai në skenë ovacione të jashtëzakonshme shpërthenin menjëherë pa marrë vesh se kur e si e krijoi atë lidhje aq të bukur e fisnike me spektatorin lushnjar. Ishte aktor me një forcë të madhe dhe e shprehte bukur e me fisnikëri se gjithçka bënte, e bënte për të gëzuar spektatorin. Gjoshoja filloi të shkëlqejë me atë, të vështirën, të bukurën, parodinë. Unë isha e re dhe nuk di si qëndronte puna për Shqipërinë, veç di të them se Lushnja e shijonte për herë të parë atë përmes një artisti të madh siç ishte Gjoshon Vasija. Përmes melodisë dhe humorit të bukur ai i përcillte gjithëherë


---

78 P.Pepa: "Gjoshon Vasija-meteor i humorit shqiptar", fq.86

spektatorit mesazhe qytetërimi e morali, asnjëherë politike. Paroditë e tija moralizonin qytetërimin, pastërtinë, ironizonin zhurmën, fshikullonin veset. Qysh në atë kohë e në ato kushte ai aspironte dhe përcillte mesazhet e një qytetërimi përmes të cilëve bënte për vete gjithë popullin e Lushnjës.

Dallohej aftësia e tij e madhe për të ngritur të tjerët përmes dialogjeve e lojës së përbashkët. Të krijonte përshtypjen e njeriut të sakrificës, sepse në këto raste ai vetë sikur rrinte në "hije" dhe duartrokitjet i mirrte partneri i tij që ndihmohej aq bukur e aq me shpirtë e pasion nga vetë Gjoshoja. Mbi të gjitha ishte si një njeri i mrekullueshëm, një njeri i rrallë për të cilët kemi nevojë...<sup>79</sup>

... Kur do të përgatitnim librin e tij me satira "Epopeja e llomit kombëtar", bashkë me një foton e tij më ka përcjellë edhe dy gishtë letër:



Frano!

N'te marrtë mendje, këtë foto ma strehó te ndoj faze e librit, me shpresë që shokët e mi, edhe pse në murgjin dhe i plakur, më krytojnë perseri.

Gjosh

Trieste. 2004

79 Po aty, fq. 85

## Kohë e përlyeme

Iku... por ai la këtu të qeshurën, gazin, humorin e rrallë, la me shumicë atë për të cilën njerëzit kanë më shumë nevojë se për gjithçka tjetër, gjëra të cilat janë mjaft më jetëgjata se vetë jeta e njeriut ...

Sa i dashur është ai njeri që të dhuron të qeshurën!

*Shekulli, 25 shkurt 2014*



## **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Kulli, Frano

Kohë e përlyeme : publicistikë / Frano Kulli ;  
red. Tefë Topalli. – Lezhë : Gjergj Fishta, 2018

232 f. ; 21 cm.

Bibliogr.

ISBN 978-9928-222-66-4

1.Letërsia shqipe 2.Shkrime, korrespondenca për shtypin

821.18 -92



